



KURTH NARRACIONI:

**ZBULIMI I NARRACIONEVE TË DËMSHME
TE POLITIKANËT DHE MEDIAT**

Titulli i monografisë:

Kurth narracioni: Zbulimi i narracioneve të dëmshme te politikanët dhe mediat

Botues:

Instituti për studime të komunikimit
rr. "Jurij Gagarin" 17-1-1, Shkup
www.iks.edu.mk

Për botuesin:

prof. dr. inord. Zaneta Trajkoska

Edicioni:

ResPublica

Autorë:

prof. dr. Eleonora Serafimovska, mr. Jordanka Çerepnallkova-Trajkova, prod. dr. inord. Zaneta Trajkoska, mr. Tea Koneska-Vasilevska, prof. dr. inord. Meri Karanfillovska, Aleksandra Temenugova, prof. dr. Simona Gruevska Maxhoska, mr. Jordana Shemko-Georgievska dhe Vjosa Taipi

Redaktor:

prod. dr. inord. Zaneta Trajkoska

Recensent:

prof. dr. Vesna Shopar

Titulli i origjinalit:

Наративна стапика: Откривање на Штетни(те) наративи кај политичарите и медиумите

Përkthimi në shqip:

mr. Jordana Shemko-Georgievska dhe Vjosa Taipi

Dizajni grafik:

Ivana Temellkoska

Redaktimi teknik:

Dejan Joveski

Viti:

2025

Vendi:

Shkupi

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.776.23:32-05(497.7)"2023/2024"(047.31)
81'42:32-05(497.7)"2023/2024"(047.31)
316.774:[316.776.23:32(497.7)"2023/2024"(047.31)
316.774:[81'42:32(497.7)"2023/2024"(047.31)
316.77:32(497.7)"2023/2024"(047.31)

KURTH narracioni [Електронски извор] : zbulimi i narracioneve të dëmshme te politikanët dhe mediat / [autorë Eleonora Serafimovska ... [и др.] ; përkthimi nga gjuha maqedonase në shqip Jordana Shemko-Georgievska dhe Vjosa Taipi]. - Shkup : Instituti për studime të komunikimit, 2025. - (Edicioni ResPublica)

Начин на пристапување (URL):

<https://respublica.edu.mk/wp-content/uploads/2025/02/Kurth-narracioni-zbulimi-i-narracioneve-te-demshme-te-politikanet-dhe-mediat.pdf>.
- Превод на делото: Наративна стапика : откривање на штетни(те) наративи кај политичарите и медиумите. - Текст во PDF формат, содржи 251 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 03.03.2025. - Фусноти кон текстот. - Други авторки: Jordanka Çerepnallkova-Trajkova, Zaneta Trajkoska, Tea Koneska-Vasilevska, Meri Karanfillovska, Aleksandra Temenugova, Simona Gruevska Maxhoska, Jordana Shemko-Georgievska dhe Vjosa Taipi. - Библиографија: стр. 248-251

ISBN 978-608-4805-53-3

1. Serafimovska, Eleonora [автор] 2. Çerepnallkova-Trajkova, Jordana [автор] 3. Trajkoska, Zaneta [автор] 4. Koneska-Vasilevska, Tea [автор] 5. Karanfillovska, Meri [автор] 6. Temenugova, Aleksandra [автор] 7. Gruevska-Maxhoska, Симона [автор] 8. Shemko-Georgievska, Jordana [автор] [преведувач] 9. Taipi, Vjosa [автор] [преведувач] а) Политичари – Штетни наративи – Македонија – 2023-2024 – Истражувања б) Медиумско известување – Штетни политички наративи – Македонија – 2023-2024 – Истражувања в) Политичка комуникација – Македонија – 2023-2024 – Истражувања

COBISS.MK-ID 65408005

Lista e shkurtesave

ASHMAAV – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele

LD – Lëvizja demokratike

SHGM – Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë

TE – togfjalësh emëror

ISK – Institut për studime të komunikimit

FE – fraza emërore

IL – Inovacione leksikore

KEMM – Këshilli i etikës së mediave në Maqedoni

ND – narracion i dëmshëm

NA-DËM – “Matja e narracioneve të dëmshme politike” (**NA-DËM**)

PARATHËNIE

Publikimi është rezultat i hulumtimit “Matja e narracioneve të dëmshme politike” (NA-DËM) të Institutit për studime të komunikimit i zbatuar në bashkëpunim me hulumtues dhe ekspertë nga fusha e komunikimeve dhe mediave, gazetarë dhe profesionalistë nga mediat. Në mënyrë interdisiplinare, me “ndihmë” të shkencës së komunikimit, psikologjisë, politikologjisë, linguistikës, hulumtimi më mënyrë longitudinale (viti 2023 dhe 2024) depërton thellë në “rrefimin për narracionet e dëmshme politike” në kontekstin maqedonas, duke i dhënë përgjigje pyetjes kryesore të hulumtimit “A dhe si krijohen dhe shpërhapen narracionet e dëmshme politike” në hapësirën publike të komunikimit. Monografia i ndjek “shtigjet” e narracioneve të dëmshme politike, krijimin, strukturimin, promovimin, zbatimin e tyre, si dhe efektet dhe pasojat e mundshme në kontekstin aktual shoqëror-politik, të përshtatur në një periudhë të komunikimit politik “të rregullt” dhe periudhë të komunikimit politik “zgjedhor”.

Kompozicionalisht, monografia përbëhet nga pesë tërësi. Së pari, niset nga “zeroja”, nga postulatet teorike, shkencore të kësaj çështjeje, me përkufizim të qartë konceptual të narracioneve të dëmshme politike, modeleve, burimeve, elementeve të tyre, me theks në kuptimin dhe ndikimin e tyre në komunikimin politik, kurse mandej edhe në dy subjektet kyçe të “obsesionit”, aktorët politikë dhe mediat dhe rolin e tyre në krijimin, moderimin, transmetimin dhe shumëfishimin e narracioneve të dëmshme politike. Pikërisht këtu qëndron edhe veçantia e këtij hulumtimi, përkatësisht krijimi i një liste të veçantë indikatorësh për detektim, mbikëqyrje, matje të narracioneve të dëmshme, si “vlerë e shtuar” në përvojat ekzistuese hulumtuese, kurse të përshtatura në kontekstin shoqëror-politik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Empirikisht, në pjesën “Narracionet politike nëpër numra”, zbulohen, kontrollohen pyetjet e parashtruara në mënyrë hipotetike për mbartësit e narracioneve të dëmshme. Analiza dëshmon se aktorët politikë (politikanët, partitë politike, funksionarët) janë krijuesit dominues të narracioneve të dëmshme politike, me një potencial enorm “kreativ” si në krijim, vëllim të prodhimin dhe shpeshësi ashtu edhe në përmbajtje dhe shumëllojshmëri. Duke i shfrytëzuar të gjitha resurset dhe mediat në dispozicion (të botuara, elektronike, internet) dhe kanalet zyrtare (konferencat për gazetarët, tribunat, profilet personale në internet, kumtesat publike të institucioneve, fjalimet në Kuvend), informimin publik dhe debatin e argumentuar e zëvendësojnë me sulme, shpifje, ofendime, nënçmime, para së gjithash drejtuar oponentëve politikë, personaliteteve publike, madje edhe gazetarëve, duke bërë “kujdes” që qytetarët të mos i ofendojnë në cilëndo bazë, sepse ata janë votuesit e tyre. Rrefimet e tyre drejtohen kah minimin të besimit tek institucionet, përzgjedhjes së njëanshme, nxitjes së ndarjeve, sulmeve të ndërsjella në bazë profesionale, populizmit, që e minon seriozisht besimin në parimet dhe proceset demokratike. Kurse mediat (dhe gazetarët), pothuajse pa diskutim, edhe “fjalë për fjalë”, dhe pa rezerva e kritika, i përcjellin narracionet të dëmshme të qytetarët, duke mundësuar depërtimin e tyre në të gjithë hapësirën informative. Të kapur në kurthin e “pa/korrektësisë politike”, në vend që të jenë “mbrojtës” të publikut, punojnë për interesa të veçanta, dhe me vetëdije ose jo, i harrojnë/shkelin standardet bazë profesionale gazetareske. I informojnë qytetarët mbi çështjet aktuale sociale-politike, por në fakt marrin pjesë në dezinformimin dhe manipulimin e tyre, të “kapur” në vorbullën e “lojërave” politike. Çështja nuk është vetëm të informojmë në mënyrë të paanshme dhe të vërtetë, të mos jenë në funksion të politikanëve, të mos shpërhapim dezinformacione, gjuhë urrejtjeje, propagandë, por të kundërshtojnë aktivisht të gjitha

narracionet të cilat bazohen në të pavërteta, dezinformacione, nxitje të diskriminimit, të vënë në dukje përmbajtjen mediatike manipuluese dhe “toksike”, por edhe t’i dekonstruktojnë, kurse për këtë i kanë në dispozicion standardet etike të përcaktuara qartë.

Në analizën vijuese mbi “Rolin e fjalëve në konstruksionin e narracioneve të dëmshme” analizohet përmbajtja e fjalëve të përdorura, kurse si metodë për zbulimin e strategjive të komunikimit të cilat i përdorin aktorët politikë gjatë shpjegimit të dukurive, problemeve në shoqëri. Në këtë mënyrë, analiza se kush, çfarë dhe si në mënyrë narrative (të dëmshme) ka thënë, deklaruar, theksuar në hapësirën e komunikimit publik zërthehet në mënyrë diskursive në thellësi për të kuptuar kontekstin dhe kornizën në të cilën vendosen narracionet e dëmshme. Si mbështetje e kësaj janë shembujt e shumtë të raporteve/informacioneve në media (elektronike, internet) në të cilat dominojnë narracionet e dëmshme. Mandej, theks i veçantë u kushtohet emocioneve dhe rëndësisë dhe peshës së tyre në krijimin e narracioneve të dëmshme, gjë që është vërtetuar deri më tani në studime të shumta se pikërisht emocionet janë një nga faktorët kryesorë që ndikojnë mbi njerëzit dhe sjelljen e tyre, kurse në politikë, për të vendosur për çështje me rëndësi jetike për shoqërinë. Fjalët të cilat kanë ngjyrim emocional në narracionet e dëmshme e ndjekin sistemin binar të funksionimit, pamjen e thjeshtë bardhezi për politikën, por edhe për të gjitha sferat e tjera të jetesës (ekonominë, kulturën, shëndetësinë, mediat, arsimin...) të “neve” të mirët, të ndershmit, patriotët, kurse “ju” të këqijtë, të pandershtit, tradhtarët dhe shumë e shumë të tjera. Vokabulari i tillë, i përcjellë nëpërmjet mediave të publiku, nuk ka mundësi të mos ketë pasoja për të gjithë shoqërinë dhe sipas modelit të ofruar, shkakton një ndarje të dyfishtë të qytetarëve madje edhe në qelizat më elementare shoqërore (familje, të afërm, miq), por edhe zhgënjimin e tyre, dëshpërimin, apatinë dhe një valë emocionesh të përziera të përkatësisë dhe lidhjes nga njëra anë, përkundrejt frikës dhe përbuzjes, nga ana tjetër. Madje, as aktorët politikë dhe as mediat, jo vetëm që mbajnë nuk përgjegjësi për prishjen e mirëqenies së qytetarëve, por duket se as që nuk janë të vetëdijshëm për këtë përgjegjësi. Dhe tërësia e pestë dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme ka të bëjë me “Neologjizmat si pjesë e narracioneve të dëmshme politike”. Dhe këtu dominojnë aktorët politikë duke përdorur ose “kalke” krejtësisht të reja ose shprehje të njohura me kuptim të ri dhe kontekstualizim të dëmshëm, si manipulim strategjik gjuhësor drejtuar, para së gjithash, kah publikut. Nëpërmjet mediave të cilat i transmetojnë këto neologjizma të dëmshme, ato jo vetëm që janë në dispozicion por edhe është më e mundshme të hyjnë në përdorimin e përditshëm nga qytetarët, kështu shpërhapen mandej, “marrin legjitimitet” dhe bëhen praktikë.

Në tërësi, konstatimet përmblylëse në këtë monografi “paralajmërojnë” retorikë serioze të dëmshme politike e cila e “ndot” hapësirën e komunikimit publik, duke sulmuar kështu demokracinë dhe vlerat demokratike. Arsyë më se e mjaftueshme për mobilizim të të gjitha burimeve shoqërore për t’u “rezistuar” metodave dhe formave të tilla të veprimit politik. Në këtë drejtim janë rekomandimet e dhëna në fund të monografisë, përkatësisht respektimi i dokumenteve obligatore ekzistuese vendase dhe ndërkombëtare (deklaratat, ligjet, rekomandimet, kodet) të cilat i përcaktojnë standardet dhe parimet në komunikimin politik, që nga aktorët politikë kërkojnë të jenë transparentë, në dispozicion të mediave, profesionalistë, të paanshëm dhe të përfaqësojnë interesin publik në komunikim, të mos jenë burim dhe të mos shpërhapin gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese, kurse nga mediat paanshmëri, saktësi, transparencë dhe konstruktiviteti. Janë prekur të gjithë, edhe aktorët politikë edhe mediat, por para së gjithash, qytetarët, publiku. Nevojiten ndryshime nëse duam të flasim për komunikimin politik demokratik.

Ky publikim është një vepër “pioniere” që depërton në mënyrë sistematike, problematike dhe metodologjike në analizën e narracioneve kryesore të dëmshme politike, në shfaqjen, shtrirjen, shpërhapjen e tyre, subjektet që i krijojnë dhe transmetuesit që shpërhapin përmbajtjen e dëmshme, vokabularin që përdoret si arma kryesore, natyrën e tyre diskursive, si edhe ndikimin e tyre negativ mbi “shëndetin” e shoqërisë dhe demokracisë. Kuptohet se narracionet e dëmshme politike nuk janë një “dukuri” e re, as në mjedisin maqedonas dhe as në mjedisin më të gjerë, por e kanë ngritur “alarmin” për praninë e tyre gjithnjë e më dominuese, madje edhe pranimin, kurse jo rrallë edhe

justifikimin si “bashkëpunëtor” në mjedisin politik të brendshëm. Si rrjedhim, doli domosdoshmëria e një qasjeje ndërdisiplinore si një potencial unifikues në “ekspozimin” e “dëmit” që e mbartin këto narracione, domethënë shfrytëzimi i kapaciteteve (njohurive dhe përvojës) i një numri të madh teoricienësh/studiuësish, si dhe të praktikantëve/empiristëve (ekip prej 30 personash), si vlerë e shtuar në rezultatin i cili është para nesh).

Në fund, një falënderim të madh për të gjithë hulumtuesit dhe autorët pjesëmarrës në këtë angazhim hulumtues enorm, me shpresë se ky publikim do të nxitë hulumtime të reja si në vendosjen e mekanizmave të shumtë ashtu edhe kah vendosjes së tyre për rregullim/vetërregullim, por edhe për edukim të qytetarëve, mediave, aktorëve politikë në luftën kundër narracioneve të dëmshme politike dhe mbrojtjen e demokracisë. Sot, edhe pas përfundimit të hulumtimit, botimit të raporteve të rregullta mujore, dymujore, gjashtëmujore të njohurive të marra, kurse tani edhe me këtë monografi, narracionet e dëmshme politike, edhe pse ndoshta nuk e kanë intensitetin dhe koloritin e njëjtë, nuk janë fshirë nga vokabulari politik dhe e “ushqejnë” ende publikun. Një arsye e mjaftueshme për hulumtime në këtë temë, analizë të thellë të diskursit të konstruksionit të çështjeve dhe proceseve shoqërore-politike në shtet.

Falënderim edhe për mbështetjen nga Ambasada Britanike -Shkup, e cila në suazat e projektit “Përdorimi i gazetarisë së bazuar në fakte për ngritjen e vetëdijes dhe për kundërshtim të dezinformacioneve në hapësirën mediatike në Maqedoninë e Veriut: Përdor fakte” e njohu rëndësinë e kësaj teme/këtij problemi edhe te ne edhe më gjerë.

prof. dr. Vesna Shopar

Përmbajtja

| | |
|--|-----------|
| HYRJA | 10 |
| 1. KORNIZA KONCEPTUALE DHE TEORIKE | 13 |
| 1.1. Për narracionet | 13 |
| 1.2. Mbi rolin e emocioneve të narracionet | 16 |
| 1.3. Aktorët politikë dhe narracionet e dëmshme | 19 |
| 1.4. Mediat dhe narracionet e dëmshme | 23 |
| 1.5. Neologjizmat në narracionet politike | 26 |
| 1.6. Narracionet politike nëpërmjet prizrave të teorive | 29 |
| 1.7. Hulumtime relevante | 33 |
| 2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT | 40 |
| 2.1. Objekti dhe qëllimet e hulumtimit | 40 |
| 2.2. Pyetja e hulumtimit dhe konkretizimi i saj | 40 |
| 2.3. Variabëlë | 41 |
| 2.4. Ekzemplari | 45 |
| 2.5. Qasja metodologjike | 48 |
| 2.6. Teknika metodologjike për analizë të të dhënave | 50 |
| 2.7. Instrumente | 50 |
| 3. NARRACIONE TË DËMSHME POLITIKE NËPËRMJET NUMRAVE | 52 |
| 3.1. Analiza e narracioneve të dëmshme politike të krijuara nga aktorët politikë | 53 |
| 3.2. Analiza e informimit nga mediat për narracionet e dëmshme politike | 67 |
| 3.3. Mesazhe kryesore nga analiza e aktorëve politikë dhe mediave | 87 |

| | |
|--|------------|
| 4. ROLI I FJALËVE NË KONSTRUKSIONIN E NARRACIONEVE TË DËMSHME | 92 |
| 4.1. Si aktorët politikë përdorin fjalët për të ndërtuar narracione të dëmshme | 94 |
| 4.2. Si mediat online përcjellin fjalorin e narracioneve politikisht të dëmshme | 102 |
| 4.3. Si e komunikojnë stacionet televizive fjalorin e narracioneve politikisht të dëmshme ... | 110 |
| 4.4. Mesazhet kryesore nga analiza e fjalëve të përdorura me ngjyrim emocional | 117 |
| 5. NEOLOGJIZMAT SI PJESË E NARRACIONEVE POLITIKISHT TË DËMSHME | 120 |
| 5.1. Analiza komunikuese - linguistike | 121 |
| 5.2. Dallimet dhe ngjashmëritë midis aktorëve politikë në lidhje me përdorimin e neologjizmave . | 164 |
| 5.3. Mesazhet kryesore nga analiza komunikative-linguistike | 166 |
| 6. SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE | 168 |
| 6.1. Përgjigjet e pyetjeve nga hulumtimi | 168 |
| 6.2. Pasojat e narracioneve të dëmshme | 174 |
| 6.3. Implikimet teorike dhe shkencore | 175 |
| 6.4. Rekomandime dhe angazhime të ardhshme | 178 |
| 7. SHTOJCA | 182 |

Ëndërrojmë me narracion, fantazojmë me narracion, kujtojmë, parashikojmë, shpresojmë, dëshpërohemi, besojmë, dyshojmë, planifikojmë, rishqyrtojmë, kritikojmë, ndërtojmë, përflasim, mësojmë, urrejmë dhe duam nëpërmjet narracionit.

(Barbara Hardy)¹

1 Hardy, B. (1987). The Collected Essays of Barbara Hardy. New Jersey: Harvest Press.

Në botën e politikës, që prej shekujsh, dhe deri më sot, fjala e shqiptuar në publik ka pasur peshë si “mal”. Në antikë oratoria politike është konsideruar si shkencë, kurse sot apostrofohet si shkathtësi. Për politikanët është “privilegj” t’i drejtohen publikut në mënyrë direkte/ indirekte, por edhe “përgjegjësi” se si do të veprojnë, çfarë dhe si do t’u thonë qytetarëve të vet, atyre që i kanë zgjedhur që t’i udhëheqin, për të qeverisin me shtetin. Aktorët politikë krijojnë dhe përdorin narracione që të formojnë opinionin publik, duke ndikuar kështu mbi sjelljen dhe vendimmarrjen politike. Duke vepruar kështu, ata i përdorin gjithashtu mediat që t’i promovojnë narracionet e veta. Megjithatë, qëllimi i mediave është të informojnë, edukojnë publikun dhe të sigurojnë pluralizëm të mendimeve, qëndrimeve dhe fakteve të besueshme për të gjitha proceset shoqërore. Keqpërdorimi i hapësirës së komunikimit publik me përmbajtje potencialisht të dëmshme dhe narracione me informacione të rreme, të pasakta, keqdashëse, gjuhë urrejtjeje dhe dezinformata jo vetëm që e kontaminon “arenën” politike, por përbën edhe sfidë dhe kërcënim serioz për demokracinë, një problem me të cilin merren seriozisht shkencat politike, sociologjia dhe psikologjia, dhe janë zhvilluar teori të shumta dhe janë miratuar një sërë ligjesh, deklaratash, rregulloresh dhe kodesh për “mbrojtjen e së vërtetës”. Në dekadën e fundit, me rritjen e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, sfida është bërë edhe më e madhe. Rrethi po zgjerohet gjithnjë e më shumë, duke përfshirë të gjitha format dhe metodat e komunikimit politik publik, të gjitha subjektet, nga qytetarët e thjeshtë e deri te strukturat më të larta politike në shtet, e bashkë me të edhe përmbajtjet dhe informacionet potencialisht të dëmshme.

Në suazat e shkencave sociale dhe politike, termi narracione politike përdoret për të përshkruar mënyrën në të cilën rrëfimi i tregimeve/historive mund të formësojë faktet, duke ndikuar kështu në kuptimin e realitetit (Shenhav, 2006). Në të vërtetë, narracionet e propaganduara nga aktorët politikë synojnë të bindin dhe mobilizojnë publikun, të formojnë opinionin publik dhe të legjitimojnë agjendat politike. Në këtë kuptim, narracionet politike nuk janë thjesht një koncept teorik, por edhe një lloj mjeti i përdorur nga aktorët politikë për të ndërtuar një realitet dhe perspektivë të caktuar dhe në këtë mënyrë t’i ndryshojnë marrëdhëniet midis individëve dhe grupeve në një shoqëri (Graef et al., 2018).

Mediat nga ana tjetër, luan një rol kyç në përcjelljen e narracioneve politike, duke vepruar si urë lidhëse midis politikëbërësve dhe opinionit. Nëpërmjet lajmeve, platformave të mediave sociale dhe kanaleve digjitale, mediat “marrin pjesë” në formësimin e të kuptuarit publik të ngjarjeve, çështjeve dhe ideologjive politike. Ndikimi i tyre mbi narracionet politike është i dyfishtë: kur raportimi i medias është i balancuar, ai ofron njohuri të vlefshme dhe e mban qeverinë përgjegjëse; kur është e deformuar, selektive ose sensacionale, mund të dezinformojë dhe të përçajë publikun. Ky ndikim kompleks nxjerr në pah nevojën për gazetari të përgjegjshme, për edukimin mediatik të opinionit dhe për shqyrtimin e vazhdueshëm të praktikave mediatike që të sigurohet një demokraci e shëndetshme dhe e informuar.

Skena politike maqedonase po i “përjeton” të njëjtat përmbysje, veçanërisht të theksuara në vitet njëzet të shekullit të 21-të. Një periudhë e ngarkuar me çështje dhe probleme serioze vendimtare për zhvillimin e vendit: ndryshimi i emrit të vendit, hyrja e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, fillimi/stagnimi i negociatave për anëtarësim në BE, ndryshimet në Kushtetutë, rritja e euroskepticizmi, marrëdhëniet e mira fqinjësore me Bullgarinë dhe Greqinë, ndryshimi i qeverisë (zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare), reformat në drejtësi, skandalet e rënda korruptive në sfera të shumta sociale. Kontekst social-politik “i ndjeshëm” ndaj krijimit të historive/ rrëfimeve të dëmshme të kundërshtarëve politikë, të ndarë në “patriotë” dhe “tradhtarë”, “të ndershëm” dhe “kriminelë”. Mjedisi politik është thellësisht i polarizuar, shkrim-leximi mediatik dhe informacioni është i zhvilluar dobët, dhe hapësira onlajn nuk është rregulluar sa nevojitet, ndërsa hapësira e informimit publik ndotet gjithnjë e më shumë me dezinformata, informacione të pasakta, informacione keqdashëse, propagandë dhe gjuhë të urrejtjes. Sulmet, nënçmimet, etiketimet dhe ofendimet ndaj “tjetrit” janë të zakonshme, pa argumente apo fakte, mendimi ndryshe as dëgjohet e as perceptohet. Janë aktivizuar të gjitha format mediatike dhe format e komunikimit politik – nga mediat tradicionale, rrjetet sociale, platformat alternative, grupet e bisedave private, madje po krijohen dhomat e jehonës (flluska) si “bashkëudhëtarë” që mesazhet politike të arrijnë te qytetarët.

Në mungesë të hulumtimeve të thelluara që do t’i zbulonte madhësinë, burimet, modelet dhe elementet e përmbajtjes dhe rrëfimeve të dëmshme që e “kontaminojnë” hapësirën e komunikimit publik, është e nevojshme t’u përgjigjemi disa pyetjeve kryesore: cilët janë subjektet që krijojnë narracionet e dëmshme politike, cilët janë subjektet që transmetojnë narracione të dëmshme politike, cila është natyra, shpeshtësia dhe konteksti i narracioneve të dëmshme politike, strategjitë dhe teknikat retorike në komunikimin e tyre me publikun. Përgjigjet e të gjitha këtyre pyetjeve i jepën nga Hulumtimi “Matja e narracioneve të dëmshme politike” (NA-DËM) i kryer midis vitit 2023 dhe 2024. Këtu, narracionet e dëmshme përcaktohen qartë, operacionalizohen nëpërmjet një sërë indikatorësh, kurse problemi kryesor hulumtues - narracionet e dëmshme politike në komunikimin politik – “observohet” në mënyrë empirike longitudinale nëpërmjet kanaleve të komunikimit publik gjatë një periudhe njëvjeçare.

Hulumtimi përfshinte tri nivele analize: së pari, ndjekje (monitorim) e praktikave të komunikimit të aktorëve politikë dhe monitorimin e mediave (TV-stacione dhe mediat e lajmeve onlajn), kontroll dhe analizë, gjatë të cilave përgatiteshin dhe publikoheshin raporte periodike; së dyti, hulumtim ad hoc për temë/tema që rezultoi/ rezultuan si jashtëzakonisht domethënëse gjatë periudhës së hulumtimit dhe niveli i tretë, përgatitja e monografisë, përkatësisht një raport përmbledhës i të gjithë periudhës së hulumtimit, i cili përfshin analiza të thelluara dhe ofron më shumë të dhëna mbi situatat me narracione të dëmshme politike dhe raportime mediatike për to në Maqedoni.

Të dhënat e marra nga niveli i parë i analizës, domethënë nga procesi i monitorimit të komunikimit politik publik të aktorëve politikë dhe transmetimit dhe përhapjes së tyre në media, u analizuan në raporte periodike, si dhe në dy analiza përmbledhëse disamujore. Analizat e detajuara të çdo subjekti politik apo mediumi individual janë të disponueshme në [analizën periodike](#) (gjithsej pesë), [gjashtëmujore](#) (shtator 2023 - shkurt 2024) dhe analizën [tremujore](#) (mars - maj 2024). Analiza e nivelit të tretë bazohet në të dhëna e përgjithshme, jo në aktorët politikë individualë apo mediat, por në mënyrë kolektive. Kështu që, monografia i mbulon aspektet kryesore të problemit: postulatet teorike dhe fokusin hulumtues mbi narracionet politike, narracionet e dëmshme politike të krijuara nga aktorët politikë dhe raportimin e medias mbi narracionet, dinamikën, llojet dhe format e tyre. Theks i veçantë i kushtohet rolit të fjalëve në ndërtimin e narracioneve të dëmshme, si dhe neologjizmave si pjesë e narracioneve të dëmshme politike.

Hulumtimi “Matja e narracioneve të dëmshme politike” (NA-DËM) Instituti për studime të komunikimit (ISK) e realizoi në suazat e projektit “Përdorimi i gazetarisë të bazuar në fakte për ngritjen e vetëdijes dhe kundërshtimit të dezinformacioneve në hapësirën mediatike në Maqedoninë e Veriut: Fakte të dobishme” mbështetur nga Ambasada Britanike në Shkup.

1. KORNIZA KONCEPTUALE DHE TEORIKE

1.1. PËR NARRACIONET

Narracioni është rrëfim ose tregim i ngjarjeve, përvojave, pikëpamjeve, të vërtetave apo të rremeve, në forma të ndryshme, të shkruar, me gojë apo vizuale që të përcjellin informacione, për bindje, por edhe për argëtim. Ai është rrëfim i strukturuar për ngjarje të caktuara dhe/ose përvoja në rrëfim me një kuptim konkret. Në [Fjalorin e shkrim-leximit mediatik](#), narracioni përkufizohet si “Tregim; rrëfim i cili lidh ngjarje dhe personalitete midis tyre; një mënyrë e caktuar e kuptimit apo shpjegimit të ngjarjeve”, termin i cili në “shkencën e komunikologjisë zë një vend të veçantë”.

Narracionet shpesh vendosin shkakësinë, kuptimin dhe koherencën midis ngjarjeve të palidhura ndryshe dhe kështu u mundësojnë individëve ta kuptojnë dhe ta interpretojnë realitetin në një mënyrë të thjeshtë dhe të hapur. Narracionet nuk janë vetëm një rrëfim i fakteve, por përfshijnë perspektiva, vlera dhe interpretime (Patterson & Monroe, 1998; Hinele, 2018). Pikërisht për shkak të aftësisë së tyre për të organizuar informacione komplekse në struktura koherente dhe të lidhura që nuk harrohen, narracionet konsiderohen si një mënyrë e natyrshme për t'u kuptuar njerëzit. Ky proces në fakt i ndihmon njerëzit të organizojnë përvojat e tyre personale dhe kolektive, duke i lejuar ata të shohin vendin e tyre në një kontekst më të gjerë shoqëror ose historik (Patterson & Monroe, 1998).

Karakteristikë e narracioneve është fakti se informacioni në to paraqitet në formën e përvojave të thjeshta të përditshme njerëzore (p.sh., një sekuençë ngjarjesh në formën e shkakut dhe pasojës, motivimeve, konflikteve dhe zgjidhjes së tyre), gjë që i bën ato më të kuptueshme dhe më të lehta për t'u kuptuar dhe për t'u mbajtur mend. Hulumtimet psikologjike tregojnë se njerëzit kanë më shumë gjasa të mbajnë mend dhe të lidhin informacionin kur ai paraqitet si një histori, sesa kur paraqitet si fakte të izoluar (Bruner, 1991). Por ato kanë fuqi të bindin dhe të ndikojnë mbi qëndrimet, bindjet dhe sjelljen e njerëzve. Si mjet, narracionet nuk janë neutrale. Ato mund të përdoren për të bindur njerëzit drejt qëllimeve pozitive si drejtësia, barazia dhe qëndrueshmëria, por mund të përdoren gjithashtu për të mbështetur terrorizmin, autoritarizmin dhe dhunën (Braddock dhe Hogan, 2016).

Narracionet janë, gjithashtu, mjete themelore për ndërtimin e identiteteve personale dhe grupore. Nëpërmjet narracioneve të përbashkëta, individët lidhen me të tjerët, duke krijuar një ndjenjë përkatësie dhe mirëkuptimi reciprok. Për shembull, historitë kombëtare, historitë fetare ose mitet kulturore ofrojnë korniza që lidhin individët me vlerat dhe qëllimet kolektive, duke e përforcuar lidhjen sociale (Shenhav, 2006). Narracionet e lehtësojnë empatinë dhe mirëkuptimin e të tjerëve, gjë që nga ana tjetër është thelbësore për socializimin e njeriut dhe lidhjen me bashkësinë (Hinele, 2018).

Narracionet janë shumë efikase në përfshirjen e emocioneve, të cilat luajnë rolin kryesor në vendimmarrje. Tregimet i përfshijnë emocionalisht njerëzit, duke i ndihmuar ata të lidhen me

situata, fenomene dhe personazhe të caktuara në një nivel personal, gjë që nga ana tjetër ndikon ndjeshëm mbi qëndrimet dhe vendimet. Ky angazhim emocional i individit shpesh çon në lidhje më të forta me përmbajtjen narrative dhe, si rrjedhim, në një kuptim më të thellë të çështjeve të paraqitura në kontekstin narrativ (Marcus et al., 2000).

Psikologjia evolucionare sugjeron se tregimi i rrëfimeve mund të ketë evoluar si një mjet social për mbijetesën e individit të ri, duke ndihmuar në transmetimin e njohurive, përvojave të paçmuara për jetën dhe mbijetesën, kujtesës kulturore dhe normave sociale. Ndoshta çdo brez përpigjet t'i përcjellë brezit të ardhshëm mesime, rreziqe dhe vlera kulturore nëpërmjet rrëfimit të "historive", në mënyrë që ato të mbahen mend dhe të transmetohen mandej. Ky afinitet i lindur për tregimet është ngulitur kështu në psikikën njerëzore, duke i bërë narracionet një mjet themelor për të kuptuar dhe për të mësuar (Boyd, 2009; Sugiyama, 2001). Nëpërmjet historive të përbashkëta - të tilla si mitet, rrëfimet historike ose anekdotat familjare - bashkësitë krijojnë kujtesën dhe identitetin kolektiv, duke i përforcuar vlerat kulturore dhe kohezionin grupor (Hineline, 2018).

NARRACIONET NË POLITIKË

Narracionet përdoren edhe në politikë, ku krijohet një rrëfim i cili do të jetë i kuptueshëm për votuesit, do të ndikojë mbi perceptimet e opinionit për politikanët dhe çështjet politike dhe to ta formësojnë mendimin publik mbi ngjarje të rëndësishme shoqërore-politike. Narracioni politik është histori e rrëfyer nga politikanët që të prezantojnë vetveten dhe politikën e veta nën një dritë pozitive, që të krijojnë ndjenjë të vazhdimësisë dhe t'u japin kuptim fushatave të tyre.

Sipas përkufizimit, narracionet politike janë rrëfime të strukturuar të ngjarjeve politike që janë si personale ashtu edhe kolektive, duke ofruar korniza nëpërmjet të cilave individët dhe grupet kuptojnë botën, interpretojnë rolet e tyre në jetën politike dhe u japin kuptim ngjarjeve politike dhe sociale (Patterson dhe Monroe, 1998). Narracionet politike i ndihmojnë individët dhe grupet të kuptojnë realitetin politik. Ato përdoren nga aktorët politikë që t'i portretizojnë ngjarjet në një mënyrë të caktuar, që t'i legjitimojnë veprimet e tyre dhe që ta nxitin identitetin kolektiv. Ato ndikojnë në mënyrën se si perceptohen çështjet politike, duke i lidhur ato me një histori më të gjerë, e cila mund të përfshijë elemente të historisë, ideologjisë ose vlerave kulturore (Shenhav, 2006). Në fakt, nëpërmjet tregimit të përsëritur, grupet dhe individët krijojnë një ndjenjë të përbashkët përkatësie dhe vazhdimësie, qëllime dhe vlera që ndihmojnë në ruajtjen e kohezionit politik (Patterson dhe Monroe, 1998; Shenhav, 2006).

Narracionet politike, jo vetëm që e formësojnë dhe e reflektojnë, ndonjëherë shtrembërojnë realitetin politik. Roli i tyre në politikë është të shërbejnë si mjete thelbësore për ndërtimin e kuptimit dhe organizimin e realiteteve komplekse politike (Patterson dhe Monroe, 1998; Shenhav, 2006). Duke inkuadruar ngjarje dhe çështje nëpërmjet rrëfimit të tregimit, aktorët politikë ndihmojnë e publikun që t'i interpretojë ngjarjet politike në mënyra që përputhen me agjendat dhe angazhimet e tyre.

Narracionet politike janë dinamike dhe të adaptueshme. Siç ndryshojnë kontekstet politike, ashtu ndryshojnë edhe narracionet, duke i lejuar aktorët politikë të përgjigjen në mënyrë efektive ndaj realiteteve në ndryshim (Shenhav, 2006). Kjo përshtatshmëri u lejon që të mbeten relevante dhe aktualë me kalimin e kohës, duke ndryshuar që të mbledhin informacione të reja ose ndryshime në peizazhin politik (Patterson and Monroe, 1998). Kjo e bën të qartë se fuqia e narracioneve nuk qëndron vetëm në përshkrimin, por edhe në ndërtimin e realitetit politik, duke ndikuar kështu si në perceptimin ashtu edhe në sjelljen e publikut.

Paterson dhe Monro (Patterson and Monroe, 1998) e mbrojnë përdorimin e narracionit si një qasje analitike në shkencat politike, duke sugjeruar se narracionet mund të zbulojnë aspekte të sjelljes politike që mund të mos jenë të dukshme vetëm nëpërmjet metodave kuantitative. Duke e shqyrtuar strukturën, përmbajtjen dhe shpërndarjen e narracioneve politike, studiuesit mund të fitojnë një pasqyrë më të thellë në vlerat, besimet dhe motivimet që qëndrojnë në themel të veprimeve politike.

ASPEKTET HULUMTUESE TË NARRACIONEVE POLITIKE

Aspektet të diskutuara, të analizuara dhe të hulumtuara më shpesh të narracioneve politike janë:

- **Inkuadrimi:** Narracionet politike shpesh përfshijnë inkuadrimin e ngjarjeve ose çështjeve në një mënyrë të veçantë që të theksohen disa aspekte të caktuara, kurse të minimizohen të tjerët. Me zgjedhjen e duhur të fjalëve, imazheve dhe metaforave, mund të ndikohet theksueshëm mbi mënyrën se si publiku e percepton problemin.
- **Mesazhet:** Narracionet politike zakonisht drejtohen, fokusohen në mesazhe konkrete ose aspekte specifike të dialogut që përputhen me një agjendë politike. Këto mesazhe përsëriten në mënyrë të përsëritur që të përforcohet narracionin (Lakoff, 2004).
- **Emocioni dhe identiteti:** Narracionet efektive politike shpesh tërheqin emocionet dhe prekin identitetet dhe vlerat e njerëzve. Ato janë ndërtuar në një mënyrë që mund të krijojë një ndjenjë përkatësie midis mbështetësve ose të nxisë urrejtje ose zemërim që të motivojnë veprime, ose të nxisin frikë, panik ose kërcënim që të dekurajojnë ndërmarrjen e veprimeve të caktuara ose të motivojnë bindjen e padiskutueshme.
- **Thjeshtësia dhe anësia:** Narracionet janë më efektive kur janë të thjeshta, lehtësisht “të tretshme” dhe të arritshme për një publik më të gjerë. Argumentet komplekse ose të nuancuara mund të errësohen nga narracionet më të qarta dhe më të thjeshta, kështu që publiku do t'i pranojë ato të thjeshtat më lehtë dhe më shpejt.
- **Konsistenca:** Konsistenca është vendimtare në ruajtjen e narracionit politik. Ndhmon në krijimin e besueshmërisë dhe siguron që mesazhi të mbetet koherent me kalimin e kohës (Bennett & Livingston, 2018).
- **Kontrasti dhe kundërshtimi:** Narracionet politike shpesh përfshijnë kontrastin e pozicionit personal me atë të kundërshtarëve ose rivalëve: ne/neve kundrejt ata/atyre. Kjo mund të bëhet duke theksuar dallimet në politikat, vlerat ose karakterin (Shenhav, 2006).
- **Mediat dhe kanalet e komunikimit:** Aktorët politikë përdorin kanale të ndryshme të komunikimit, siç janë fjalimet, debatet, mediat sociale, reklamat dhe “mbulimi” i lajmeve, që t'i shpërhapin narracionet e veta.
- **Evolucioni i narracionit:** Narracionet politike mund dhe duhet të zhvillohen me patjetër me kalimin e kohës i përgjigje ndaj rrethanave të ndryshueshme, mendimit publik dhe ngjarjeve (Polletta & Callahan, 2017). Përshtatshmëria është e rëndësishme për efektivitetin e tyre afatgjatë.
- **Efektet:** Qëllimi përfundimtar i narracioneve politike është të ndikohet mbi mendimin publik dhe mbi perceptimin publik, të mobilizohen votuesit dhe të arrihen qëllimet e agjendës politike. Ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e diskursit publik dhe të rezultateve të zgjedhjeve dhe debateve për politikën (McCombs & Shaw, 1972).

Ajo që është e rëndësishme të ë theksohet është se narracionet politike mund të ndryshojnë shumë në përmbajtjen dhe qëllimin e tyre. Ato mund të përdoren për qëllime pozitive, si promovimi i angazhimit qytetar dhe informimi i paanshëm i publikut, por shumë shpesh për qëllime më manipuluese. Narracionet politike me qëllime manipuluese shpesh shtrembërojnë faktet, përforcojnë stereotipa përçarëse ose nxisin paragjykime dhe armiqësi ndaj grupeve të caktuara, duke krijuar dhe mbështetur perceptime negative që t'u shërbejnë qëllimeve politike. Ato përkufizohen si narracione të dëmshme politike dhe mund të rrisin polarizimin, ndarjet dhe minojnë besimin në institucione, gjë që nga ana tjetër çon në konflikt social dhe politik (Wodak, 2015; Sokol & Sarajlić, 2023). Veçanërisht të përhapura me shpejtësi në epokën e mediave sociale, “dhomat e jehonës” dhe “flluskat e informacioni” mund të jenë armë të fuqishme në duart e aktorëve të ndryshëm që synojnë të destabilizojnë demokracinë dhe të zhdukin njerëzimin.

Efektiviteti i një narracioni politik do të varet nga faktorë të tillë si besueshmëria e burimit, mënyra në të cilën mesazhi përcillet tek publiku i synuar, konteksti më i gjerë politik dhe social në të cilin ai përcillet dhe ndahet, si dhe pranueshmëria e publikut dhe edukimi dhe arsimimi i tij.

1.2. MBI ROLIN E EMOCIONEVE TE NARRACIONET

Emocionet kanë rol kyç në rrëfimin e tregimit sepse rrisin përfshirjen dhe angazhimin e dëgjuesit, ndihmojnë në ruajtjen e përmbajtjes narrative në kujtesë dhe ndikojnë në qëndrimet dhe sjelljet e publikut.

Tregimet e “ngarkuara” emocionalisht tërheqin vëmendjen dhe nxisin një lidhje midis tregimtarit dhe publikut. Kur tregimet ngjallin emocione të tilla si gëzim, trishtim ose frikë (të njohura në psikologji si emocione bazë), ato krijojnë përvojë unike që mund të çojë në përfshirje më të thellë të individit. Kjo rezonancë emocionale është thelbësore për komunikim dhe bindje efektive (Bruner, J., 1991).

Historitë emocionale kanë më shumë gjasa të mbahen mend më lehtë sesa ato neutralet, sepse amigdala, pjesë e trurit e përfshirë në përpunimin e emocioneve, e përmirëson kodimin e kujtimeve që janë emocionalisht të rëndësishme. Si rezultat, narracionet që ngjallin emocione të forta mund të lënë një përshtypje të qëndrueshme, duke e bërë mesazhin e përcjellë më të paharrueshëm (LaBar & Phelps, 1998).

Emocioni gjatë rrëfimit mund t'i formësojë qëndrimet dhe sjelljet e publikut duke krijuar ndjeshmëri për personazhet ose situatat. Kur publiku identifikohet emocionalisht me një histori, mund të ketë më shumë gjasa të ndryshojë bindjet e veta ose të ndërmarrë veprime bazuar në narracionin e paraqitur (Green & Brock, 2000).

Struktura e një narracioni, duke përfshirë kurthin dhe zhvillimin e karakterit, përcakton ndjeshëm ndikimin e tij emocional. Narracionet e hartuara mirë zakonisht ndjekin një strukturë që ndërton tension dhe zgjidhje, duke ngjallur emocione dhe duke çuar në një përvojë katartike të publiku (Scully & Seger, 2003).

Në përmbledhje, roli i emocioneve në tregim është i shumanshëm, duke ndikuar mbi angazhimin, ruajtjen e kujtesës, formimin e qëndrimit, transmetimin kulturor dhe përvojën emocionale të publikut. Duke integruar në mënyrë efektive emocionet në narracione, rrëfimtaret e rrisin ndikimin e tyre dhe lidhen dhe kuptohen në një nivel më të thellë me publikun e vet.

Fjalët nuk janë vetëm një sërë shkronjash të bashkuara me bojë, nuk janë kombinime të zakonshme shkronjash. Fjalët janë shenja. Fjalët janë aktivizues. Fjalët janë mbartës të kuptimit, mbartës të ndjenjave dhe katalizatorë të ndryshimeve (Tausczik, Y. R., & Pennebaker, J. W., 2010). Një fjalë mund të nxitë furtunë emocionesh, duke e ndryshuar drejtimin e bisedës, të marrëdhënieve ndërnjëzore, madje edhe të jetës.

Fjalët me ngjyrim emocional në letërsi mund të gjenden edhe si “fjalë emocionale” ose “fjalë të ngarkuara”. Në thelbin e vet, këto fjalë ngjallin ndjenja, aktivizojnë reagime dhe e “valëzojnë” botën tonë të brendshme (Gendron, M., Lindquist, K. A., Barsalou, L., & Barrett, L. F., 2012). Këto janë shprehje ose fraza të ngarkuara me kuptim nënkontekstual, që mbartin një paketë emocionesh shtesë që shkon përtej semantikës së tyre. Fjalët me ngjyrim emocional i shtojnë intensitetet shtesë një bisede ose teksti të shkruar. Jo vetëm që i dëgjojmë apo lexojmë vetëm, ato shkojnë më tej dhe ndikojnë mbi mendimet dhe emocionet tona. Kjo është fuqia e këtyre fjalëve.

Si rrjedhim, nuk është për t'u habitur që liderët, profesionistët e marketingut dhe specialistët e komunikimit të llojeve të ndryshme i kushtojnë vëmendje rezonancës emocionale të gjuhës së tyre, duke e përdorur atë që të krijojnë reagime të caktuara mbi publikun e tyre, duke manipuluar në mënyrë delikate ndjenjat dhe opinionet. Siç thuhet shpesh, nuk ka rëndësi vetëm ajo që thua, por edhe mënyra se si e thua, dhe në këtë rast, “si” i referohet pikërisht ngjyrimin emocional të fjalëve që përdoren.

Fjalët me ngjyrim emocional mund të kategorizohen në lloje të ndryshme, sipas qëllimit që kërkojnë të arrijnë në komunikim. Kështu, një lloj janë fjalët e *emocioneve pozitive*. Këto janë ato që sjellin buzëqeshje, ngrohin zemrat dhe përhapin gëzim. Kjo kategori përfshin fjalë si “dashuri”, “lumturi”, “eksitim”. Kur përdoren me sinjeritet, ato kanë fuqinë të ngrenë shpirtin, të përforcojnë besimin dhe të fuqizojnë lidhjen. Në anën e kundërt janë fjalët e *emocioneve negative*. Fjalët si “zemërim”, “trishtim”, “frikë” dhe “zhgënjim” i përkasin këtij grupi. Ka edhe fjalë me emocione neutrale. Këto janë fjalë si “surprizë”, “kuriozitet” ose “kënaqësi” dhe ato mund të marrin konotacione pozitive ose negative në varësi të kontekstit. Së fundi, ka edhe *fjalë emocionale që varen nga konteksti*. Këto fjalë mund të duken neutrale në shikim të parë, por ato mund të kenë peshë të madhe emocionale në situata të caktuara. Për shembull, “shtëpia” mund të jetë një emër i thjeshtë për një person, por për një tjetër, mund të ngjallë ndjenja të forta rehati, nostalgji, madje edhe mallëngjim.

Por, si funksionojnë këto fjalë dhe pse janë kaq efektive? Gjuha është më shumë se një mjet komunikimi. Ai është gjithashtu një mjet nëpërmjet të cilit kryhet ndikim, bindje dhe frymëzim. Në ndërveprimin njëzëor, ato shërbejnë si fije që na lidhin me njëri-tjetrin (Tausczik & Pennebaker, 2010). Si çdo mjet, ato mund të përdoren si për qëllime konstruktive ashtu edhe për qëllime shkatërruese. Ndërsa ato kanë fuqinë për të frymëzuar, ngushëlluar dhe lidhur, ato mund të përdoren gjithashtu si armë për të manipuluar, lënduar ose përçarë. Kur ndërtohen aftësi për të kuptuar gjuhën emocionale, nuk duhet harruar ndjenja e përgjegjësisë dhe etikës për përdorimin e këtyre mjeteve të fuqishme.

Mënyra se si i përpunojmë fjalët me ngjyrim emocional nuk është universale. Dallimet kulturore luajnë një rol të rëndësishëm në mënyrën se si e perceptojmë gjuhën emocionale. Një fjalë që mund të jetë thellësisht prekëse në një kulturë mund të jetë krejtësisht neutrale në një tjetër. Ky variacion kulturor në përdorimin e fjalëve me ngjyrim emocional e nxjerr në pah rëndësinë e inteligjencës emocionale në komunikim. Aftësia për të kuptuar shenjat emocionale të gjuhës, për të përshtatur siç duhet fjalët që do të përdoren dhe për të përdorur në mënyrë të përshtatshme nuancat e konteksteve të ndryshme kulturore është një aftësi e vlefshme në botën tonë globalizuese.

FUQIA E FJALËVE ME NGJYRIM EMOCIONAL NË DISKURSION POLITIK

Mund të vihet re se çdo fjalim apo debat politik është i mbushur me fjalë me ngjyrim emocional (Gennaro, G. & Ash, E., 2021). Ato janë përzgjedhur me zgjuarsi që të rezultojnë me emocionet e votuesve dhe që të formësojnë perceptimet e tyre. Fjalët si “liri”, “drejtësi”, “tirani” ose “shtypje” dridhen me peshën e tyre emocionale nënkontekstuale. Këto fjalë janë shumë më ndikuese se ato neutralet sepse ngjallin reagime emocionale. Ato synojnë të manipulojnë opinionin publik, të provokojnë reagime të forta emocionale dhe t'i shërbejnë një agjende specifike. Politikanët shpesh u kushtojnë vëmendje të veçantë këtyre fjalëve të fuqishme kur përgatisin fjalimet dhe mesazhet e tyre që të tërheqin emocionet e publikut (D'Ambrosio, 2022). Si rrjedhim, shumë shpesh i përdorin frikën, shpresën, zemërimin ose krenarinë. Kështu, dëgjojmë fjalime nga politikanë në të cilat ata e përshkruajnë një veprim të caktuar si “heroik” në vend të “guximtar”, ose një politikë të re si “revolucionare” në vend të “e rëndësishme”.

Nga ana tjetër, përdorimi i tepërt i këtyre fjalëve në politikë ndonjëherë mund të mjegullojë kufirin midis së vërtetës dhe perceptimit. Në këtë mënyrë krijohet një atmosferë sensacionale dhe mund ta dëmtojë kredibilitetin e politikanit.

Kuptimi i rolit të fjalëve me ngjyrim emocional në politikë (ndikimi i tyre në evokimin e emocioneve të caktuara, inkuadrimit të debateve, ndikimin në gjykimet publike) dhe njohja e tyre në fjalime dhe mesazhe mundëson një kuptim më të mirë të retorikës politike dhe marrjen e vendimeve më të informuara.

DALLIMI DHE ANALIZA E FJALËVE ME NGJYRIM EMOCIONAL

Këto fjalë janë ndërthurur me shumë mjeshtëri në narracione që të shkaktojnë reagime specifike. Aftësia për t'i njohur ndihmon në zbulimin e fjalimit të njëanshëm dhe të menduarit kritik. Më shpesh, këto fjalë janë ndërthurur në një gjuhë provokuese që përdor fjalë ose fraza të përdorura qëllimisht për të ngjallur emocione të forta, si “karrem” ku njerëzit “do të bien”. Gjithashtu, këto fjalë shumë shpesh i theksojnë ekstremet, kështu që deklaratat përmbajnë fjalë si “më i miri” ose “më i keqi absolut”. Kur fjalitë, fjalimet dhe deklaratat *ngjallin ndjenja më shumë sesa përcjellin fakte*, ka të ngjarë që të përdorin fjalë me ngjyrim emocional. Si rrjedhim, duhet të merret parasysh gjithmonë motivi i përdorimit të fjalëve emocionale, të peshohen argumentet në deklaratë dhe a ka fakte që i mbështesin argumentet. Mandej, duhet mbajtur gjithmonë parasysh konteksti në të cilin përdoren këto fjalë – a justifikohet përdorimi i një fraze apo fjale të caktuar në kontekstin e dhënë. Sigurisht, jo çdo fjalë që ka peshë emocionale duhet të injorohet. Emocionet mbartin informacione të rëndësishme, por ato nuk duhet të turbullojnë gjykimin.

PËRSOSJE E NJOHURIVE DHE PËRDORIMI I FJALËVE ME NGJYRIM EMOCIONAL

Që të shfrytëzohet fuqia e fjalëve me ngjyrim emocional, nevojitet të zhvillohet inteligjenca emocionale, domethënë aftësia për të njohur, kuptuar dhe kontrolluar ndjenjat e veta dhe të tjerëve. Duke përmirësuar aftësitë për t'i përdorur këto fjalë në mënyrë efektive dhe duke i përdorur ato me përgjegjësi dhe ndjeshmëri, krijohet një komunikim më kuptimplotë dhe me ndikim në të gjitha sferat e jetës.

Gjatë komunikimit, njeriu duhet të ketë parasysh peshën emocionale të fjalëve, t'i përzgjedhë me kujdes, t'i përdorë me mençuri dhe në këtë mënyrë të stimulojë emocione të tjerët që çojnë në lidhje dhe mirëkuptim midis njerëzve.

1.3. AKTORËT POLITIKË DHE NARRACIONET E DËMSHME

Aktorët politikë si krijues, ndërtues dhe prodhues të narracioneve politike formojnë dhe kornizojnë historitë ose narracionet që i përcaktojnë çështjet, ngjarjet, politikat dhe identitetet politike. Prandaj, narracionet politike janë një mjet vërtet i fuqishëm, por edhe legjitim për aktorët politikë që të angazhojnë, informojnë dhe mobilizojnë publikun. Megjithatë, pikërisht për shkak se narracionet mund të formojnë besime, qëndrime dhe sjellje, ato mbajnë përgjegjësi të rëndësishme etike. Nëse përdoren në mënyrë të pakujdesshme ose manipuluese, narracionet politike mund të bëhen të dëmshme dhe më pas të bëhen të rrezikshme, pasi ato kanë fuqinë të përçajnë shoqërinë, të thellojnë mosbesimin dhe madje të nxisin konflikt.

Në komunikimin politik, ekziston konsensus për nevojën e ekzistimit të kulturës politike të korrektësisë dhe respektimit të të gjithë pjesëmarrësive në procesin e komunikimit. Ky konsensus pasqyrohet në dokumente të shumta (deklarata, rekomandime, kode) që përcaktojnë standardet dhe parimet në komunikimin politik, kurse këto nga ana e tyre janë bazë për përcaktimin dhe kuptimin e narracioneve të dëmshme dhe njohjen e tyre në diskursin politik².

OBLIGIMI PËR KOMUNIKIMIN ETIK DHE RUAJTJEN E LIRISË SË FJALËS

Funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar, si edhe funksionarët partiakë, kanë detyrimin të praktikojnë etikën e komunikimit në komunikimin e tyre me publikun dhe median. Kjo nënkupton se qasja që do të aplikojnë është: “një qasje që zbatohet në punë dhe që nënkupton kryerjen e detyrave të punës me ndershmëri, ndërgjegje, në kohë dhe me përgjegjësi”. Duke i respektuar standardet profesionale dhe të drejtat e njeriut të personave të përfshirë në punë, zbatohen politika dhe parime me të cilat respektohen parimet morale të sjelljes etike në procesin e punës” (Instituti për studime të komunikimit, 2023b).

Disa nga partitë politike britanike dhe gjermane kanë statute dhe kode etike që i përcaktojnë parimet e përgjithshme të integritetit, ndershmërisë dhe etikës, në përputhje me politikat specifike të partive.

Këshilli i Evropës gjithashtu e mbështet lirinë e fjalës, të mbrojtur në Vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas të cilës liria e fjalës përfshin lirinë që të kritikohet dhe të tregohen informacione që mund të ofendojnë, shokojnë ose shqetësojnë shtetin ose cilindo pjesë të popullsisë, të cilat janë të nevojshme për “ekzistencën e pluralizmit, tolerancës dhe shpërhapjes së mendimit pa të cilin nuk ka shoqëri demokratike” [Liria e Shprehjes Globale (Universiteti Kolumbia), n.d.]. Kufizimet e lirisë së fjalës janë të mundshme vetëm nëse plotësohen tri kushte: a) të parashikuara me ligj; b) vetëm nëse mbron një qëllim legjitim, për shembull të drejtat e të tjerëve; c) vetëm nëse është e nevojshme në një shoqëri demokratike (Article 19, 2015).

Neni 19 i Deklaratës Universale për të Drejtat e njeriut përcakton qartë se çdokush ka të drejtën e mendimit dhe shprehjes, ku kjo e drejtë e përfshin edhe lirinë e përfaqësimit të një mendimi të caktuar, si edhe lirinë për kërkim, dhënie dhe marrje të informacioneve dhe ideve nëpërmjet mediave (United Nations, n.d.).

2 [Joint Declaration on Freedom of Expression and Elections in the Digital Age; The 2022 Code of Practice on Disinformation; Recommendation CM/RecChS \(2025\) 15 on the application of the European Social Charter by North Macedonia with respect to Article 6§4](#); Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2011. [Kodeksi etik për nëpunësit publik](#)

Çdo individ ose grup ka të drejtë të shprehë pikëpamjet, opinionet dhe idetë e tij nëpërmjet cilësdo medie, duke përfshirë libra, gazeta, revista, radio, televizion, film dhe dokumente elektronike në rrjetet kompjuterike, pa frikë nga hakmarrja, censura apo sanksionet ligjore. Kjo është gjithashtu një e drejtë themelore e çdo shoqërie të lirë, pa të cilën gazetarët, shkencëtarët dhe çdo qytetar nuk mund të kryejnë rolin e tyre jetik në shpërhapjen e njohurive të reja (Instituti për studime të komunikimit, 2023^e).

Prej këtyre obligimeve për etikë në komunikim del parimi i komunikimit etik dhe ruajtjes së lirisë së fjalës.

NDALIMI I PËRDORIMIT TË GJUHËS SË URREJTJES DHE FJALËS DISKRIMINUESE

Komiteti i Ministrave i Këshillit Evropian, e përkufizon *gjuhën e urrejtjes* si shprehje që nxisin, nxisin, shpërhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash të caktuar ose i denigrojnë ata në bazë të karakteristikave ose statusit të tyre personal ose të atribuar si raca, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, mosha, paaftësia, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual (Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për luftimin e gjuhës së urrejtjes, 2022³).

Në vendimet e Këshillit të Evropës, nëpunësit publikë, veçanërisht ata në pozita udhëheqëse, nuk duhet të përfshihen ose të mbështesin gjuhën e urrejtjes. Politikanët duhet të promovojnë kulturë të respektimit të të drejtave të njeriut në publik, të dënojnë qartë gjuhën e urrejtjes, duke respektuar lirinë e fjalës (Council of Europe, 2022). Shtetet anëtare të OSBE-së gjithashtu angazhohen që ta parandalojnë gjuhën e urrejtjes, si dhe manifestime të tjera të “nacionalizmit agresiv, racizmit, shovinizmit, ksenofobisë, antisemitizmit, ekstremizmit të dhunshëm, si dhe diskriminimit të bazuar në fe ose besim” (OSBE, 2003).

Partive politike u bëhet thirrje të miratojnë kode sjelljeje për kandidatët/funksionarët e tyre që do të përcaktojnë standardet minimale për respektimin e parimit të mosdiskriminimit, ndalimin e shpërhapjes së urrejtjes dhe kufizimin e të drejtave të njeriut. Mandej, atyre u kërkohet të punojnë në iniciativa ndërpartiake që fokusohen në përmirësimin e tolerancës, parandalimin e diskriminimit, nxitjen e mirëkuptimit ndërkulturor, përfshirjen sociale dhe respektin për diversitetin (UNHRSP, OSBE, OAS, ACHRP, 2021). Kodet e sjelljes së partive politike në Gjermani dhe në Mbretërinë e Bashkuar përmbajnë dispozita që kanë të bëjnë me antidiskriminimin, antibulingun dhe ngacmimin, tolerancën ndaj diversitetit, respektimin e dinjitetit njerëzor dhe lirinë e njeriut. Për parimet e mosdiskriminimit flet edhe Kodi i Etikës së LSDM-së, ku nëpërmjet shembujve renditen disa baza për diskriminim, promovim të respektit të ndërsjellë me qytetarët, përmbajtje nga gjuha e urrejtjes dhe sjellje etike.

Në Strategjinë e komunikimit të Qeverisë është vendosur qartë se përmbajtjet që mund të jenë ofenduese për individët ose një grup të caktuar qytetarësh nuk publikohen apo shpërndahen. Mandej, Kodi i etikës për nëpunësit publikë e thekson parimin e barazisë së partive politike, sipas të cilit nëpunësit publikë duhet t'i trajtojnë partitë politike në mënyrë të barabartë dhe të mos i nënshtrohen diskriminimit mbi baza të ndryshme.

Nga këto ndalime për përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe të gjuhës diskriminuese lind parimi i mospërhapjes së gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës diskriminuese.

3 Këshilli i Evropës, 2023. [Lufta kundër gjuhës së urrejtjes](#)

OBLIGIMI TË JENË TRANSPARENTË DHE NË DISPOZICION TË MEDIAVE

Për shkak të përgjegjësisë së veçantë shoqërore që e kanë politikanët, kandidatët për funksione dhe funksionarët e zgjedhur e të emëruar, janë të detyruar të ruajnë një nivel të lartë transparence përpara publikut dhe mediave për çështjet me interes publik. Shtetet duhet të sigurojnë që media të ketë qasje të papenguar në burimet zyrtare, si dhe të kandidatët për funksione publike, por edhe të sigurojnë që të mos ketë pengesa për shpërndarjen e informacionit dhe ideve, edhe në rastet e pandemisë (UNHRSP, OSBE, OAS, 2020). Përveç kërkesave ligjore për transparencë në financimin dhe shpenzimet në fushatat politike gjatë zgjedhjeve, politikanët duhet të jenë transparentë edhe në lidhje me shpenzimin e parave në platformat sociale, siç thuhet në shumë deklarata të përbashkëta.

Subjektet politike janë të detyruara të praktikojnë “transparencë aktive” në punën e tyre (“transparenca aktive” nënkupton publikimin e informacionit me iniciativën e vetë të institucioneve, pa u paraqitur asnjë kërkesë për qasje në ato informacione⁴) dhe të publikojnë materiale që janë në interes për publikun, si fjalime, qëndrimet politike që i përfaqësojnë, deklarata, raporte të konferencave për shtyp, reagime ndaj kundërshtarëve politikë, si dhe të sigurojnë persona për kontakt për komunikim me gazetarët. Partitë politike, gjithashtu, duhet të vënë në dispozicion të publikut dokumente dhe të dhëna të rëndësishme, si statuti, struktura e partisë, procesi i vendimmarrjes, raportet financiare dhe dokumente të tjera relevante për punën e tyre.

Nga ky obligim del parimi i transparencës.

OBLIGIMI TA PËRFAQËSOJNË INTERESIN PUBLIK NË KOMUNIKIM

Politikanët dhe nëpunësit publikë përveç që përfaqësojnë institucion (identitet kolektiv), kanë edhe identitet individual (personal). Kur komunikojnë me publikun, politikanët dhe nëpunësit publikë duhet të jenë të kujdesshëm që të mos i interpretojnë pikëpamjet e tyre personale si pikëpamje të organizatave të cilave u përkasin ose të institucioneve që i përfaqësojnë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për nëpunësit publikë, të cilët duhet të jenë të paanshëm në punën e tyre.

Ekzistenca e një konflikti interesi midis politikanëve dhe nëpunësve publikë nuk mund të shmanget, ndaj duhet të jetë transparent dhe i menaxhuar në mënyrë të duhur. Sipas Kodit të sjelljes për deputetët evropianë, konflikt i interesave ekziston kur një deputet ka interesa personale që mund të ndikojnë në mënyrë jo të duhur në vendimmarrjen e deputetit, ndërsa nuk ka konflikt interesi ku nga vendimi do të përfitojë edhe deputeti si pjesë e publiku i gjerë ose si pjesë e një grupi më të madh qytetarësh (Annex of EP Code, 2017).

Në Kodin etik të nëpunësve publikë të miratuar nga Qeveria e RM-së, nëpunësit publikë kanë për obligim që detyrat e tyre të punës t'i kryejnë në mënyrë politikisht neutrale, të mos përfaqësojnë bindjet e tyre politike në kryerjen e detyrave të tyre të punës dhe as të kryejnë veprimtari politike që mund të ndikojnë në besimin e qytetarëve në aftësinë e tyre për kryerjen e detyrave të punës në mënyrë të paanshme (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 133, 2011).

4 Ekziston edhe bazë ligjore për transparencën aktive të institucioneve, e cila gjendet para së gjithash në Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat Publike, por edhe në një sërë ligjesh të tjera, si Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Buxhetet, Ligji për Borxhin Publik, Ligji për Prokurimin Publik, Ligji për Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale etj. Përveç rregullores, transparenca aktive buron edhe nga praktika e mirë dhe institucionet kanë detyrime që në mënyrë proaktive të publikojnë informacione dhe nga planet aksionale në suazat e iniciativës së Partneritetit për Qeverisje të Hapur. <https://aktivnatransparentnost.mk/>

Kodi i sjelljes për nëpunësit qeveritarë për marrëdhënie me publikun i obligon të jenë të paanshëm, të ruajnë objektivitetin dhe t'i vënë detyrimet e shërbimit përpara interesave personale. Në të përcaktohen drejtimit që tregojnë përcaktimin dhe kufizimin e përdorimit të profileve private të rrjetet sociale të nëpunësve, me qëllim që të mos dëmtohet reputacioni i institucionit dhe të mos merren pikëpamjet personale të nëpunësve si pikëpamje të institucionit.

Sipas qeverisë britanike, nëpunësit publikë përgjegjës për komunikimin duhet të jenë gjithmonë të pranishëm dhe të gatshëm që t'i shpjegojnë politikën dhe mendimet e Qeverisë apo ministrive që i përfaqësojnë. Ata duhet të flasin në cilësinë zyrtare, në vend që të citohen jozyrtarisht. Komunikimi duhet të bazohet në fushëveprimin e punës së Qeverisë. Duhet të jetë objektiv dhe shpjegues, kurse jo i njëanshëm, që të mos perceptohet si partiak-politik. Në të njëjtën kohë, komunikimi që buron nga Qeveria nuk duhet të përdoret ekskluzivisht për arritjen e qëllimeve partiake-politike. Nëpunësit nuk duhet t'i mbrojnë politikën partiake, as t'i sulmojnë politikën apo qëndrimet e partive opozitare (përveç kur është e nevojshme për t'iu përgjigjur një pyetjeje specifike). (Civil Service. 2010; Government Communication Service Propriety Guidance, 2014, 2022).

Nga ky obligim që ta përfaqësojnë interesin publik në komunikim del parimi i profesionalizmit dhe paanësisë në komunikimin me përfaqësuesit qeveritarë.

OBLIGIMI TË MOS JENË BURIM DHE TË MOS SHPËRHAPIN DEZINFORMACIONE DHE INFORMACIONE TË PAKONTROLLUARA

Fjalimi manipulues, i cili përmban dezinformacione, mund të ndikojë seriozisht mbi proceset zgjedhore dhe në përgjithësi mbi proceset demokratike nëpërmjet krijimit të të pavërtetave dhe sulmeve të pabaza mbi personalite me të cilat zvogëlohet besimi në procesin zgjedhor dhe në institucionet e përgjegjshme. Krijimi dhe shpërndarja e dezinformatave nuk është krim, por është joetik dhe mund të jetë jashtëzakonisht i dëmshëm për proceset demokratike të një shteti. Parimet e përgjithshme të integritetit, ndershmërisë dhe etikës (në dokumentet e analizuar) janë në kundërshtim me çdo përpjekje të koordinuar ose të pakoordinuar për përdorimin e dezinformatave nga politikanët dhe funksionarët publikë, prandaj është e rëndësishme që politikanët dhe funksionarët publikë të mos përdorin dezinformata dhe të ndajnë vetëm informacione të verifikuara në komunikimin e vet.

Në parimet bazë për shtetet që përcaktohen në Deklaratën e Përbashkët të 2021 mbi Lirinë e Shprehjes për Politikanët dhe Funksionarët Publikë, ka udhëzim që shtetet (dhe partitë) të mos angazhohen kurrë në financimin ose koordinimin e sjelljeve joautentike ose operacioneve të tjera në internet që kanë synim të ndikojnë mbi të gjithë ose mbi një pjesë të publiku për qëllime partiake-politike. Ky dokument i obligon shtetet të vendosin masa disiplinore që do të zbatohen ndaj funksionarëve publikë që krijojnë, shpërndajnë, sponsorizojnë, inkurajojnë ose ndajnë postime që ata e dinë ose duhet të dinë se janë të rreme (UNHRSP, OSBE, OAS, ACHRP, 2021).

Gjithashtu, nuk lejohet krijimi dhe përdorimi i profileve të rreme, marrja e profileve apo përdorimi i boteve për shpërhapjen e informacioneve ('bot-driven amplification'), operacionet me hakim dhe shpalljen e informacioneve ('hack-and-leak operations'), prezantimi i rremë ('impersonation'), video malicioze të ndryshuara – dipfejk ('malicious deep fakes'), angazhim i paguar i përdoruesve, mesazhe jotransparente me pagesë ose promovim nga influenserë, krijim dhe përdorim i profileve që janë pjesë e sjelljes së koordinuar joautentike, sjelljes për interes që ka të bëjë me zmadhimin artificial të spektrit apo mbështetjes së perceptuar publike për dezinformacione të caktuara (European Commission, 2022).

Disa parti politike britanike dhe gjermane kanë statute dhe kode etike që përcaktojnë parimet e përgjithshme të integritetit, ndershmërisë dhe etikës, në përputhje me politikën specifike të partive. Në të njëjtën kohë, qeveria britanike ka nxjerrë manual specifik për trajtimin e dezinformatave

(Government Communication Service, 2021). Qeveria e RMV-së ka përcaktuar në strategjinë e saj të komunikimit që funksionarët qeveritarë për marrëdhënie publike të qeverisë duhet të thonë të vërtetën dhe të jenë objektivë. Në këtë dokument thuhet se nuk publikohen informacione të pasakta apo spekulime që mund të mashtrojnë qytetarët.

Nga obligimi i aktorët politikë të mos jenë burim dhe të mos shpërhapin dezinformacione dhe informacione të pakontrolluara del parimi i komunikimit të bazuar në dëshmi.

1.4. MEDIAT DHE NARRACIONET E DËMSHME

Mediat luajnë rolin qendror në transmetimin, përforcimin dhe ndonjëherë edhe krijimin e narracioneve politike. Ato shërbejnë si një urë lidhëse midis aktorëve politikë dhe publikut, duke ofruar korniza të caktuara për historitë që i përcjellin, të cilat në mënyrë të pamohueshme ndikojnë në mënyrën se si njerëzit i kuptojnë dhe reagojnë ndaj ngjarjeve, politikave dhe ideologjive politike. Për shkak se mediat arrijnë një publik të gjerë dhe shërbejnë si burime parësore informacioni, qasja e tyre ndaj narracioneve politike mund të ndikojë ndjeshëm mbi mendimin publik dhe mbi kulturën politike. Si rrjedhim, respektimi i standardeve profesionale gazetareske është imperativ.

Baza për përcaktimin e narracioneve të dëmshme të transmetuara nëpërmjet mediave dhe mosrespektimin e mundshëm të standardeve profesionale janë rregulloret në fuqi që rregullojnë punën e mediave (neni 16 i Kushtetutës së RMV-së, Ligji për media, Ligji për audio dhe shërbimet mediatike audiovizuale, Ligjin për parandalimin e diskriminimit, aktet nënligjore dhe rregulloret e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale), si dhe sipas parimeve dhe udhëzimeve të shoqatave profesionale, organizatave mediatike dhe institucioneve arsimore): Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM, n.d.); Udhëzimet për raportim etik në mediat onlajn (Aplikimi i Kodit të gazetarëve në sferën onlajn) të Këshillit për etikën e mediave në Maqedoni (CEMM, 2021); vlerat, standardet profesionale dhe praktikat e përshkruara në Doracakun për gazetari me interes publik të Institutit për studime të komunikimit (Šopar et al., 2016); Doracku për gazetarët dhe redaktorët *Dallo dhe parandalo: Mjetet gazetareske për ballafaqim me dezinformimin* nga Instituti për studime të komunikimit [Trajkoska (ed.), 2023].

Kështu, në këtë pjesë janë dhënë ligjet, kodet dhe standardet që paraqesin një sublimim të burimeve dhe literaturës referuese vendase dhe ndërkombëtare, lidhur me rregullimin dhe vetërregullimin e punës së mediave. Ajo që është thelbësore në këtë drejtim është se kur raportojnë për narracionet e dëmshme politike, nga gazetarët profesionistë pritet që t'u përmbahen vlerave që i përfaqësojnë ato standarde.

Pavarësisht debateve që vazhdojnë edhe sot mbi vlerat themelore mbi të cilat bazohet profesioni i gazetarisë, ka ende *konsensus se pavarësia, autonomia, paanshmëria, saktësia, transparenca dhe konstruktiviteti* janë postulatet kryesore.

Pavarësia është një nga vlerat kryesore në gazetari dhe në ballafaqimin me dezinformatat. Kjo do të thotë se gazetaria nuk ndikohet nga interesat dhe agjendat e jashtme, siç janë interesat politike apo të korporatave. Kjo supozon se gazetarët nuk mashtrohen nga burimet, nuk frikësohen nga pushteti ose nuk komprometohen nga interesat vetjake. Në një nivel më të thellë - pavarësia e shpirtit dhe mendjes dhe kuriozitetit intelektual, i ndihmon gazetarët të shikojnë përtej klasës së tyre ose statusit të tyre socioekonomik, përkatësisë etnike, fesë, gjinisë ose egos së tyre. Gazetaria e pavarur është një pjesë thelbësore e demokracisë.

Me pavarësinë ndërlihet *autonomia*. Ajo ekziston në tri nivele të ndryshme analitike: i pari është niveli institucional, i cili i referohet gazetarisë në tërësi, i pavarur nga institucionet e tjera shoqërore, si shteti dhe tregu; i dyti është niveli individual, i cili u referohet vetë gazetarëve që kanë fuqi krijuese diskrecionale dhe fuqi vendimmarrëse në punën e tyre; dhe i treti është niveli organizativ, i cili i referohet nivelit të vendit të punës, ku preferencat individuale shpesh ndikohen nga kufizimet institucionale. Në përgjithësi, hulumtimi gazetaresk është fokusuar më së shumti në analizimin e autonomisë në nivel institucional dhe individual, kurse më pak në nivel organizativ.

Paanshmëria gazetareske më shpesh përkufizohet si shprehje ose përdorim i fakteve pa shtrembërim për shkak të bindjeve, paragjykimeve, ndjenjave ose paragjykimeve personale. Në kohët më të fundit, paanshmëria është konsideruar kryesisht një metodë e të kuptuarit. Kjo përfshin respektimin e fakteve, konsultimin me burime të shumta, parashtrimin e pyetjeve të vështira, paraqitjen e provave, të jesh mendjehapur dhe të bëhet i gjithë procesit sa më transparent. Paanshmëria nuk do të thotë që duhet paraqitur një perspektivë krejtësisht neutrale apo e paanshme, por i referohet shprehimisht metodës së punës, e cila duhet të jetë e paanshme.

Gazetarët nuk mund të përfaqësojnë “të vërtetën e vetme”, por të jesh i saktë dhe të kuptohen si duhen faktet mbetet një parim kyç në gazetari. *Saktësia* nënkupton paraqitjen e informacionit që është i vërtetë; është themeli mbi të cilin ndërtohet gjithçka tjetër: lajmi, konteksti, interpretimi, debati. Në ballafaqimin me dezinformimin, është thelbësore të sigurohet që informacioni i paraqitur të jetë i saktë dhe i mbështetur me dëshmi. Kjo përfshin kontrollimin e fakteve dhe verifikimin e burimeve të informacionit, si dhe pranimin e hapur të cilado paqartësive ose kufizimeve në informacionet.

Transparenca nënkupton të jesh i hapur dhe i sigurtë në lidhje me procesin gazetaresk dhe të çdo konflikti potencial të interesave, si dhe zbardhja e cilado lidhjeve apo paragjykimeve të cilat mund të ndikojnë mbi informacionet e prezantuara. Kjo përfshin transparencë në lidhje me burimet e informacionit dhe pranimin e cilado paragjykimeve apo kufizimeve potenciale në informacion, transparencën në lidhje me financimin, transparencën në lidhje me metodën e përdorur dhe zgjedhjet kryesore të bëra, transparencën në lidhje me gabimet ose lëshimet e rëndësishme. Transparenca theksohet si një mënyrë efektive për të luftuar dezinformimin, si dhe për të kundërshtuar rënien e vazhdueshme të besimit dhe kredibilitetit në media.

Konstruktiviteti nënkupton paraqitjen e informacionit në një mënyrë që është e dobishme dhe produktive, në vend që të jetë polarizuese ose e dëmshme. Kur bëhet fjalë për dezinformimin, është e rëndësishme të promovohet diskursi konstruktiv dhe të inkurajohet mendimi kritik për zgjedhjet e mundshme të problemeve të përbashkëta. Gazetaria konstruktive është qasje që synon t'i ofrojë publikut pamje të drejtë, të saktë dhe të kontekstualizuar të botës, pa e mbitheksuar negativin dhe atë që është e gabuar. Mund të shihet si përgjigje ndaj polarizimit, sensacionalizmit dhe anësisë ndaj negativitetit.

Këto vlera themelore janë shndërruar në **standarde për gazetarinë** që japin besim – gazetari kredibile.

Standardet kryesore të gazetarisë kredibile në lidhje me *burimet* janë:

- **Verifikimi:** Verifikimi është thelbi i gazetarisë së besueshme; respektimi i fakteve dhe e drejta e publikut që ta dijë të vërtetën është obligimi i tij i parë. Prandaj të gjithë elementët kryesorë të rrëfimit, si pohimi i burimeve, emrat, datat dhe vendet, faktet dhe numrat, duhet të kontrollohen gjithmonë (edhe dyfish) dhe gjithmonë kur ekziston mundësia të përdoren më shumë burime dhe të gjitha dëshmitë duhet të ekuilibrohen në mënyrë transparente me mendje të hapur.

- **Gjithëpërfshirja:** Për gazetari kredibile përcaktimi i drejtë i fakteve është i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm Edhe faktet e vërteta mund të tregojnë një histori të paplotë dhe, si rrjedhojë, histori të gabuar. Prandaj, të gjitha informacionet e rëndësishme duhet të përfshihen në histori dhe duhet të përfshihen të gjitha faktet dhe pikëpamjet përkatëse.
- **Besueshmëria e burimeve:** Gazetarisë kredibile së pari i nevojiten burime të besueshme. Prandaj, sa herë që është e mundur, përdoret informacion i dorës së parë, nga vëzhgimi personal. Nëse nevojiten burime indirekte, ato duhet të njihen dhe të konsiderohen të besueshme. Duhet gjithashtu të merret parasysh a e ka marrë vetë burimi drejtpërdrejt informacionin dhe a ka burimi informacione më të reja.
- **Më shumë se një burim:** Për gazetarinë kredibile historitë nuk duhet të bazohen vetëm mbi një burim të vetëm, ato duhet të jenë gjithmonë të drejta, kështu të gjithë personave që janë përfshirë u jepet kohë e mjaftueshme për dëgjim të drejtë.
- **Thirrja e burimeve/mbrojtja e burimeve:** Gazetaria e besueshme është transparente për burimet, por, nëse nevojitet, edhe i mbron. Mandej, gazetaria e tillë anashkalon përdorimin e burimeve të lëndueshme, si persona me kufizime mentale, fëmijë dhe viktime të krimeve, fatkeqësive apo katastrofave.
- **Pagimi/pranimi i parave:** Gazetaria kredibile nuk varet nga stimulimet financiare, e anashkalon gjithmonë pagimin e burimeve të informacioneve, siç anashkalon pranimin e parave nga burimet.

Standardet kryesore të gazetarisë së besueshme në raport me *prezantimin e lajmeve* janë:

- **Anashkalimi i dramatizimeve/rekonstruksioneve:** Gazetaria kredibile i prezanton lajmet në mënyrë të sqartë, citatat janë të sakta dhe precize dhe përdoren gjithmonë në kontekstin të të cilin janë dhënë. Anashkalohet rikonstruktimi dhe dramatizimi në lajme me aktorë pa u thënë kjo.
- **Dallimi midis fakteve dhe mendimeve:** Gazetaria kredibile është më ndryshe se praktikat e tjera mediatike sepse bën dallim midis informacioneve faktive dhe deklaratave normative.
- **Konteksti:** Gazetaria e besueshme i vendos faktet në perspektivë, në kontekst relevant që u jep kuptim.
- **Drejtësi:** Gazetaria kredibile pranon se realiteti nuk është bardhezi, si rrjedhim i vendos se cilat grupe dhe interesam kurse kështu edhe perspektivat, që përfshihen në ngjarje të caktuara ose në zhvillimin e ngjarjeve në lajme.
- **Anashkalim i polarizimit:** Gazetaria e besueshme synon të rrëfejë të gjithë historinë, kurse jo vetëm t'i tregojë ekstremitetet e dy fundeve, të anashkalojë zmadhimin e pikëpamjeve të kundërta apo të konflikteve që të bëhen lajme, të anashkalojë fokusimin vetëm në qëndrimet ekstreme dhe t'u kushtojë vëmendje mjedisit më të gjerë dhe nuancave.
- **Privatësia:** Gazetaria kredibile e respekton integritetin e individëve, privatësinë e tyre.

1.5. NEOLOGJIZMAT NË NARRACIONET POLITIKE

Një nga mënyrat sipas të cilave aktorët politikë përpiqen ta konstruktojnë realitetin politik është përdorimi i neologjizmave në diskursin politik. Neologjizmat politikë krijohen që t'u përgjigjen konteksteve të caktuara politike, sociale dhe kulturore duke siguruar gjuhë të re për përshkrimin e ideve, fenomeneve apo ndryshimeve të reja në shoqëri.

Neologjizmat luajnë një rol të rëndësishëm në narracionet politike, duke e formësuar diskursin publik dhe duke i reflektuar ndryshimet në vlerat shoqërore, ideologjite ose realitetin politik. Këto shprehje, fraza të reja apo fjalë të ripërcaktuara mund të bëhen mjete të fuqishme për paraqitjen e çështjeve të caktuara, krijimin e asociacioneve të reja, thjeshtimin, por edhe "mbushjen" emocionale të çështjeve politike në mënyra që përputhen me agjenda të caktuara politike. Ato mund të krijojnë qartësi, identitet dhe unitet, por gjithashtu mund të çojnë në manipulim, mbithjeshtëzim dhe polarizim. Kur përdoren me përgjegjësi, këto neologjizma mund të pasurojnë diskursin publik dhe të ndihmojnë shoqëritë të ballafaqohen me sfidat e reja. Megjithatë, të pakontrolluara dhe të përdorura në mënyrë të papërgjegjshme, ato mund të shtrembërojnë realitetin dhe të shkaktojnë një sërë pasojash të dëmshme.

ÇFARË JANË NEOLOGJIZMAT?

Neologjizmat janë fjalë të reja në gjuhë, kuptime të reja të fjalëve që tashmë ekzistojnë ose fjalë nga gjuha pasive të cilat marrin kuptime të reja. Arsyet për shfaqjen e neologjizmave janë: koncepte dhe dukuri të reja ose koncepte dhe dukuri të panjohura më parë për të cilat nuk ka fjalë ekzistuese dhe fjalët janë marrë së bashku me konceptin ose fenomenin nga gjuha burimore (p.sh. *botoks*, *monitorim*, *mango*, *softuer* etj.), fjalë të reja për koncepte dhe dukuri tashmë ekzistuese si rezultat i modës, mospërkthimi nga gjuha burimore dhe ndikimi leksikor (*billboard* në vend të 'panosë për reklamim', bençmart për 'pikë referimi, kushti, kriteri', *menaxher* për 'drejtor' etj.), fjalë me kuptim të ripërtërirë, d.m.th. fjalë ekzistuese të cilave u shtohet një kuptim i ri ose fjalë nga fjalori pasiv që përditësohen (*aplikacion* me kuptimin 'formular punësimi', *dosje*, (folder) për organizimin e dokumenteve në kompjuter) etj.).

Shfaqja e neologjizmave është një nga mënyrat kryesore të pasurimit të fondit leksikor të gjuhës maqedonase. Disa përshtaten me sukses në sistemin leksikor, kurse disa të tjera bien. Ato që përshtaten i marrin modele fjalëformuese maqedonase dhe me shtimin e prefikseve, interfikseve dhe sufikseve maqedonase përshtaten tërësisht në sistemin maqedonas.

Okazionalizmat janë fjalë autoriale, individuale të përdorura, përkatësisht neologjizma autoriale. Për dallim nga neologjizmat, të cilët i përkasin ose do të bëhen pjesë e leksikut të gjuhës maqedonase dhe përdoren gjerësisht, okazionalizmat janë vetëm potencial për leksikun. (Gruevska-Maxhoska, 2021: 99-103). Në materialin e analizuar këtu, kryesisht bëhet fjalë për okazionalizma dhe vetëm një numër i vogël janë futur në stilin funksional bisedor, pa potencial që të hyjnë në leksikun e gjuhës maqedonase.

Neologjizmat shpërhapen më shpesh nëpërmjet mediave dhe internetit, dhe shumica janë nga gjuha angleze, e cila është lingua franca në botë sot. Subjekti i analizës këtu janë neologjizmat e politikanëve dhe partive politike të transmetuara nëpërmjet faqeve të tyre zyrtare në internet, si dhe nëpërmjet faqeve të tyre zyrtare, përkatësisht profileve në rrjetin social Fejsbuk dhe në kuadër të narracioneve të dëmshme politike.

Aktorët politikë shpeshherë kanë tendencë t'i fshehin qëllimet e tyre dhe kjo është një nga karakteristikat kryesore të diskursit politik, e cila manifestohet në gjuhë me krijimin dhe përdorimin e neologjizmave që të ndikohet mbi ndërgjegjësimin e publikut, në radhë të parë si elektorat, dhe atë të partive politike. Gjuhëtari dhe studiuesi Çi Lu (Luu, 2016) vë në dukje se në politikë, neologjizmat përdoren jo vetëm për të pasuruar fjalorin politik, kurse me të edhe të diskursit politik, por edhe për një kontroll dhe inkuadrim të caktuar të narracionet dhe për të ndikuar tek publiku që t'i përvetësojë dhe përdorë këto fjalë të reja, që më shpesh lidhen me diskreditimin e kundërshtarëve politikë dhe me mohimin dhe/ose talljen e ideologjive të ndryshme politike. Më shpesh ata kanë një simbolikë shumë bindëse ose nuancë emocionale. Ajo thotë se gjuha politike e formëson identitetin emocional të publikut duke i ofruar atij diçka për të qenë pjesë, pra t'i përkasë dhe diçka për të qenë të kujdesshëm, domethënë të mos i përkasin. E thënë thjesht, duhet të vendosni se cilit grup do t'i përkisni kurse nga cilit do të keni frikë dhe do ta sulmoni (ose ne përkundrejt tyre). Si rrjedhim, në varësi se me cilin grup identifikoheni, do të keni tendencë të përdorni stilet e komunikimit të atij grupi.

Në atë kontekst, sfera politike është shumë aktive në formimin e neologjizmave dhe, sipas Veronika Katerminas (Katermina, 2018), për shkak të zhvillimit të vazhdueshëm dhe natyrës aktuale, produktiviteti i saj në këtë kuptim do të rritet, kurse masmediat dhe teknologjitë e reja ka shumë mundësi ta mbështesin shpërhapjen e mëtejshme të këtyre të ashtuquajturave neologjizmave politike. Ajo analizon tri grupe neologjizmesh: 1. *politikanët dhe mbështetësit* (neologjizma kushtuar njerëzve që i përkasin një partie të caktuar ose janë adhurues të disa pikëpamjeve politike); 2. *llojet e qeverisjes* (neologjizma kushtuar llojeve të ndryshme të qeverisjes); 3. *ngjarjet politike* (neologjizma kushtuar proceseve politike).

Sipas Sipas Katermina (2018), tendenca është zakonisht shtimi i prapashtesës - *izëm* kur ndërtohen neologjizma që lidhen me emrat personalë të aktorëve politikë. Për shembull: Bler - *izëm* – ideologjia politike e ish-udhëheqësit të Partisë Laburiste dhe ish-kryeministrit të Mbretërisë së Bashkuar Toni Bler, që pasqyron përkushtimin e dikujt ndaj atyre politikave centriste; Tramp - *izëm* – pasqyrimi i pikëpamjeve dhe deklaratave politike të ish-presidentit të SHBA-së, Donald Tramp, me një dozë komedie; Bush - *izëm* – i lidhur me ish-presidentin e SHBA Xhorxh W. Bush, kurse në kontekstin e fjalëve dhe frazave qesharake apo absurde dhe gabimeve gjuhësore që ai përdor në të folurin publik. E njëjta tendencë është e pranishme edhe në gjuhën maqedonase, kështu që hasen neologjizma: *taçevizëm, zaevizëm* etj., siç do të shihet në analizën e mëtutjeshme.

Në aspektin e llojeve të qeverisjes, shembujt përfshijnë bashkimin e dy fjalëve, të tilla si narcis-o-kraci (sundim nga aktorë politikë tepër egocentrikë) dhe *idio-kraci* (sundim nga të ashtuquajturit aktorë politikë idiotë ose budallenj), kurse në aspektin e ngjarjeve politike shfaqen fjalëformime si: *gr-egzid* dhe *br-egzit* (dalja e mundshme greke dhe britanike nga Eurozona), e cila krijon një prapashtesë të re: -egzit (dalje), që u shtohet shkronjave të para të emrat e shteteve.

Diskursi politik karakterizohet nga një tendencë për të fshehur të vërtetën ose për të zbuluar vetëm gjysmën e saj. Sipas Marine Mchedlishvili (Mchedlishvili, n.d.), përdorimi specifik i mjeteve verbale është një nga instrumentet kryesore në ballafaqimin me kundërshtarët politikë. Me qëllim që të nënlerësojnë ose diskreditojnë kundërshtarin e tyre, politikanët dalin me terma dhe fraza efektive, të cilat më pas vijnë në përdorim të gjerë si nga media ashtu edhe nga publiku. Pothuajse të gjithë termat politikë dikur kanë qenë neologjizma politikë dhe kanë historinë e tyre të krijimit. Siç thotë kjo autore, pranimi i tyre në një gjuhë varet nga shkalla e rëndësisë së konceptit të shënuar nga një neologjizëm i veçantë: ata me rëndësi më të madhe në një kontekst kombëtar/ndërkombëtar bëhen pjesë përbërëse e gjuhës. Ajo që ajo thekson veçanërisht është

se neologjizmat më të suksesshëm politikë përfaqësojnë një ndërlidhje harmonike midis formës së jashtme/të brendshme dhe semantikës, duke i kthyer ato në mesazhe të fuqishme dhe mjete efektive për ndikim. Disa prej tyre bëhen shumë të njohura dhe fillojnë të përdoren e shpërhapen nga mediat dhe publiku si të zakonshme, duke nxitur edhe krijimin e formave të reja. Disa nga këto fjalë kanë jetëgjatësi të shkurtër, por disa mbeten në gjuhë dhe bëhen pjesë e saj. Kjo është veçanërisht problematike kur bëhet fjalë për narracionet e dëmshme, pasi kështu ato hyjnë në përdorim të përditshëm dhe “normalizohen”.

Gjuhëtarja dhe hulumtuesja Irina Esina fokusohet në neologjizmat si “mjet leksikor për manipulim me fjalën që gjeneron konotacione shtesë, e megjullon kuptimin, çon në mashtrim dhe krijon situata konfliktesh” (Essina, 2020: 9). Në këtë kuptim, krijimi i fjalëve të reja mund ta ndryshojë realitetin dhe ta ndryshojë dhe ta kontrollojë procesin e komunikimit, përkatësisht shkëmbimin e informacionit. Mekanizmi kryesor i manipulimit me neologjizmat është sugjerimi, një fenomen që synon bindjen. Në këtë mënyrë, aktorët politikë mund të ndikojnë tek individit, duke futur disa ide iluzore sociopolitike dhe duke përcaktuar norma dhe vlera të ndryshme. Është me rëndësi të veçantë të theksohet se në procesin e përdorimit dhe shpërhapjes së disa neologjizmave rol luajnë edhe masmediat dhe publiku. Fazat e procesit janë si më poshtë: krijohet një neologjizëm politik në rrethana të caktuara; pastaj përdoret në nivele të ndryshme të lobit politik; dhe, në fund, përdoret nga publiku sipas orientimit të supozuar të masmediave (Ismail, 2013).

KONSTRUKSIONI GJUHËSOR I REALITETIT DHE SHPËRHAPJA E INOVACIONEVE LEKSIKORE

Thënë thjesht, konstruksioni social i realitetit lidhet me rëndësinë dhe me konotacionin që i jepet çdo dukurie, çdo ngjarjeje, përkatësisht ndonjë ngjarjeje nga shoqëria dhe si të tilla janë përvetësuar nga përfaqësuesit e asaj shoqërie dhe ato një këtë mënyrë i shohin dhe i përjetojnë ato si të tilla (Serafimosku dhe bashk., 2022).

Sipas Xherald Grejs (Grace, 1987), ndërtimi gjuhësor i realitetit ndodh në dy nivele: 1. gjuha si tërësi pasqyron një realitet të caktuar të ndërtuar dhe realitetet e tilla quhen botë konceptuale; 2. akti i të folurit ose shprehja gjuhësore përfaqëson gjithashtu pasqyrim të një realiteti të caktuar të ndërtuar dhe realitetet e ndërtuara në nivelin e fjalisë quhen ngjarje konceptuale. Për konstruksionin gjuhësor të realitetit është i rëndësishëm folësi, ose dërguesi i mesazhit, i cili vendos dhe zgjedh se çfarë ngjarje do të paraqesë si reale, apo të ndërtojë. Këto ngjarje quhen konceptuale pikërisht sepse varen nga konceptimi i folësit: ai i njeh dhe i strukturon ato.

Gjuha specifike politike i zgjeron informacionet politike duke shprehur në thelb koncepte të caktuara politike (Abdul Ameer Hadi & Muhsin Gharab AL-Majdawi, 2019). Si rrjedhim, neologjizmat janë karakteristikë pikërisht e kësaj gjuhe dhe i referohen burimit të njohjes së botës politike, kështu që ato, në fakt, i japin emrin një ideje të re të caktuar që lind në atë botë politike brenda shoqërisë. Ahfaqen më shpesh kur përditësohen ngjarje të caktuara dhe shoqërohen me ndryshime të caktuara në politikë, ekonomi, kulturë dhe fusha të tjera.

Siç theksojnë këta studiues, politikanët konsiderohen si mjeshtër të krijimit të fjalëve të reja, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore, kur i përdorin ato për të ushtruar një ndikim të caktuar te votuesit në mënyrë të shkathët, kurse më shpesh me fjalë të reja që i referohen karakterit të një kundërshtari politik me synimin për të nënçmuar disa nga cilësitë e tij. Aktorët politikë njëkohësisht u afrohen dhe, në një farë mënyre, i urdhërojnë qytetarët, si përdorues të gjuhës, të miratojnë zëvendësimet e disa fjalëve me fjalë të reja. Përdoruesit e gjuhës, me kalimin e kohës, përpiqen t'i përgjithësojnë këto inovacione, në mënyrë që të ndryshojnë kuptimin e fjalëve që t'i përshtatin për shpërhapje të mëtejshme brenda shoqërisë (Booij, 2005; Saeed, 2009).

Në këtë mënyrë, sipas Marej Edelman (Edelman, 1985), aktorët politikë ndërtojnë në mënyrë strategjike dhe manipuluese një realitet të caktuar gjuhësor që bazohet në ndërtimin e besimeve për kuptimin e disa problemeve, ngjarjeve, krizave dhe ndryshimeve të politikave, kurse strategjia kryesore është të imobilizohen kundërshtarët, kurse të mobilizohet mbështetja nga ithtarët. Kështu, gjuha politike bëhet realitet politik, përkatësisht shoqëror. Nëpërmjet përdorimit të neologjizmave të dëmshme, gjuha politike gjeneron besime se cilët janë “aleatë” dhe cilët janë “armiq”, përkatësisht i përforcon këto besime. Fuqia e një gjuhe të tillë politike nuk buron gjithmonë nga përshkrimet e saj për botën “reale”, por nga rikonstruksioni i ngjarjeve dhe ndodhive të caktuara nga e kaluara dhe referenca e saj për disa gjëra nga e tashmja që nuk janë gjithashtu më të dukshmet, si gjërave të tilla potenciale në të ardhmen që i ndërton në mënyrë strategjike.

Neologjizmat “janë vazhdimësi nga fjalëformime krejtësisht të reja deri në leksema plotësisht të vendosura që janë të njohura për shumicën e bashkësisë gjuhësore” (Würschinger, 2021: 2). Shpërndarja e inovacioneve leksikore është proces që transmeton neologjizma të suksesshme përgjatë kësaj vazhdimësie. Shpërhapja e neologjizmave ndan disa karakteristika me shpërhapjen e inovacioneve kulturore, pasi shpërhapja e fjalëve të reja shpesh është e lidhur ngushtë me shpërhapjen e produkteve dhe praktikave sociokulturore. Sipas Everet Roxhers dhe Flojd Shumejker (Rogers & Shoemaker, 1971), shpërhapja është një lloj i veçantë komunikimi, përkatësisht proces në suazat e të cilit të a.q. inovacionet shpërhapen midis përfaqësuesve të sistemit shoqëror. Kështu, neologjizmat, si inovacion sociokulturor, po bëhen gjithnjë e më të përdorura dhe konvencionale në një bashkësi të caktuar të të folurit. Kështu, për shembull, një fjalë e re shpiket nga një aktor politik, si folës individual, dhe ajo fjalë së pari arrin tek folësit, pra tek bashkësia e folësve të lidhur ngushtë me aktorin politik ose që ndajnë interesa të caktuara që lidhen me fjalë e re të krijuar. Me shpërhapjen e mëtejshme, kjo fjalë e re do të shpërhapej te një numër më të madh folësish, domethënë do të largohej nga bashkësia e folësve të lartpërmendur dhe do të kalonte në bashkësitë e tjera. Në këtë kuptim, media dhe rrjetet sociale luajnë rol të rëndësishëm. Përdorimi i gjuhës në rrjetet sociale është më informal dhe kreativ, kështu që ato janë vatër për neologjizma. Nëse bëhet fjalë për narracione të dëmshme që lidhen me neologjizmat, atëherë ky proces i përhapjes së inovacioneve leksikore është shumë i rëndësishëm për studim dhe analizë dhe për shqyrtim si në hulumtimet shkencore ashtu edhe në praktikë.

1.6. NARRACIONET POLITIKE NËPËRMJET PRIZMAVE TË TEORIVE

Narracionet politike janë të rëndësishme për kuptimin se si aktorët politikë ndikojnë mbi perceptimin e publikut, mobilizojnë mbështetje për një, kurse sigurojnë bojkot për një opsion tjetër politik. Janë zhvilluar disa korniza teorike dhe koncepte për analiza të narracioneve politike.

Teoria e inkuadrimit (Framing Theory) është një nga më të zbatueshmet dhe lidhet me mënyrën se si informacionet i prezantohen publikut, duke e formësuar perceptimin dhe kuptimin e tyre për çështjet politike. Aktorët politikë përdorin “korniza” – inkuadrime që të theksojnë aspekte të caktuara të ndonjë çështjeje ndërsa i minimizojnë të tjerat. Kjo qasje selektive ndikon mbi perceptimet, mendimet, kurse mandej edhe mbi marrjen e vendimeve, si dhe mbi sjelljen e njerëzve. Kështu, politikanët mund ta tregojnë imigrimin si çështje sigurie ose si kujdes humanitar, që ndikon mbi faktin se si publiku dhe kreatorët e politikës i qasen kësaj teme (Goffman, 1974).

Këtë teori e zhvillon i pari Erving Gofman në librin e tij “Analiza e kornizave” në vitin 1974 dhe ajo përdoret gjerësisht në studimet mediatike dhe komunikimin politik që të shpjegohet se si diskursi publik mund të jetë nën ndikim nga mënyra se si prezantohen çështjet.

Konceptet kryesore të kësaj teorie janë termet *korniza*, struktura metalike të cilat i ndihmojnë njerëzit t’i interpretojnë dhe t’i organizojnë informacionet me fokusim në elementë të caktuar të rrëfimit, dhe *inkuadrim*, proces me të cilin komunikatorët (si mediat ose aktorët politikë) konstruktojnë një mënyrë të caktuar të kuptimit të ndonjë çështjeje. Mandej, si të rëndësishme konsiderohen konceptet: *ndërtimi i kornizave*, që përfshin krijimin ose përzgjedhjen e kornizave specifike të cilat harmonizohen me pikëpamje të caktuara dhe mund të ndodhë edhe në nivel individual dhe institucional; koncepti *vendosja e kornizës*: me t’u ndërtuar korniza, ajo duhet të vendoset në diskursin publik dhe ta formësojë mënyrën sipas të cilës njerëzit flasin dhe kuptojnë një çështje të caktuar; dhe në fund koncepti *interpretim i publikut*, efikasiteti i kornizës varet nga fakti se sa mirë përputhet me besimet dhe vlerat e publikut.

Në komunikimin politik, inkuadrimi është mjet i fuqishëm për të formuar opinionin publik dhe për të ndikuar në debatet politike. Politikanët, mediat dhe grupet e interesit përdorin inkuadrimin për të promovuar agjendat e tyre duke theksuar çështje ose perspektiva të caktuara. Kjo përfshin krijimin e narracioneve që përputhen me vlera, ideologji ose emocione të caktuara. Korniza përcakton se çfarë do të përfshihet në bisedë dhe çfarë do të përjashtohet.

Teoria e inkuadrimit këmbëngul të shpjegojë narracionet politike dhe ndikimet e tyre nëpërmjet disa mënyrave dhe duke përdorur disa koncepte. Së pari është *përcaktimi i problemit*: aktorët politikë mund të formësojnë një çështje të caktuar sociale duke përcaktuar se cili është problemi dhe kush është përgjegjës për të. Për shembull, në debatin për ndryshimet klimatike, një kornizë mund ta përkufizojë atë si një konsensus shkencor mbi një krizë të krijuar nga njeriu, ndërsa një tjetër mund ta përkufizojë atë si shkencë të ekzagjeruar ose të pabazë. Çdo kornizë mbart implikime të ndryshme për zgjidhjet e politikave. Mandej, aktorët politikë përdorin shpesh *vlerësimin moral*, kështu që kornizat politike shpesh përfshijnë gjykime morale për të drejtën dhe të gabuarën. Për shembull, debati për mirëqenien mund të përshtatet si ndihma e popullatave vulnerabël (obligim moral) ose si nxitje e varësisë (dështim moral). Çdo kornizë çon në përgjigje të ndryshme të politikave. Dhe *interpretimi kauzal (atribuimi i shkaqeve)* është mjet inkuadrimi. Në narracionet politike, aktorë të ndryshëm mund të theksojnë arsye të ndryshme për një çështje. Për shembull, varfëria mund të paraqitet dhe portretizohet si rezultat i pabarazisë sistematike ose dështimit individual. Kjo ndikon mbi mbështetjen publike për politika të tilla si mbrojtja sociale ose krijimi i vendeve të punës. Përveç faktit që kornizat përpiqen ta përcaktojnë problemin, që ta vlerësojnë atë moralisht dhe ta interpretojnë atë në mënyrë kauzale, do të përpiqen gjithashtu të propozojnë zgjidhje. Kornizat e tilla ofrojnë zgjidhje të bazuara në përcaktimin e problemit dhe interpretimin kauzal. Për shembull, nëse krimi është krijuar si rezultat i vlerave të dobëta morale, atëherë zgjidhja mund të përfshijë zbatimin më të rreptë të ligjit. Megjithatë, nëse do të trajtohet si një çështje socioekonomike, atëherë zgjidhja mund të jenë politikat që lidhen me arsimin ose punësimin. Së fundi, inkuadrimi politik shpesh mbështetet në metafora ose gjuhë simbolike për të krijuar narracione të gjalla dhe emocionale rezonante. Për shembull, korniza “lufta kundër drogës” sugjeron qasje urgjente dhe militariste ndaj politikës së substancave të paligjshme, ndërsa “kujdesi shëndetësor si e drejtë e njeriut” e inkuadron atë në termat e drejtësisë sociale.

Disa hulumtime empirike dëshmojnë si funksionojnë kornizat dhe cilat janë efektet e një inkuadrimi të caktuar specifik. Sipas Entman (1993) kornizat funksionojnë nëpërmjet përzgjedhjes dhe theksimit: përzgjedhje çfarë të theksohet dhe veçim i elementëve të caktuar të narracionit para të tjerëve. Kornizat e vendosura në këtë mënyrë ndikojnë mbi shkakun e problemeve dhe mbi zgjidhjet e rekomanduara. Nelson etj. (1997) kanë zbuluar se inkuadrimi i ndryshëm i çështjeve

racore (si veprim afirmativ) mund të ndikojë mbi mendimet e njerëzve. Kur politika mbi çështjet racore është formësuar si promovimi i barazisë, mbështetja për të u zmadhua, por kur inkuadrimi ishte në drejtim të konkurrencës së pandershme për vende pune, mbështetja u zvogëluar. Liengar (1991) në librin e tij "A është dikush përgjegjës?" dëshmon se midis inkuadrimit mediatik i çështjeve politike – si varfëria apo krimi – ka efekte reale mbi mendimin publik. Ai bëri dallimin midis inkuadrimit episodik (raportimi i ngjarjeve ose rasteve specifike) dhe inkuadrimit tematik (theksimi i tendencave më të gjera shoqërore), duke zbuluar se kornizat episodike shpesh i bëjnë njerëzit t'ua atribuojnë problemet dështimeve individuale, kurse jo shkaqeve sistematike.

Teoria e narracioneve strategjike (Theory of strategic narrative) fokusohet në mënyrën se si aktorët - kryesisht shtetet, liderët politikë ose institucionet - ndërtojnë dhe komunikojnë histori që t'i formësojnë perceptimet, që ta përcaktojnë realitetin dhe të ndikojnë mi sjelljen e publikut vendas dhe ndërkombëtar. Këto narracione janë krijuar qëllimisht që të arrihen qëllime politike, sociale ose kulturore, siç janë sigurimi i mbështetjes publike, legjitimimi i veprimeve të caktuara ose politikat udhëzuese. Teoria integron elemente të komunikimit, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shkencës politike për të shpjeguar se si funksionon fuqia nëpërmjet rrëfimeve të historive.

Narracionet strategjike janë të qëllimshme, të organizuara dhe të orientuara kah historisë që u japin kuptim ngjarjeve komplekse duke siguruar kornizë koherente interpretimi. Ato ndërtohen nga aktorë politikë dhe shpërndahen nëpërmjet kanaleve të ndryshme mediatike që të formojnë mirëkuptimin publik dhe që t'i harmonizojnë perceptimet me një politikë apo botëkuptim të caktuar. Teoria i përfshin koncepten thelbësore të tilla si *narracioni*, histori koherente që i lidh së bashku ngjarjet, aktorët dhe veprimet, duke formuar mënyrën se si njerëzit e kuptojnë një situatë; *veprim strategjik*: përdorimi i qëllimshëm i narracioneve për të arritur qëllime specifike – siç janë ndikimi mbi mendimin publik, fitimi i legjitimitetit politik ose fitimi i mbështetjes ndërkombëtare; *përafrimi narrativ*: proces me të cilin aktorë të ndryshëm përpiqen të përafrojnë narracionet e tyre me kuptimin dominues ose të dëshiruar mbi ndonjë çështjeje. Kjo mund të ndodhë në nivel vendor, rajonal apo global; *fuqia dhe ndikimi*: narracionet strategjike thuhet se janë mjete të fuqisë së butë. Në vend që të detyrojnë të tjerët, ata përpiqen t'i formësojnë besimet, vlerat dhe sjelljen e publikut.

Narracionet strategjike përdoren në politikën e brendshme dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare që të arrihen qëllimet politike duke i formësuar perceptimet. Politikanët dhe shtetet përdorin narracionet që t'i shpallin vlerat e tyre, t'i justifikojnë vendimet dhe të legjitimojnë veprimet e tyre. Në kontekst politik, këto narracione ndihmojnë të parashtrohen çështjet komplekse në mënyra që përputhen me publikun e synuar, duke inkurajuar identifikimin me politika ose botëkuptime të veçanta. Miskimon et al. (2013) e prezantuan këtë teori duke theksuar se si funksionojnë narracionet strategjike në politikën globale. Ata pohojnë se shtetet konkurrojnë që ta formësojnë sistemin ndërkombëtar nëpërmjet narracioneve të tyre.

Rosel et al. (2014) kanë analizuar si ndikojnë narracionet strategjike mbi marrëdhëniet ndërkombëtare duke parë se si SHBA-ja, Rusia dhe Kina përdorin narracionet që ta formësojnë/ ndërtojnë rendin global. Van der Ze (2020) eksploron se si narracionet strategjike përdoren në politikën e jashtme evropiane për të portretizuar BE-në si aktor global dhe udhëheqës në multilateralizëm. Hallams dhe Shrer (2016) e kanë studiuar kornizën narrative strategjike të operacioneve të NATO-s, duke treguar se si u përdorën narracione të ndryshme që të argumentohen aksionet e NATO-s dhe që të ruhet legjitimiteti midis shteteve anëtare.

Teoria e diskursit (Discourse theory) është teoria me fokus te gjuha. Analiza e diskursit politik fokusohet mbi mënyrën se si përdoret gjuha që të ndërtohen fuqia, ideologjia dhe identiteti. Narracionet politike analizohen si pjesë e diskursit më të gjerë, duke theksuar se si ata i përforcojnë ose i sfidojnë strukturat ekzistuese të fuqisë. Për shembull, analizohen fjalimet politike që të kuptohet se si politikanët e konstruktojnë identitetin nacional ose i tregojnë kundërshtarë e vet (Fairclough, 2001).

Teoria e diskursit është kornizë që përdoret që të kuptohet se si gjuha, simbolet dhe praktikrat e komunikimit formojnë realitetin, identitetin dhe marrëdhëniet e pushtetit në shoqëri. Me të konfirmohet se diskursi – sistemet e kuptimit të krijuara nëpërmjet gjuhës – është qendror në ndërtimin e jetës shoqërore dhe politike. Narracionet politike shihen si mënyra të strukturuar të interpretimit dhe kuptimit të botës, me fuqi të ngulitur në këto narracione. Teoria është zhvilluar kryesisht nga mendimi poststrukturalist, veçanërisht nëpërmjet punës së teoricienëve si Mishel Fuko, Ernesto Laklau dhe Shantal Muf, dhe hulumton se kuptimi i koncepteve (si demokracia, liria ose drejtësia) nuk është i përhershëm, por është ndërtuar, kontestuar dhe të riformësuar nëpërmjet luftërave politike.

Në bazën e kësaj teorie është diskursi, sistem kuptimi ose mënyrë e veçantë e të folurit dhe të kuptuarit të botës. Ajo është më shumë se vetëm gjuhë - i përfshin praktikrat, idetë dhe përfaqësimet që formojnë njohuritë dhe realitetin shoqëror. Pas Mishel Fukos, diskursi lidhet ngushtë me *fuqinë*, kështu që ata që e kontrollojnë diskursin mund të formësojnë atë që konsiderohet si “e vërtetë” ose “arsyeja e shëndetshme” në shoqëri. Mandej, *artikulimi* është gjithashtu një koncept i rëndësishëm kur flitet për fuqinë e diskursit. Aktorët politikë “artikulojnë” ose ndërtojnë lidhje midis ideve, simboleve ose praktikave të ndryshme shoqërore në mënyrë që të krijojnë një narracion ose botëkuptim koherent. Për shembull, lidhja e “imigrimit” me “sigurinë kombëtare” në diskursin politik formon perceptimin publik për imigracionin. Në konceptin e *hegjemonisë*, të përshkruar nga Gramshi dhe të zhvilluar më tej nga Laklau dhe Muf, disa diskurse bëhen dominuese dhe natyralizuara, ndërsa të tjera marginalizohen. Lufta politike është shpesh një betejë për vendosjen e hegjemonisë duke bërë një diskurs të caktuar të duket si “arsye e shëndetshme”. Narracionet politike, në këtë kornizë, janë strategji diskursive që krijojnë kuptim, legjitimojnë fuqinë dhe formësojnë politikën publike duke përcaktuar problemet, duke vënë fajin dhe duke propozuar zgjidhje.

Mishel Fuka ka pohuar se fuqia nuk praktikohet vetën nëpërmjet obligimit por edhe nëpërmjet prodhimit të dijes dhe të vërtetës. Ata që e kontrollojnë diskursin kontrollojnë atë që konsiderohet “e vërtetë” ose “normale” në shoqëri. Idetë e tij rreth marrëdhënies ndërmjet diskursit dhe fuqisë mund të gjenden në vepra të tilla si “Arkeologjia e dijes” (1969). Laklau dhe Muf, në veprën e tyre me ndikim “Hegjemonia dhe strategjia socialiste” (1985), zhvilluan një teori të diskursit që thekson se si identitetet dhe betejat politike formohen nëpërmjet diskursit. Ata pohojnë se lëvizjet politike duhet të angazhohen në ndërtimin e diskurseve të reja hegjemoniste që t’i sfidojnë ideologjitë dominuese. Një figurë kyçe në analizën kritike të diskursit (CDA), Ferklaf (N. Fairclough, 1995), studion se si diskursi i formon praktikrat shoqërore dhe marrëdhëniet e fuqisë. Ai fokusohet në mënyrën se si gjuha kontribuon në riprodhimin e strukturave shoqërore, veçanërisht në lidhje me fuqinë, pabarazinë dhe ideologjinë. Një tjetër figurë kyçe në analizën e diskursit, Theun A. van Dajk, fokusohet në rolin e diskursit në formësimin e vetëdijes dhe ideologjisë shoqërore. Ai shqyrton sesi diskursi politik përdoret për të riprodhuar dominimin shoqëror, si për shembull nëpërmjet portretizimit të emigrantëve ose pakicave në retorikën politike.

Teoria e ndërveprimit simbolik (Theory of symbolic interactionism) e cila e thekson rolin e simboleve dhe kuptimeve në formësimin e ndërveprimeve ndërpersonale (Blumer, 1969). Herbert Blumer e shpiku termin “ndërveprim simbolik”. Teoria fokusohet në mënyrat në të cilat individët krijojnë, interpretojnë dhe reagojnë ndaj simboleve në ndërveprimet e tyre të përditshme. Njerëzit veprojnë në bazë të kuptimeve që kanë gjërat për ta, kurse këto kuptime dalin nga dhe formohen nëpërmjet ndërveprimeve shoqërore. Në zemër të ndërveprimit simbolik është të kuptuarit se realiteti ndërtohet shoqërisht nëpërmjet komunikimit dhe kuptimi negociohet dhe rishikohet vazhdimisht në marrëdhëniet ndërpersonale. Zhvilluar nga veprat e Xhorxh Herbert Mid dhe Herbert Blumer, ndërveprimi simbolik shpesh përdoret për të shpjeguar se si identiteti individual, rolet shoqërore dhe dinamikat e grupit janë formësuar nga kuptimet simbolike që dalin në komunikim.

Konceptet themelore të kësaj teorie janë simbolet, objektet, fjalët, gjestet ose veprimet që kanë kuptime specifike në një kulturë ose kontekst të caktuar dhe që krijohen nëpërmjet ndërveprimit shoqëror; kuptimi, kuptimi i simboleve përcaktohet nëpërmjet ndërveprimit dhe i nënshtrohet ndryshimit në bazë të kontekstit ose perspektivës, prandaj njerëzit lidhen me gjërat bazuar në kuptimin që ato gjëra kanë për ta; vetëkoncepti, individët e zhvillojnë vetidentitetin e vet nëpërmjet ndërveprimeve me të tjerët, që përfshin marrjen e rolit të tjetrit (d.m.th. të imagjinosh se si i perceptojnë të tjerët).

Narracionet politike mund të shpjegohen nëpërmjet ndërveprimit simbolik duke u fokusuar në mënyrat në të cilat aktorët politikë (siç janë politikanët, mediat dhe votuesit) krijojnë dhe negociojnë kuptimet nëpërmjet simboleve, gjuhës dhe ndërveprimeve. Simbolet politike - si flamujt, parullat ose figurat ikonike - mbartin kuptime të fuqishme të ndërtruara dhe të interpretuara nga individë dhe grupe në shoqëri. Këto simbole bëhen të fuqishme sepse fitojnë kuptime të përbashkëta nëpërmjet ndërveprimeve sociale. Për shembull, fushatat politike shpesh përdorin simbole si flamuri që të krijojnë rezonancë emocionale me votuesit.

Narracionet politike krijohen dhe mbahen nëpërmjet përdorimit të gjuhës dhe retorikës, të cilat janë forma simbolike të komunikimit. Politikanët krijojnë fjalime që të shkaktojnë kuptime ose emocione të caktuara, kurse këto narracione ndërveprojnë vazhdimisht me publikun. Për shembull, kur një politikan përdor termin “Maqedonia e Përrjetshme”, “Maqedonia e Maqedonasve”, ai evokon një sërë kuptimesh simbolike që lidhen me identitetin kombëtar, vetidentifikimin dhe vetëpranimin.

Në “Mendja, vetvetja dhe shoqëria: Nga pikëpamja e sjelljes shoqërore” (1934), Mid, nëpërmjet konceptit të tij për “veten” si një konstrukt shoqëror, shpjegon se si individët e kuptojnë veten nëpërmjet ndërveprimit social, i cili është vendimtar në zhvillimi i identiteteve politike. Herbert Blumer i zgjeroi idetë e Midit dhe theksoi se kuptimet dalin nga ndërveprimi social. Përqendrimi i Blumerit në procesin interpretues qëndron në themel të pjesës më të madhe të analizës së narracioneve politike, sepse kuptimet politike negociohen dhe ndërtohen nëpërmjet diskursit dhe ndërveprimit.

Këto janë kornizat themelore teorike të cilat sigurojnë mbikëqyrje në faktin se si narracionet politike konstruktohen, shpërhapen dhe përdoren që të ndikohet mbi mendimin publik dhe rezultatet e politikave. Çdo teori mbart lente autentike për kuptimin e rolit të historive, narracioneve në politikë.

1.7. HULUMTIME RELEVANTE

Shumica e disiplinave shkencore, duke përfshirë edhe shkencat politike, studimet komunikuese, sociologjinë, psikologjinë sociale, gjuhësinë në fokusin e vet e kanë pasur ndikimin e narracioneve mbi mendimin publik, sjelljen politike, formimin e identiteteve dhe krijimin e politikave. Si rrjedhim janë të shumta edhe hulumtimet dhe të dhënat në këtë temë.

NDIKIMI I NARRACIONEVE POLITIKE MBI MENDIMIN PUBLIK

Janë të shumta studimet të cilat hulumtojnë se si narracionet politike i formojnë qëndrimet dhe opinionet e publikut mbi çështjet politike dhe se si ato ndikojnë në atë që njerëzit e konsiderojnë të rëndësishme. Gjetjet sugjerojnë se inkuadrimi i narracioneve, duke theksuar disa aspekte të një çështjeje mbi të tjerat, ndikon në opinionin publik dhe vendimmarrjen politike duke formuar

mënyrën se si njerëzit interpretojnë dhe vlerësojnë informacionin (Chong dhe Druckman, 2007). Efektiviteti i inkuadrimin varet nga faktorë të tillë si besueshmëria e burimit, frekuenca dhe përsëritja e narracioneve, kornizat (nëpërmjet të cilave gjërat duhet të interpretohen) dhe ndjeshmëria e publikut ndaj manipulimit. Kur ekzistojnë korniza konkurruese (disa politikanë thonë një gjë dhe të tjerë të kundërtën), interpretimet e individëve ndikohen nga besimet e mëparshme, njohuritë politike dhe vlerat e tyre, që e zbusin ndikimin e efekteve të inkuadrimin.

Mandej, narracionet që përmbajnë parashikime për rezultatet e ardhshme (për shembull, kur disa politikanë thonë se nëse qytetarët nuk zgjedhin opsionin e tyre, shteti do të dështojë) ndikojnë në qëndrimet e publikut ndaj çështjeve politike (Jerit, 2009). Efektiviteti i narracioneve të tilla do të jetë më i madh nëse ato ofrojnë një parashikim të qartë të pasojave që lidhen me politikën, duke e bërë kështu çështjen më të gjallë dhe bindëse. Për më tepër, narracionet me apele që ofrojnë siguri dhe favorizim për/drejt një politike të caktuar rrisin mbështetjen për të, ndërsa apelet që ofrojnë pasiguri, ose më saktë parashikime negative për një opsion tjetër politik, reduktojnë mbështetjen e qytetarëve për të. Kjo e dhënë thekson se siguria dhe drejtimi i perceptuar (pozitiv ose negativ) i parashikimeve janë thelbësore për përcaktimin e ndikimit të narracioneve që përmbajnë parashikime të rezultateve të ardhshme në publik (Jerit, 2009). Gjetjet e Xherit e theksojnë në fakt fuqinë e gjuhës parashikuese në formësimin e opinionëve dhe sugjerojnë që politikanët dhe avokatët mund t'i përdorin strategjikisht narracionet e tilla që të ndërtojnë ose ulin mbështetjen publike për politika të caktuara.

ROLI I NARRACIONEVE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE

Në studimet e llojit të tillë në të vërtetë bëhen përpjekje që të sigurohet mënyrë sistematike për studimin e roleve të narracioneve në krijimin e politikave. Hulumtimet në këtë fushë hulumtojnë se si narracionet për problemet politike dhe zgjidhjet i formojnë debatet dhe rezultatet politike.

Rezultatet e hulumtimit e mbështesin idenë se narracionet janë thelbësore në formësimin e opinionit publik dhe të preferencave të politikave, pasi ato thjeshtojnë çështjet komplekse, duke i bërë ato më të arritshme dhe bindëse (Shanahan & McBeth, 2018). Narracionet e suksesshme të politikave shpesh herë përmbajnë elementë të qartë si heronj, personazhe negativë, viktima dhe mësimet morale, të cilat ndihmojnë publikun të lidhet emocionalisht dhe kognitivisht me mesazhet e politikave. Narracionet mund të nxisin ndryshimin e politikave ose të përforcojnë status quo-në, në varësi të mënyrës se si ato paraqesin dhe formojnë çështjet, mobilizojnë mbështetësit dhe formësojnë perceptimet e legjitimitetit dhe urgjencës.

LIDHJA E MEDIAVE ME NARRACIONET POLITIKE

Ka studime të cilat e hulumtojnë rolin e mediave në krijimin, shpërhapjen dhe përforcimin e narracioneve politike. Në atë kontekst hulumtohet se si platforma të ndryshme mediatike i prezantojnë/tregojnë çështjet politike dhe ndikojnë mbi perceptimin publik.

Të dhënat nga hulumtimet flasin se mediat ndikojnë mbi perceptimet e publikut për çështjet politike, në formësimin e diskursit demokratik dhe angazhimin qytetar, shpesh nëpërmjet inkuadrimin, mbulimit selektiv dhe përcaktimit të agjendës (Bennett & Entman, 2001). Domethënë, perceptimi i publikut për çështjet politike do të varet nga fakti nëse dhe çfarë narracioni politik do të përcjellë media, dhe a do t'i përcjellë në mënyrë selektive apo plotësisht. Me rritjen e kanaleve të ndryshme mediatike dhe platformave digjitale, ka një fragmentim më të madh në konsumin e

lajmeve, gjë që mund të çojë në dhomat e jhonës dhe polarizimin ideologjik dhe, rrjedhimisht, përforcimin e narracioneve politike (Bennett & Entman, 2001).

Mandej, mbulimi mediatik i narracioneve politike mund ta përforcojë ose minojë llogaridhënien politike (Bennett & Entman, 2001). Edhe pse media ka potencialin t'i thërrasë liderët në përgjegjësi për atë që thonë dhe bëjnë, ato (media) shpesh zgjedhin me vetëdije sensacionalizmin (narracionet sensacionale) në vend të raportimeve thelbësore, gjë që ndikon në të kuptuarit e publikut për çështje të rëndësishme.

Përveç këtyre narracioneve sensacionale, problematike janë edhe narracionet “episodike”. Lajmet televizive shpesh përdorin narracione episodike, “korniza” episodike (raste individuale), në vend të narracioneve/kornizave tematike (analiza kontekstuale), gjë që e bën publikun t'ua atribuojë përgjegjësinë për problemet sociale individëve dhe jo faktorëve sistematikë (Iyengar, 1991). Dominimi i formimit episodik të narracioneve e hedh fajin për çështje të rëndësishme, si varfëria apo krimi, te individët, duke reduktuar mbështetjen publike për politikën që adresojnë zgjidhje strukturore ose institucionale. Këto narracione episodike e minojnë llogaridhënien duke mbuluar rolin e qeverisë, institucioneve ose faktorëve shoqërorë në zgjidhjen e çështjeve komplekse, që çon në pikëpamje më pak të informuara dhe më të individualizuara të përgjegjësisë politike (Iyengar, 1991).

RËNDËSIA E EMOCIONIT NË NARRACIONET POLITIKE

Këto studime interesohen se sa ndikon futja e emocioneve në narracionet politike mbi kulturën politike, mobilizimin e qytetarëve dhe formimin/ndërtimin e identiteteve. Hulumtimet në këtë fushë fokusohen më konkretisht në mënyrën se si narracionet që ngjallin emocione të tilla si frikë, zemërim ose shpresë, ndikojnë mbi votuesit dhe sjelljen e tyre.

Rezultatet e disa studimeve kryesore konfirmojnë se narracionet politike që ngjallin emocione të forta, veçanërisht entuziazmin dhe frikën, ndikojnë ndjeshëm mbi angazhimin dhe vendimmarrjen e votuesve (Brader, 2005). Narracionet me thirrje për entuziazëm rrisin interesin e votuesve, përforcojnë preferencat ekzistuese dhe inkurajojnë pjesëmarrjen politike, ndërsa narracionet me thirrje për frikë i bëjnë njerëzit më të hapur ndaj informacioneve të reja, duke i inkurajuar ata të rishqyrtojnë ose ndryshojnë qëndrimet e veta.

Në këtë kontekst theksohet ideja e ekzistencës së “sistemeve të dyfishta emocionale”: disponimi dhe mbikëqyrja, të cilat drejtojnë sjelljen politike. Sistemi i disponimit lidhet me veprime të zakonshme dhe e përforcon besnikërinë ndaj politikave të caktuara, ndërsa sistemi i mbikëqyrjes aktivizohet kur njerëzit ndihen të kërcënuar, gjë që inkurajon një vlerësim më të kujdesshëm të informacionit/narracioneve politike (Marcus & MacKuen, 2000). Si rrjedhim, emocione të tilla si entuziazmi, frika dhe ankthi ndikojnë mbi mënyrën se si individët e përpunojnë informacionin politik, ku entuziazmi i përforcon preferencat dhe besnikërinë e vendosur, ndërsa ankthi çon në rishqyrtim kritik dhe vlerësime më kritike. Përkatësisht, ankthi është ai që e aktivizon sistemin e mbikëqyrjes, duke i inkurajuar individët të kërkojnë informacione.

Dëshmohet se edhe “historitë e thella”, të cilat janë narracione të ngarkuara emocionalisht dhe i reflektojnë përvojat dhe vlerat jetësore të njerëzve, luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e identiteteve dhe perspektivave politike. Këto histori shpesh i tejkalojnë faktet dhe lidhen më shumë me përvojat personale dhe kolektive (Polletta & Callahan, 2017). Edhe narracionet e nostalgjisë, të cilat ngjallin ndjenjën e dëshirës për një të kaluar të idealizuar, janë veçanërisht efektive në mobilizimin e mbështetjes për lëvizjet politike. Këto narracione janë veçanërisht tërheqëse për individët që ndihen të marginalizuar ose të zhgënjyer nga ndryshimet bashkëkohore, duke u ofruar atyre ndjenjë përkatësie dhe identiteti (Polletta & Callahan, 2017)

Në të vërtetë, të gjitha këto studime sugjerojnë se fushatat politike mund të përdorin në mënyrë strategjike apele emocionale që të aktivizojnë përgjigje konkrete te votuesit, duke i bërë emocionet mjet të fuqishëm për të ndikuar mbi rezultatet e zgjedhjeve (Brader, 2005). Gjatë kësaj, emocionet nuk kuptohen si forca irracionale në politikë, por janë thelbësore për arsyetimin e informuar politik, duke formuar mënyrën se si individët interpretojnë, përfshihen dhe reagojnë ndaj ngjarjeve politike (Marcus & MacKuen, 2000).

NARRACIONET POPULISTE DHE NDIKIMI I TYRE MBI PUBLIKUN

Populizmi si ideologji e sheh shoqërinë të ndarë në dy grupe antagonistë: “njerëzit e pastër” kundrejt “elitës së korruptuar” (Mudde, 2004). Kjo kornizë dualiste është në themelin pjesës më të madhe të retorikave dhe strategjisë populiste. Tërheqja e populizmit qëndron në thjeshtësinë dhe drejtpërdrejtshmërinë e tij, dhe është veçanërisht kapshëm për qytetarët që ndihen të përjashtuar ose të huaj nga elitat tradicionale politike. Kjo e bën populizmin të adaptueshëm ndaj konteksteve dhe ideologjive të ndryshme politike, nga nacionalizmi i djathtë deri te lëvizjet e krahut të majtë kundër rendit shoqëror.

Ngritja e populizmit i reflekton tendencat më të gjera shoqërore, duke përfshirë sensacionalizmin mediatic, mosbesimin politik dhe zhgënjimin nga partitë kryesore, të cilat krijojnë mjedis të favorshëm për narracionet populiste. Ky lloj narracionesh mund të mobilizojë votuesit e paangazhuar dhe të sfidojë elitat e rrënjosura dhe, gjithashtu, rrezikon të minojë normat demokratike nëpërmjet promovimit të ndarjes, zvogëlimit të tolerancës për pluralizmin dhe nëpërmjet gërryerjes së kontroleve dhe balancave institucionale (Mudde, 2004).

Narracionet populiste shpesh shoqërohen me lëvizje të krahut të djathtë që përdorin retorikë të bazuar në frikë për të ndërtuar ndjenjën/lidhjen/identitetin brenda dhe jashtë grupeve. Ata shpesh i portretizojnë emigrantët, pakicat ose kundërshtarët politikë si kërcënime për sigurinë, kulturën dhe identitetin kombëtar, duke e përforcuar ndjenjën e “ne” kundrejt “ata” (Wodak, 2015). Duke krijuar “shqerra e flijimit”, diskursi populist i krahut të djathtë shpesh i marginalizon grupet, duke i fajësuar ata për problemet sociale. Kjo strategji jo vetëm që largon vëmendjen nga çështjet e tjera politike, por gjithashtu e konsolidon mbështetjen duke shfrytëzuar paragjykimet parakzistuese.

Populistët e djathtë shpesh i paraqesin pikëpamjet e tyre si “arsye e shëndetshme” në narracionet e tyre, duke i bërë thirrje “njeriut të zakonshëm” kundër “elitës”. Kjo qasje ndihmon për të legjitimuar politikën përjashtuese si pasqyruese të vullnetit të vërtetë, natyror të njerëzve (Wodak, 2015). Narracionet populiste paraqesin rrezik për vlerat demokratike duke e nxitur polarizimin dhe duke e minuar tolerancën dhe pluralizmin.

NARRACIONET POLITIKE DHE KONFLIKTET

Narracionet në të cilat përfshihen konfliktet, qofshin ato kulturore, historike apo sociale, ndikojnë në mënyrën se si publiku e percepton veten dhe identitetin e tij. Emocionet që ngjallin narracionet e tilla luajnë një rol kyç në ruajtjen e konflikteve. Frika, zemërimi dhe mosbesimi zakonisht janë të ngulitura në narracione të tilla, duke i përforcuar perceptimet negative të grupit kundërshtar dhe duke i penguar mundësitë për pajtim ose dialog (Bar-Tal, 2007). Narracionet e tilla shpesh përfshijnë mite dhe simbole kulturore, të cilat shërbejnë për të ruajtur solidaritetin brenda grupit, kurse i demonizojnë të gjithë që janë jashtë atij grupi, duke i përforcuar më tej armiqësitë. Edhe

liderët edhe institucionet ndikojnë ndjeshëm mbi dinamikën e konflikteve të pazgjidhshme/të papajtueshme. Ata mund të përjetësojnë narracione që justifikojnë armiqësitë e vazhdueshme ose, anasjelltas, promovojnë dialogun dhe përpjekjet për ndërtimin e paqes (Bar-Tal, 2007).

Këto narracione janë gjithashtu vendimtare në formësimin e identiteteve individuale dhe kolektive. Historitë që të rinjtë i dëgjojnë për veten dhe bashkësitë e tyre në kohë konflikti dhe përplasjesh ndikojnë në perceptimet e tyre për përkatësinë, konfliktin dhe “tjetrin” (Hammack, 2011). Narracionet kulturore specifike për secilin grup i informojnë të rinjtë dhe i ndihmojnë të kuptojnë identitetin e tyre në lidhje me konfliktin. Këto narracione shpesh i theksojnë temat e viktimizimit, qëndrueshmërisë dhe vuajtjeve historike.

Edhe pse narracionet mund t’i thellojnë dhe përjetësojnë ndarjet, ato gjithashtu kanë potencialin për të nxitur ndjeshmërinë dhe dialogun. Duke kuptuar dhe duke u angazhuar me narracionet e “njëri-tjetrit, së bashku”, ekziston mundësi për të ndërtuar ura dhe për të transformuar identitete (Hammack, 2011). Kjo do të thotë të theksohet rëndësia e narracionit në ndërtimin e identitetit, veçanërisht në kontekstin e konfliktit, dhe e thekson nevojën për dialog dhe mirëkuptim të ndërsjellë që të lehtësohen përpjekjet për ndërtimin e paqes.

GJUHA E URREJTJES NË NARRACIONET POLITIKE

Hulumtimet mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes në narracionet politike dëshmojnë se si liderët dhe lëvizjet politike përdorin gjuhën e urrejtjes për të synuar grupe specifike, duke nxitur dhunën dhe diskriminimin, dhe se si këto narracione krijojnë “armik” ose “shqerrë flijimi” dhe e përforcojnë dehumanizimin.

Rezultatet e hulumtimeve tregojnë se koncepti i një narracioni me “gjuhë të rrezikshme” ka potencial të lartë për të nxitur dhunën masive. Identifikimi i modeleve dhe konteksteve specifike të të folurit që rrisin rrezikun e dhunës është thelbësor për parandalimin (Benesch, 2014). Është dëshmuar, gjithashtu, se përdorimi i kundërnarracioneve – përgjigjet pozitive ndaj gjuhës së urrejtjes – mund të parandalojë dhunën masive ose të zvogëlojë ndikimin e narracioneve të dëmshme. Kjo përfshin ndërtimin e ndërgjegjësimit midis bashkësive dhe individëve për të prodhuar mesazhe alternative që nxisin përfshirjen (Gagliardone, Alves & Martinez, 2015). Strategjitë efektive kundër të folurit përfshijnë dënimin publik të fjalës nxitëse, promovimin e mesazheve pozitive dhe përforcimin e mesazheve të paqes (Benesch, 2014). Një nga mënyrat për parandalimin e retorikës së dhunshme dhe dhunës së mundshme masive është nëpërmjet monitorimit dhe alarmimit të bashkësisë, që përfshin monitorimin e mediave dhe mesazheve publike.

Nga ana tjetër, narracionet e urrejtjes, të cilat përdoren në mënyrë strategjike për të mobilizuar grupe të caktuara votuesish, ndërkohë që largojnë të tjerët, kontribuojnë për një atmosferë të polarizuar politike, duke i komplikuar përpjekjet për të nxitur angazhimin gjithëpërfshirës demokratik (Sokol & Sarajlić, 2023).

POLARIZIMI DHE NARRACIONET NE KUNDËR TYRE

Disa studime e identifikojnë polarizimin politik në rritje si sfidë të përbashkët për demokracitë në nivel global. Ky polarizim shpesh i ndan shoqëritë sipas linjave ideologjike, etnike ose fetare. Faktorët polarizues përfshijnë pabarazinë ekonomike, ndikimin e mediave sociale, politikat e identitetit dhe manipulimin strategjik nga elitat politike. Liderët shpesh i përkeqësojnë ndarjet për të mobilizuar mbështetje, duke i karakterizuar kundërshtarët si kërcënime ekzistenciale për vlerat

ose mbijetesën e grupit të tyre (McCoy, Rahman & Somer, 2018).

Numri i madh i narracioneve polarizuese çon në kthimin pas të demokracisë, pasi kundërshtarët politikë delegitimohen dhe normat demokratike si toleranca e ndërsjellë dhe kontrollet institucionale minohen. Kjo i intensifikon betejat për fuqi dhe e dobëson besimin në institucionet demokratike. Narracionet polarizuese e destabilizojnë qeverisjen duke e zmadhuar bllokimin në funksionimin shoqëror, duke reduktuar kompromisin në politikë dhe duke rritur mosbesimin e publikut. Kohezioni social gërryhet pasi grupet bëhen më të izoluara dhe armiqësore, duke e reduktuar vullnetin e tyre për të bashkëpunuar për çështje të përbashkëta.

Vihet re se, polarizimi politik bazohet gjithnjë e më shumë në identitet dhe jo në ideologji. Ky “polarizim i bazuar në identitet” nënkupton se përkatësitë politike lidhen ngushtë me identitete të tjera shoqërore (p.sh., etnia, feja), duke intensifikuar besnikërinë brenda grupit dhe armiqësinë jashtë grupit. Identitetet politike janë ngarkuar emocionalisht, duke çuar në “polarizim afektiv” - ndjenja të forta negative ndaj palës kundërshtarë. Kjo përgjigje emocionale është më e ulët për dallimet e politikave dhe më e lartë për solidaritetin brenda grupit dhe armiqësinë jashtë grupit (Mason, 2018). Mejsun nënvizon se polarizimi i drejtuar nga identiteti i gërryen normat demokratike, duke nxitur klimë ku kompromisi dhe bashkëpunimi janë gjithnjë e më të rrallë. Gjithashtu i bën individët më të prirur të justifikojnë praktikat jodemokratike që të “mbrojnë” vlerat dhe fuqinë e grupit të tyre (Mason, 2018).

FUSHATAT DISKREDITUESE SI NARRACIONE TË DËMSHME DHE NDIKIMI I TYRE

Fushatat diskredituese ndikojnë theksueshëm mbi peizazhin politik, duke i minuar kandidatët dhe partitë nëpërmjet dezinformacioneve dhe sulmeve personale. Këto fushata nxitin mjedis të mosbesimit dhe armiqësisë midis elektoratit.

Narracione me përdorimin e përhapur të stereotipave gjinore në diskursin politik që marginalizojnë kandidatet femra dhe përforcojnë rolet tradicionale gjinore, jo vetëm që i cenojnë kandidatët individualisht, por gjithashtu i përjetësojnë pabarazitë shoqërore.

Ballafaqimi me sfidat e paraqitura nga narracionet e dëmshme kërkon përpjekje të përbashkët nga aktorët politikë, shoqëria civile dhe organizatat mediatike që të promovojnë përgjegjësi dhe të nxitin diskurs politik “më të shëndetshëm” (Sokol & Sarajlić, 2023).

DEZINFORMACIONET SI NARRACIONE TË DËMSHME DHE NDIKIMI I TYRE

Dezinformacionet të kuptuara si informacione qëllimisht të gabuara të krijuara dhe të shpërndara që të manipulohet mendimi publik ose që të fshihet e vërtetën, u shërbejnë qëllimeve specifike politike, si delegjitimimi i kundërshtarëve, ndikimi në perceptimin publik dhe ndikimi në rezultatet e zgjedhjeve. Ato mund të përdoren në mënyrë strategjike nga aktorët politikë për të çuar përpara agjenda ose narracione të caktuara (Freelon, & Wells, 2020). Shpërhapja e tyre lehtësohet nëpërmjet platformave të mediave sociale (Bennett & Livingston, 2018; Freelon, & Wells, 2020; Lazer, D. M. J., et al. 2018). Dizajni i këtyre platformave, i cili shpesh i jep përparësi angazhimit para saktësisë, e përkeqëson problemin duke përforcuar përmbajtje senzacionale dhe të rreme. Ato gjenerojnë më shumë interes dhe më shumë shpërhapje në krahasim me burimet tradicionale të lajmeve (Allcott & Gentzkow, 2017; Guess, Nagler & Tucker, 2019).

Dezinformacionet gërshetohen shpesh me histori personale dhe nostalgji, duke përforcuar besimet dhe emocionet ekzistuese në vend që të paraqesin fakte. Ky ndërveprim ndërlikon aftësinë e publikut

që të dallojë të vërtetën nga e pavërteta, pasi narracionet e ngarkuara emocionalisht mund të tejkalojnë vlerësimet racionale të informacionit (Polletta & Callahan, 2017).

Është dëshmuar se dezinformacionet ndikojnë edhe mbi sjelljen e qytetarëve, kështu që e shkatërrojnë angazhimin qytetar duke krijuar një mjedis ku qytetarët kanë më shumë mundësi të shkëputen nga proceset politike ose të konfuzohen për çështjet politike. Kjo ndarje dobëson më tej institucionet dhe proceset demokratike (Bennett & Livingston, 2018). Si përmbledhje, dezinformacionet si një lloj narracionesh të dëmshme paraqesin sfida serioze për proceset demokratike duke minuar besimin tek institucionet, duke polarizuar opinionin publik dhe duke krijuar konfuzion në lidhje me informacionet faktike. Ky erozion i besimit mund të dobësojë themelet e qeverisjes demokratike (Freelon, & Wells, 2020; Bennett & Livingston, 2018).

MEDIAT SOCIALE SI PËRFORCUES TË NARRACIONEVE TË DËMSHME POLITIKE

Studimet në këtë fushë hulumtojnë se si platformat e mediave sociale i përforcojnë narracionet e dëmshme politike, duke mundësuar shpërhapjen e shpejtë të dezinformacioneve, gjuhës së urrejtjes dhe përmbajtjes ekstremiste.

Mediat sociale fillimisht i lehtësuan lëvizjet demokratike duke siguruar një platformë për mobilizim dhe shprehje, veçanërisht gjatë revolucioneve të tilla si Pranvera Arabe. Megjithatë, më vonë të njëjtat platforma kontribuuan ndjeshëm në trazirat politike, polarizimin dhe përhapjen e dezinformacioneve. Kështu, ndërsa mediat sociale mundësojnë ndërveprim më të drejtpërdrejtë midis qytetarëve dhe figurave politike dhe mund të mobilizojnë qytetarët dhe të inkurajojnë angazhimin politik, ato gjithashtu mund të çojnë në erozion të rolit të portierit të mediave tradicionale, duke ngritur shqetësime për cilësinë e informacionit dhe potencialin për manipulim, si dhe t'i përkeqësojnë ndarjet, që t'i përforcojnë qëndrimet ekstremiste dhe që të nxitin konflikt (Tucker et al, 2017).

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

2.1. OBJEKTI DHE QËLLIMET E HULUMTIMIT

Objekt i këtij hulumtimi janë **narracionet e dëmshme politike** në komunikimin politik. Problemi i hulumtimit është **mënyra në të cilën ndërtohen narracionet nga aktorët politikë dhe mënyra e informimit të mediave për to.**

Qëllimet e hulumtimit janë **analiza e narracioneve** të subjekteve politike dhe **përcaktimi i narracioneve dominuese të dëmshme, strategjitë dhe teknikat retorike** në komunikimin e tyre me publikun, si edhe **analiza e mënyrës se si ato i përcillen publikut nga mediat.**

Në thelb hulumtimi ka për qëllim të zbulojë **se a i respektojnë aktorët politikë standardet dhe parimet e komunikimit politik, si edhe a i zbatojnë mediat gjatë informimit vlerat dhe standardet profesionale dhe etike të gazetarisë.** E gjithë kjo me qëllim përfundimtar për **zmadhimin e vetëdijes së të gjithëve pjesëmarrësve në komunikimin publik** (aktorët politikë, mediat dhe publiku) për rëndësinë e respektimit të të gjitha parimeve dhe standardeve për komunikimin politik, si dhe fuqinë enorme shkatërruese të narracioneve të dëmshme për proceset demokratike, përparimin e shoqërisë në të gjitha sferat dhe shëndetin e qytetarëve.

2.2. PYETJA E HULUMTIMIT DHE KONKRETIZIMI I SAJ

Pyetja themelore e hulumtimit është: **A krijohen dhe si krijohen dhe shpërhapen narracionet e dëmshme politike në Maqedoni?**

Konkretizimi i kësaj pyetjeje themelore hulumtuese për subjektet/aktorët politikë është në këtë drejtim:

- Si ndërtojnë/krijojnë narracione të dëmshme subjektet kryesore politike (përbërja parlamentare nga 2020 - 2024 dhe përbërja e qeverisë nga 2023 - 2024) në Maqedoni në faqet e tyre zyrtare të internetit dhe në faqet/profilet e tyre zyrtare në Fejsbuk (vokabulari i përdorur)?
- Çfarë narracionesh të dëmshme ndërtohen dhe i dërgohen publikut nga aktorët kryesorë politikë, duke e përfshirë prevalencën e llojeve të narracioneve të dëmshme?
- Për cilat tema ndërtohen më shpesh narracione të dëmshme në suazat e narracioneve politike?
- Cilat janë shkeljet kryesore në komunikimin politik të aktorëve politikë?

Konkretizimi i kësaj pyetjeje themelore hulumtuese për mediat (televizionet dhe mediat onlajn) është në këtë drejtim:

- Si i transmetojnë mediat narracionet politike të krijuara dhe shpërhapura nga aktorët politikë?
- A ka dhe cilat janë shkeljet kryesore të standardeve profesionale të gazetarisë për informim të ndershëm, të drejtë dhe të paanshëm për aktorët politikë dhe transmetimi i narracioneve të tyre?

2.3. VARIABILË

Variabli kryesor në të dy segmentet e analizës është **narracioni i dëmshëm**. Narracionet e dëmshme janë ato narracione të aktorëve politikë që nuk kanë qëllim dhe përmbajtje dashamirëse dhe nuk shërbejnë për promovimin e aktivizmit qytetar, nuk shërbejnë vetëm për informimin e publikut, por edhe për manipulimin e tij, kurse si të tilla janë minusit kryesorë të demokracisë dhe vlerave njerëzore, me pasoja potencialisht të dëmshme në pothuajse të gjitha sferat e jetës shoqërore-politike.

Lista e narracioneve të dëmshme është krijuar për qëllime specifike të këtij hulumtimi dhe është përshtatur në përputhje me analizën e bërë nga tavolina, konsultimin e literaturës referente, kurse duke marrë parasysh kontekstin sociopolitik të Maqedonisë dhe specifikat e saj.

NARRACIONI I DËMSHËM 1 Dezinformatet: shpërhapja e informacione ose pohimeve të rreme, me qëllim që të shkaktojë dëmtim ose manipulim të mendimit publik. Që të mund të përcaktohet se a ka shpërhapje të dezinformacioneve duhet të keni “pamjen” e plotë të situatës, domethënë të jeni në gjendje të verifikoni besueshmërinë e informacionit që shpërndahet⁵.

NARRACIONI I DËMSHËM 2 Informacione me qëllim të keq: politikanët ose figurat publike mund të kenë informacion privat ose personal (p.sh., email ose mesazhe private) të hequra nga konteksti dhe të ndahen për të dëmtuar reputacionin e tyre. Shpërndarja e tyre nuk është në interes të publikut dhe shpesh bëhet me qëllim të keq për të dëmtuar reputacionin e tyre. [Posetti & Ireton (Eds.), 2018].

NARRACIONI I DËMSHËM 3 Minimi i besimit në institucionet publike (pa dëshmi): minimi i qëllimshëm dhe i pabazuar i besimit të qytetarëve në institucionet publike. Zakonisht bëhet fjalë për sulm të pabazë ndaj institucioneve publike për korrupsion, vendimmarrje të njëanshme dhe punën joprofesionale të tyre. (Knight Foundation, 2018).

NARRACIONI I DËMSHËM 4 Dhënia selektive e të dhënave për ndonjë ngjarje që duket se konfirmon një pozicion, duke injoruar të dhëna të tjera që hedhin poshtë atë pozicion. Këto narracione shpesh e çojnë publikun në përfundime të gabuara. (Arnaudo et al., 2021).

NARRACIONI I DËMSHËM 5 Teori të komplotit: akuza për komplete sekrete nga individë apo grupe të fuqishme, zakonisht pa dëshmi.

NARRACIONI I DËMSHËM 6 Sulme në bazë personale dhe/ose demonizim i kundërshtarëve: emërtimi i kundërshtarëve politikë dhe/ose figurave të tjera të rëndësishme publike në një kontekst negativ, me qëllim që të diskreditohen, fyhen, nënçmohen ose nënvlerësohen. Ky narracion përfshin fjalimin që nënkupton kualifikime për “tjetrin” si mishërim i një të keqeje ose çnjerëzore të veçantë. Demonizimi dhe sulmet personale mund të nxisin shqetësim, gjuhë urrejtjeje dhe dhunë midis individëve ose grupeve të qytetarëve. (Rowell, 2011; Amnesty International, 2017).

5 [Dezinformatë | recnik.medium.edu.mk](http://recnik.medium.edu.mk) - Dezinformatë

NARRACIONI I DËMSHËM 7 Ndikim i jashtëm: narracionet me të cilat akuzohet një subjekt apo subjekte të huaja për ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit dhe prishje të proceseve demokratike nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme: manipulim i mendimit publik, ndikim në vendimmarrje, mbjellje përçarjeje në vend etj. (Bressanelli et al., 2020).

NARRACIONI I DËMSHËM 8 Nxitje e ndarjeve: narracione qëllimi i të cilave është nxitja e ndarjeve duke denigruar ose kundërshtuar një grup tjetër njerëzish në bazë të përkatësisë etnike, bindjeve fetare, bindjeve politike, ideologjive, moshës ose karakteristikave të tjera.

NARRACIONI I DËMSHËM 9 Seksizëm: narracione (deklarata, komente, shaka, paraqitje vizuale) që bazohen në idenë se një person ose grup njerëzish është inferior ndaj një tjetri vetëm për shkak të gjinisë dhe/ose seksit të tyre (Gréboval, n.d.).

NARRACIONI I DËMSHËM 10 Ksenofobi: nxitja e frikës, përjashtimit ose kufizimit të personave dhe/ose grupeve që nuk janë shtetas të Maqedonisë, në bazë të racës, ngjyrës, prejardhjes kombëtare ose etnike. Në përgjithësi, ksenofobia manifestohet nëpërmjet aktiviteteve diskriminuese ose shprehjeve haptazi armiqësore dhe të qëllimshme të urrejtjes. Individët ksenofobë do të mendonin në këtë mënyrë: Ne (vendasit) shërbejmë si shembull, jemi të mirë dhe normalë, të gjithë duhet të shikojnë nga ne, të mendojnë si ne, ndërsa ata (të huajt, të ardhurit...) janë delikuentë, kërcënim, të dhunshëm, vjedhin etj. Ose, shkurtimisht, “ne jemi të mirët” dhe “ata janë të këqijtë” (UNHCR, 2020).

NARRACIONI I DËMSHËM 11 Etnocentrizëm: Paragjykimi kulturor ose etnik – të menduarit se grupi etnik i dikujt dhe i disave (ose të gjitha) karakteristikat e tij kulturore janë superiore ndaj të gjitha grupeve të tjera. Shpesh, çon në supozime të gabuara “etnocentrike” për kulturat dhe mënyrat e tjera të jetesës dhe në paragjykime, qëndrime dhe veprime negative ndaj “të tjerëve” (ECPS, n.d.).

NARRACIONI I DËMSHËM 12 Gjuha e urrejtjes dhe/ose gjuha diskriminuese: Fjalimi (ose komunikimi me shkrim) që synon të degradojë, ngacmojë ose nxisë dhunën ose veprimet e bazuara në paragjykime ndaj individëve ose grupeve të njerëzve në bazë të racës, gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, kombësisë, fesë, orientimit seksual, identitetit gjinor, gjuhësor, aftësisë intelektuale ose fizike, pikëpamjeve morale ose politike, klasës socioekonomike, profesionit ose pamjes së jashtme (si gjatësia, pesha dhe ngjyra e flokëve) dhe çdo karakteristike tjetër. Gjuha e urrejtjes ndryshon nga gjuha fyese, e cila ka për qëllim të ofendojë ose të përqeshë individët (“budalla”, “peder”), pa qëllim që të nxitë dhunë apo diskriminim. Kur i njëjti fjalim fyes përdoret për të fyer një grup njerëzish (“shiptar budalla”), atëherë mund të cilësohet si gjuhë urrejtjeje (Këshilli i Evropës, n.d.; Mihajlova et al. 2013).

NARRACIONI I DËMSHËM 13 Përmbajtje manipuluese vizuale mediatike: Përdorimi i fotografive/imazheve, videove dhe regjistrimeve audio të ndryshuara për të mashtruar/ngatërruar publikun ose për të promovuar tregime të caktuara. Është ndryshe nga satira dhe parodia, ku njerëzit tallen qëllimisht dhe haptazi/qartë me fotografi/imazhe të fotoshopuara dhe elemente të caktuara të shtuara.

NARRACIONI I DËMSHËM 14 Shpërhapja e panikut, frikës dhe pasigurisë: Shpërndarja e informacioneve të vërteta, gjysmë të vërteta ose të rreme që të shpërhapet panik, frikë dhe pasiguri tek qytetarët. Kjo nuk vlen për rastet kur duhet informuar për disa ngjarje/dukuri/dukuri që janë të vërteta, por në vetvete të pakëndshme, prandaj shkaktojnë panik dhe frikë – sigurisht që duhen raportuar, por ekzagjerimi, mbitheksimi, përsëritja, përdorimi i formulimeve me të cilat shkaktohet qëllimisht panik, frikë dhe pasiguri - kjo përbën një narracion të dëmshëm (Oxford University Press, n.d.; Waldroff, 2020). Mund të bëhet fjalë për shumë lloje të shpërhapjes së pasigurisë, të tilla si ekonomike, politike ose shëndetësore.

NARRACIONI I DËMSHËM 15 Nxitja e patriotizmit dhe nacionalizmit ekstrem: Krijimi i ndjenjës te njerëzit sikur të kenë armik të përbashkët, përkatësisht bëhet fjalë për patriotizëm dhe nacionalizëm ekstrem dhe besim agresiv në superioritet dhe lavdinë nacionale (Welch, 2014).

NARRACIONI I DËMSHËM 16 Populizëm: Narracione në të cilat jepen pohime të politikanëve/ figurave të rëndësishme publike se ata “përfaqësojnë popullin”, udhëhiqen nga vullneti i tyre dhe janë “në shërbim të tij” që të marrin vendime të caktuara. Është një fjalim që në mënyrë eksplicite apo implicite pohon se mbështet popullin kundër elitave/grupeve të ndryshme që kanë disa privilegje (Müller, 2017).

OPERACIONALIZIMI I VARIABILËVE: INDIKATORË PËR NARRACIONE TË DËMSHME

Variabili kryesor “narracioni i dëmshëm” i përcaktuar në 16 lloje të ndryshme, analizohet kryesisht nëpërmjet analizës së përmbajtjes. Operacionalizimi i variabilit përfshin përcaktimin e fjalëve, frazave dhe/ose pohimeve të pranishme në secilën prej narracioneve të dëmshme të përcaktuara. Kështu, për çdo narracion të dëmshëm, përcaktohen indikatorë (të paktën një indikator për një narracion të dëmshëm) që tregojnë se cilat fjalë janë kyçe për të njohur llojin specifik të narracionit të dëmshëm. Janë përcaktuar gjithsej 14 indikatorë që tregojnë për një ose më shumë lloje narracionesh të dëmshme. Gjatë kësaj, emërues i përbashkët i të gjithë indikatorëve është se pohimet e njohura nuk mbështeten nga fakte dhe dëshmi. Qëllimi i indikatorëve si narracione të dëmshme të operacionalizuara është njohja dhe analiza e detajuar e narracioneve të dëmshme.

Pasqyra e të gjithë indikatorëve, si dhe cilave narracioneve mund t’u drejtohen.

| | Indikatorë | Narracione të dëmshme të ndërlidhura |
|---|---|---|
| 1 | Prania e pohimeve për korrupsion, mungesë transparence/llogaridhënieje, joprofesionalizëm, shpërdorim detyre pa asnjë përpjekje për të vërtetuar ato pohime. | Dezinformacione. Minim i besimit tek institucionet – nëse pohimet e pabazuara kanë të bëjnë me mbartësit e funksioneve publike, institucionet publike. Përzgjedhja e njëanshme. |
| 2 | Paraqitja e gjetjeve të paverifikuara (ose gjetjet që janë të vështira për t’u verifikuar) përdoren si bazë për të akuzuar kundërshtarët politikë. | Dezinformacione. Minim i besimit tek institucionet. Përzgjedhja e njëanshme. |
| 3 | Është i pranishëm keqpërdorimi i gjerë i informacionit privat ose tragjedi personale, aftësive të kufizuara, statusit social, statusit martesor të kundërshtarëve politikë për të arritur qëllimet e tyre. | Informacion keqdashës. Sulmet personale, demonizimi. Gjuha e urrejtjes. |
| 4 | Është i pranishëm etiketimi, tallja dhe mosrespektimi i madh për njerëzit e tjerë (punëtorë mediatikë, aktivistë qytetarë, kundërshtarë politikë, mbajtës të posteve publike...). Përdorimi i fjalëve negative. | Sulmet personale, demonizimi. |

| | | |
|----|--|--|
| 5 | Ka gjuhë që fyen një grup të caktuar ose justifikon gjuhën e urrejtjes kundër një grupi të caktuar, në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës, përkatësisë kombëtare ose etnike, seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë në një grup të marginalizuar, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, arsimimit, fesë ose besimit, bindjes politike, bindjes tjetër, paaftësisë, moshës, statusit familjar ose martesor, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, statusit personal dhe social ose ndonjë bazë tjetër. | Gjuhë e urrejtjes. |
| 6 | Mostransmetim i qëllimshëm i pamjes së tërësishme të “ngjarjes” me qëllim lihen mënjanë informacione që e hedhin poshtë pozitën e atij që i jep ato. | Dezinformacione. Minim i besimit tek institucionet. Përzgjedhja e njëanshme. Përmbajtje manipuluese audiovizuale mediatike. |
| 7 | Pohohet se është e vërtetë që kundërshtarët politikë/institucionet publike manipulohen nga grupe të fuqishme prapaskenike (të fshehta) (p.sh., masonët, etj.) dhe nuk paraqiten fakte apo prova apo nuk përdoren burime që nuk kanë besueshmëri apo autoritet në atë fushë. | Dezinformacione. Teori komploti. Shpërhapje e panikut, frikës dhe pasigurisë. Ndikim i huaj. |
| 8 | Përdorimi i fjalive, formulimeve që akuzojnë një subjekt (ose subjekte) të huaj për ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit, në kundërshtim me interesat e shtetit, që në fakt përbën shkelje të proceseve demokratike. | Ndikim i huaj. Shpërhapje e panikut, frikës dhe pasigurisë. |
| 9 | Përdorimi i fjalëve dhe frazave që denigrojnë një grup të caktuar njerëzish që të shkaktojnë përçarje dhe mosmarrëveshje midis <i>neve/ne/tonëve</i> dhe <i>juve/ju/tuajve</i> . Në mënyrë tipike, <i>ne/tonët</i> jemi të mirë, pozitivë dhe të dëshirueshëm, dhe <i>ju/tuajt</i> jeni të këqij, negativë dhe të padëshirueshëm. | Nxitje e ndarjeve. Shpërhapje e panikut, frikës dhe pasigurisë. |
| 10 | Përdorimi i fjalëve dhe formulimeve që fyejnë, nënçmojnë ose tallen një person dhe/ose grup në bazë të gjinisë dhe/ose orientimit të tyre seksual. | Seksizëm. Sulme të personaliteteit, demonizim. Gjuhë e urrejtjes. |

| | | |
|----|--|---|
| 11 | Përdorimi i fjalëve që fyejnë, diskreditojnë ose shpifin ndaj një grupi njerëzish (të huaj/ të huaj) që të shkaktojnë frikë, refuzim dhe distancim prej tyre, madje duke provokuar sjellje të caktuara ndaj atij grupi. | Ksenofobi nëse ata janë të huaj/të ardhur. Etnocentrizëm. Shpërhapje e panikut, frikës dhe pasigurisë. |
| 12 | Përdorimi i fjalive, fjalëve dhe formulimeve që lavdërojnë përkatësinë etnike të dikujt, kurse të gjithë të tjerët më pak të rëndësishëm, të vlefshëm ose të denjë. | Etnocentrizëm. Patriotizëm dhe ose nacionalizëm. |
| 13 | Pamje, videot dhe regjistrimet audio të krijuara me qëllim që të mashtrojnë publikun për të besuar se diçka është reale dhe e vërtetë, por nuk është (dhe kjo mund të vërtetohet). | Dezinformacione. Përmbajtje manipuluese audiovizuale mediatike. Shpërhapje e panikut, frikës dhe pasigurisë. Përzgjedhje e anshme. Sulme të personaliteteit, demonizim. Gjuhë e urrejtjes. |
| 14 | Fjalë/fjali me të cilat në mënyrë eksplicite ose implicite, drejtpërdrejt ose tërthorazi promovohen ideologjitë/aktivitetet/sjelljet e veta si diçka që është në interes të popullit/masave të gjera/të zakonshmes “njeriut të ndershëm”, njerëzimit, ndërsa ideologjitë/veprimtaritë/sjelljet, karakteristikat e kundërshtarëve politikë promovohen si diçka që i shërben një grupi të vogël elitari njerëzish, që nuk e pasqyron vullnetin e popullit. | Populizëm. Ndikim i huaj. Patriotizëm dhe ose nacionalizëm. Teori të komplotit. |

2.4. EKZEMPLARI

Duke pasur parasysh se qëllimi kryesor është që të hulumtohet se a krijojnë dhe si krijojnë, përdorin dhe shpërhapin aktorët politikë në Maqedoni narracione të dëmshme, si dhe cili dhe si është roli i mediave gjatë informimit ndaj këtyre narracioneve, përkatësisht a i zbatojnë vlerat dhe standardet profesionale dhe etike të gazetarisë, në këtë hulumtim janë analizuar:

- faqet **zyrtare në internet të partive politike të analizuar** në RMV,
- **faqet/profilet zyrtare në Fejsbuk të partive politike të analizuar, liderëve dhe ministrave të tyre**, si dhe
- **mediat** që raportojnë mbi këto narracione: **televizione dhe mediat informative onlajn**.

Arsyet pse janë përzgjedhur për monitorim dhe analizë faqet zyrtare të internetit dhe faqet/profilet në Fejsbuk janë të dhënat nga sondazhi EUROMETRIC 2023 (EUROTINK, 2023), të cilat tregojnë se informacioni nëpërmjet internetit është një nga dy mënyrat më të përdorura të informimit për lajmet politike. 56%), kurse rrjetet sociale (me 87%) përfaqësojnë burimin më të rëndësishëm për informacione politike.

Arsyet pse TV-stacionet janë përzgjedhur për monitorim dhe analizë janë hulumtimi i ASHMAAV-it i vitit 2023 ([Të dhënat mbi shtrirjen e stacioneve radiofonike dhe përqindjen në shikueshmërinë e përgjithshme të TV-stacioneve \(janar – mars\)](#) dhe [të dhënat për shtrirjen e stacioneve radiofonike dhe përqindjen në shikueshmërinë e përgjithshme të TV-stacioneve \(janar - mars\) \(prill - qershor\)](#)) dhe të dhënat nga anketa e sipërpërmendur ku thuhet se televizioni është mënyra e dytë më e përdorur për informim për lajmet politike (43%), (43%). EUROTINK, 2023).

Arsyet pse u përzgjedhën për monitorim dhe analizë mediat e lajmeve onlajn janë sepse ajo është një hapësirë më e hapur ndaj narracioneve të dëmshme, kurse të gjitha mediat informative onlajn të monitoruara raportuan dhe morën kompensim për reklamat e paguara politike në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2020. (KSHZ, 2020, [Regjistri i radiodifuzerëve, mediat e shkruara dhe mediat elektronike \(internet-portale\)](#)).

A) AKTORËT POLITIKË

Kriteri për përzgjedhjen: parti politike me më shumë se një deputet në përbërjen parlamentare 2020 – 2024⁶: Aleanca për Shqiptarët – 8 deputetë, Alternativa – 3 deputetë, Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) – 39 deputetë, Lëvizja Demokratike – 3 deputetë, Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) – 13 deputetë, Levica – 2 deputetë, Partia Liberal Demokratike (PLD) – 2 deputetë, Partia e Re Socialdemokrate (PRSD) – 2 deputetë, Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM) – 31 deputetë, Partia Socialiste e Maqedonisë (PSM) – 2 deputetë.

Ekzemplar i faqeve zyrtare në internet i partive politike

Në këtë hulumtim janë ndjekur faqet zyrtare në internet të dhjetë partive politike (me më shumë se një deputet në përbërjen parlamentare 2020 – 2024).

Ekzemplar i faqeve/profileve zyrtare në Fejsbuk të dhjetë partive të përzgjedhura politike

Në këtë hulumtim janë ndjekur faqet/profilet zyrtare në Fejsbuk të dhjetë partive politike (me më shumë se një deputet në përbërjen parlamentare 2020 – 2024).

Ekzemplar i faqeve/profileve zyrtare në Fejsbuk të liderëve të dhjetë partive të përzgjedhura politike

Në këtë hulumtim janë ndjekur faqet/profilet zyrtare në Fejsbuk të liderëve të dhjetë partive politike të përzgjedhura:

1. Arben Taravari
2. Afrim Gashi
3. Hristijan Mickoski

6 Përbërja parlamentare 2020 – 2024, marrë nga [Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut – Deputetë](#)

4. Izet Mexhiti
5. Ali Ahmeti
6. Dimitar Apasiev
7. Monika Zajkova
8. Goran Misovski
9. Dimitar Kovaçevski (do të monitorohet edhe në funksionin e kryeministrit të Qeverisë së RMV-së)
10. Ljupço Dimovski

Ekzemplar i faqeve/profileve zyrtare në Fejsbuk të ministrave të përbërjes qeveritare v 2023 - 2024 (Qeveria e RMV-së, n.d.b)

1. Dimitar Kovaçevski – Kryeministër i Qeverisë së RMV-së
2. Artan Grubi – Zëvendëskryeministër i parë i Qeverisë së RMV -së dhe ministër i Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve midis Bashkësive.
3. Fatmir Bytyqi – Zëvendëskryeministër i Qeverisë së RMV-së i ngarkuar për Çështje Ekonomike, Koordinim të Sektorëve Ekonomikë dhe Investimeve.
4. Bojan Mariçiq – Zëvendëskryeministër i Qeverisë i ngarkuar për Çështje Evropiane
5. Sllavica Gërkovska – Zëvendëskryeministre përgjegjëse për Politika të Qeverisjes së Mirë
6. Oliver Spasovski – Ministër i Punëve të Brendshme
7. Kreshnik Bekteshi – Ministër i Ekonomisë
8. Risto Penov – Ministër i Vetëqeverisjes Lokale
9. Bujar Osmani – Ministër i Punëve të Jashtme
10. Fatmir Besimi – Ministër i Financave
11. Blagoj Boçvarski – Ministër i Transportit dhe Lidhjeve
12. Ljupço Nikolovski – Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave
13. Sllavjanka Petrovska – Ministre e Mbrojtjes
14. Jeton Shaqiri – Ministër i Arsimit dhe Shkencës
15. Jovanka Trençevska – Ministre e Punës dhe Politikës Sociale
16. Bisera Kostadinovska Stojçevska – Ministre e Kulturës
17. Kaja Shukova – Ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
18. Azir Aliu – Ministër i Shoqërisë Informatike dhe Administratës
19. Fatmir Mexhiti – Ministër i Shëndetësisë
20. Krenar Lloga – Ministër i Drejtësisë

B) MEDIAT

Ekzemplar i televizioneve (për ndjekjen e lajmeve kryesore)

Në këtë ekzemplar janë përfshirë TV-stacione publike dhe private në nivel nacional që kanë shikueshmërinë më të madhe (Agjencia për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, 2023a, 2023b), gjithsej nëntë:

1. TVM 1 (publik)
2. TVM 2 (publik, në gjuhën shqipe)
3. Alfa TV (privat)

4. Kanal 5 (privat)
5. TV Sitell (privat)
6. TV 24 (privat)
7. Tellma (Privat)
8. Alsat M (privat, në gjuhën shqipe)
9. TV 21 (privat, në gjuhën shqipe)

Ekzemplar i mediave informative onlajn

Ky ekzemplar përfshin mediat më të lexuara në internet, si në maqedonisht ashtu edhe në shqip, politikat editoriale të të cilave tregojnë pozicione të ndryshme politike (ekzemplar i qëllimshëm). Kriteret shtesë të përzgjedhjes përfshijnë respektimin [e kriterëve për anëtarësim në portalet onlajn](#) në Këshillin për etikë në media në Maqedoni (KEMM) dhe në Regjistrin e mediave profesionale onlajn [Promedia.mk](#), regjistrim në [Regjistrin e radiodifuzerëve, mediave të shkruara dhe mediave elektronike për reklamim politik me pagesë](#) në zgjedhjet parlamentare 2020:

1. Veçer.mk
2. Llokalno
3. Nezavisen
4. Slobodenpeçat
5. A1on.mk
6. MKD.mk
7. Republika
8. Kurir
9. Almakos
10. Tetova sot
11. Nova TV

2.5. QASJA METODOLOGJIKE

PERIUDHA KOHORE

Hulumtimi është kryer në periudhën nga 1 shtatori 2023 deri më 31 maj 2024. Kjo periudhë u nda në dy intervale kohore: e para, një periudhë parazgjedhore dhe përgatitore për partitë që zgjati gjashtë muaj, nga shtatori 2023 deri në shkurt të vitit 2024 dhe periudhën e dytë zgjedhore tremujore, gjatë fushatës (para)zgjedhore dhe zbatimin e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare, nga marsi deri në maj të vitit 2024.

Niveli i parë i analizës: monitorimi

Në hulumtim u realizuan dy monitorime paralelisht:

- Monitorimi i praktikave komunikuese të aktorëve politikë në Maqedoni nëpërmjet monitorimit dhe analizës së: 1. faqeve zyrtare në internet dhe faqeve/profileve zyrtare në Fejsbuk të partive politike nga përbërja parlamentare 2020-2024 që kanë më shumë se një deputet, 2. Faqet/profilet zyrtare në Fejsbuk të liderëve të partive politike, si dhe ministrave gjatë periudhës së monitoruar. Këto kanale onlajn të aktorëve politikë monitoroheshin çdo të katërtën ditë. Monitoruesit e trajnuar kishin për detyrë të lexonin të gjitha postimet në këto kanale në ditët për analiza. Nëse ata vërejnë ndonjë narracion të dëmshëm, atëherë ai postim analizohet më tej në mënyrë të detajuar duke përdorur Formularin 1 ([shih shtojcën](#)).
- Monitorimi i mediave, d.m.th monitorimi i TV-stacioneve (monitorimi i lajmeve qendrore, kryesore) dhe i mediave informative onlajn. Çdo ditë të tretë dhe të katërt lexoheshin të gjitha njoftimet/raportet në mediat onlajn dhe ndiqeshin lajmet (raportet) qendrore në televizionet që trajtonin tema sociopolitike dhe ekonomike. Kriteri i parë i përzgjedhjes ishte: përmendja e të paktën një aktori politik nga ekzemplari i përzgjedhur i aktorëve politikë. Kriteri i dytë i përzgjedhjes ishte prania e një narracioni të dëmshëm. Raporti në lajmet/postimin kryesor në median onlajn, ku përmendet ndonjë subjekt politik, kurse përmban një narracion të dëmshëm, analizohet më tej në mënyrë të detajuar duke përdorur formularë të veçantë, Formulari 2 për televizionet dhe Formulari 3 për mediat onlajn ([shih Instrumentet](#)).
Njësia e analizës është një postim i veçantë.

Niveli i dytë i analizës

Në këtë nivel të analizës u analizuan neologjizmat e përdorura nga aktorët politikë në faqet e tyre zyrtare në internet, përkatësisht faqet/profilet zyrtare në Fejsbuk të mbuluara në monitorim.

Njësia e analizës në këtë rast është një postim individual në faqet zyrtare të internetit dhe faqet zyrtare, përkatësisht profilet në Fejsbuk, nga aktorët politikë në periudhën e caktuar.

Kriteri i përzgjedhjes është që shpallja të përmbajë neologjizma. Për sa u përket vetë neologjizmave për analizë, kriteri i përzgjedhjes është që ata përfaqësojnë një narracion të dëmshëm (qoftë vetë ose të kontekstualizuar), domethënë të tregojnë diskreditim dhe nënçmim të kundërshtarëve politikë (si individualë ashtu edhe kolektiv) dhe i referohen: 1. aktorit politik (si individual ashtu edhe kolektiv) dhe 2. llojeve të pushtetit/qeverisjes dhe tendencave sociopolitike.

Në këtë analizë është përdorur Formulari 4 (shih Instrumentet).

2.6. TEKNIKA METODOLOGJIKE PËR ANALIZË TË TË DHËNAVE

Hulumtimi është eksploratorues, kurse analiza është kualitative, me kuantifikim të caktuar bazë. Përveç metodave të përgjithshme shkencore të interpretimit dhe klasifikimit, janë zbatuar teknikat metodologjike të mëposhtme për analizën e të dhënave:

- **Analiza e përmbajtjes:** Analiza konceptuale dhe relacionale e përmbajtjes së shpalljeve në faqet zyrtare në internet dhe në faqet/profilet zyrtare në Fejsbuk të aktorëve kryesorë politikë: parti politike, liderë të partive politike, ministra, si dhe të raporteve në lajmet kryesore, qendrore të TV-stacioneve dhe shpalljeve në mediat informative onlajn të cilat kanë të bëjnë me tema shoqërore-politike dhe ekonomike.
- **Analiza kritike e diskursit** – со примена на критичка дискурзивна анализа, се испитуваат јазикот (јазичните средства), реториката и стратегиите за врамување што ги користат политичките актери во споменатите онлајн канали и медиумите (телевизиите и онлајн медиумите).
- **Analiza e komponentëve (si njësi leksikore)** – me zbatimin e kësaj analize analizohen komponentët fjalëformues nga aspekti leksikor-semantik dhe stilistik.

2.7. INSTRUMENTE

Në këtë hulumtim janë krijuar, kontrolluar dhe përdorur 4 lloje ekzemplarësh për monitorim dhe analizë:

- Ekzemplar 1:** për ndjekjen dhe analizë të faqeve zyrtare në internet dhe faqeve/profileve zyrtare në Fejsbuk të ekzemplarit të aktorëve politikë të përzgjedhur
- Ekzemplar 2:** për ndjekjen dhe analizë lajmeve kryesore të TV-stacioneve të përzgjedhura
- Ekzemplar 3:** për ndjekjen dhe analizë të përmbajtjeve informative të mediave informative onlajn të përzgjedhura
- Ekzemplar 4:** për analizë komunikologjike të neologjizmave

Aspekte që ndiqen në ekzemplarin 1, 2 dhe 3 janë si vijon:

- **Sa shpallje/artikuj** janë me narracion të dëmshëm
- **Kur janë transmetuar/publikuar** shpalljet/postimet e narracioneve të dëmshme
- **A janë paralajmëruar** (për TV)
- **Kohëzgjatja e shpalljeve** në tërësi (për TV)
- **Zhanri/Lloji i postimit**

- **Tema e shpalljeve/postimeve** (fusha kryesore e temës/saktësimi i nëntemës)
- **Aktorët në shpallje** (numri i përgjithshëm i aktorëve, mënyra e paraqitjes së aktorëve kryesorë, kush dhe si i vlerëson aktorët)
- **Burimet** në të cilat mbështeten media (numri dhe lloji i burimeve, transparenca në vendosjen e burimeve të informacionit, ana e burimeve)
- **Vizualizimi** i shpalljes
- **Arsyeja e shpalljes/postimit**
- **Indikatorët e narracioneve të dëmshme** [cili tregues është i pranishëm, kush e “prodhon” indikatorin (TV), qëndrimi i gazetarit ndaj narracioneve të dëmshme të aktorëve politikë (TV)]
- **Për cilat rrëfime të dëmshme** është dëshmuar indikator?

Ekzemplari 4 është përshtatur pjesërisht nga një prej modeleve bazë të komunikimit që përbëhet nga pesë pyetje (“kush thotë”, “çfarë thotë”, “kujt”, “nëpërmjet cilit kanal” dhe “me çfarë efekti”) të teoricienit të komunikimit Harold Lasswell (Lasswell, 1948), me qëllim që të merren parasysh elementët kryesorë të procesit të komunikimit dhe të sigurohet një paraqitje më koncize e analizës.

3. NARRACIONE TË DËMSHME POLITIKE NËPËRMJET NUMRAVE

Analiza e aktorëve politikë iu përgjigjet pyetjeve “Me çfarë dinamike i përdorin aktorët politikë narracionet e dëmshme?”, “Cilat janë narracionet e dëmshme më të përdorura?”, “Në çfarë forme përcillen narracionet e dëmshme?” **Analiza e mediave**, përveç pyetjeve të njëjta si për aktorët politikë, u përgjigjet edhe pyetjeve: “Kush e prodhoi narracionin e dëmshme – aktori politik apo gazetari?”, “Cili është qëndrimi i gazetarit ndaj narracionit të dëmshme të krijuar nga aktori politik?” dhe “Sa palë janë përfaqësuar dhe sa burime konsultohen në postimet me narracione të dëmshme?”

Që të Për të merret një pasqyrë më e thellë dhe më e nuancuar të komunikimit të narracioneve të dëmshme, analiza shqyrton në mënyrë krahasuese të dhëna nga dy periudha më të gjata kohore, të cilat quhen “parazgjedhore” dhe “zgjedhore”. Periudha “parazgjedhore” përfshin periudhën nga shtatori 2023 deri në shkurt 2024 dhe është quajtur kështu sepse gjatë kësaj periudhe ishte tashmë e sigurt se zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare do të zhvilloheshin pothuajse në të njëjtën kohë⁷. Edhe pse në këtë të ashtuquajtur Periudha “parazgjedhore”: partitë politike tashmë kanë filluar fushatën jozyrtare parazgjedhore, por ende është larg periudhës zyrtare zgjedhore. Periudha “zgjedhore” përfshin tre muajt – mars, prill dhe maj 2024, kur pas miratimit të Vendimit për shpalljen e zgjedhjeve parlamentare, subjektet politike i intensifikuan aktivitetet e tyre parazgjedhore. Qëllimi i krahasimit të dy periudhave të përcaktuara “teorikisht” është të zbulojë hollësitë e mundshme në komunikimin politik dhe raportimin mediatik, të cilat u treguan të justifikuara. Analiza bazohet në të dhënat të përgjithshme, nuk analizohen aktorë politikë individualë apo media, por në mënyrë të përgjithshme. Analizat e detajuara të secilit subjekt politik apo medie individuale janë të disponueshme në [analizat periodike](#) (gjithsej pesë), [gjashtëmujore](#) (shtator 2023 – shkurt 2024) dhe analizën [tremujore](#) (mars – maj 2024).

7 Zgjedhjet parlamentare janë shpallur më 14.2.2024, kur Kryetari i Kuvendit në përputhje me obligimet kushtetuese dhe obligimet ligjore, e nënshkroi Vendimin për shpalljen e zgjedhjeve për deputetë në Kuvendin e RMV-së

3.1. ANALIZA E NARRACIONEVE TË DËMSHME POLITIKE TË KRIJUARA NGA AKTORËT POLITIKË

Gjatë monitorimit të faqeve zyrtare të internetit dhe faqeve në Fejsbuk të aktorëve të përcaktuar politikë, u konstatua se në tri nga dhjetë parti politike (Partia Liberal Demokratike, Partia e Re Socialdemokrate dhe Partia Socialiste) nuk janë vërejtur narracione të dëmshme. Në profilet në Fejsbuk të liderëve të këtyre tri partive politike nuk janë vërejtur narracione të dëmshme. Nga njëzet përfaqësuesit e qeverisë, te 11 përfaqësues nuk janë vërejtur narracione të dëmshme. Prandaj, analiza e narracioneve të dëmshme është përbë për aktorët e mëposhtëm politikë:

- Faqet zyrtare të internetit dhe profilet në Fejsbuk të **shtatë partive politike** (tre nga blloku maqedonas dhe katër nga blloku shqiptar)
- Profilet zyrtare në Fejsbuk të **shtatë liderëve** të të njëjtave parti politike dhe
- Profilet zyrtare në Fejsbuk të **nëntë përfaqësuesve qeveritarë**.

Në tabelë është dhënë pasqyrë e aktorëve politike kanalet e komunikimit të të cilëve ishin lëndë e monitorimit të analizës.

| PARTI POLITIKE – FAQE ZYRTARE NË INTERNET DHE PROFILET NË FEJSBUK | |
|---|---------------------------|
| Blloku maqedonas | Blloku shqiptar |
| 1. VMRO DPMNE | 4. Aleanca për shqiptarët |
| 2. LSDM | 5. Alternativa |
| 3. Levica | 6. BDI |
| | 7. Lëvizja demokratike |
| LIDERË TË PARTIVE POLITIKE – PROFILE ZYRTARE NË INTERNET | |
| Blloku maqedonas | Blloku maqedonas |
| 1. Hristijan Mickoski | 4. Arben Taravari |
| 2. Dimitar Apasiev | 5. Afrim Gashi |
| 3. Dimitar Kovaçevski (në këtë funksion nga shkurti 2024) | 6. Ali Ahmeti |
| | 7. Izet Mexhiti |
| PËRFAQËSUESIT E QEVERISË – PROFILE ZYRTARE NË INTERNET | |
| Blloku maqedonas | Blloku maqedonas |
| 1. Bisera K. Stojçevska | 6. Artan Grubi |
| 2. Ljupço Nikollovski | 7. Kreshnik Bekteshi |
| 3. Dimitar Kovaçevski (shtator 2023 – janar 2024) | 8. Krenar Lloga |
| 4. Bojan Mariçiq | 9. Jeton Shaqiri |
| 5. Jovanka Trençevska | |

Tabela 1. Pasqyrë e aktorëve të analizuar politikë

Të dhënat analizohen dhe paraqiten si të dhëna të shumuara për aktorët politikë si grup, me dhënie dhe me krahasime për nëngrupin e partive politike, për shkak të rolit të tij si “prodhuesi” më i madh dhe më aktiv i narracioneve të dëmshme.

DINAMIKA E PËRDORIMIT TË NARRACIONEVE TË DËMSHME

Në periudhën nga shtatori 2023 deri në maj të vitit 2024, u bë monitorimi i faqeve zyrtare të internetit dhe profileve në Fejsbuk të aktorëve politikë për gjithsej 137 ditë. Çdo muaj, secili prej aktorëve politikë monitorohej çdo të tretën dhe të katërt ditë me radhë të muajit ose gjithsej 14 deri në 16 ditë, në varësi të numrit të ditëve në muaj. Dinamika e krijimit dhe shpërhapjes së narracioneve të dëmshme analizohet nga dy aspekte: 1) **sa postime** me narracione të dëmshme janë komunikuar nga aktorët politikë dhe 2) **sa narracione të dëmshme përmbajnë postimet**.

Sa postime me narracione të dëmshme kanë pasur aktorët politikë

Monitorimi i faqeve zyrtare të internetit dhe profileve në Fejsbuk të aktorëve politikë regjistroi gjithsej **1342 postime me narracione të dëmshme** që ata i kanë përcjellë në komunikimin e tyre me publikun. **Çdo muaj**, numri i postimeve me narracione të dëmshme⁸ nga të gjithë aktorët politikë është **mesatarisht mbi 100**, ndërsa në baza **ditore, mesatarisht rreth katër deri në gjashtë postime të dëmshme** komunikohen në një ose më shumë nga kanalet e tyre të komunikimit.

Numri i postimeve të dëmshme të krijuara nga aktorët politikë është më i lartë dhe identik në **dhjetor të vitit 2023 dhe në prill të vitit 2024** (Figura 1). Mesatarisht **në nivel ditor**, në këta dy muaj janë regjistruar **më shumë se gjashtë postime me narracione të dëmshme**. Gjatë dhjetorit 2023, disa çështje në sferën sociopolitike që prekin të ardhmen e vendit ishin aktuale, si përbërja e qeverisë së ardhshme të përkohshme dhe propozimet për kandidatët presidencialë, Samiti BE-Ballkani Perëndimor dhe amendamentet kushtetuese si kusht për vazhdimin e rrugës evropintegritimeve të vendit. Këto çështje mundësuan një bazë “pjellore” për krijimin e narracioneve të dëmshme, që mund të jetë një arsye për numrin më të madh të narracioneve të dëmshme këtë muaj. Gjatë muajit prill 2024, komunikimi i partive politike dhe liderëve të tyre u fokusua në fushatat e vazhdueshme për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare, të cilat po zhvilloheshin njëkohësisht. Subjektet politike gjatë kësaj periudhe kanë pasur komunikim të shpeshtë me qytetarët nëpërmjet takimeve, tubimeve dhe mitingjeve të drejtpërdrejta, duke promovuar ofertën e tyre politike si më të mirë se ajo e kundërshtarëve të tyre politikë, në mënyrë që në këtë muaj konteksti ishte sërish i favorshëm për krijimin dhe shpërhapjen e një numri narracionesh të dëmshme në komunikimin e tyre nëpërmjet faqeve të internetit ose profileve në Fejsbuk.

8 Në tekstin e mëtejshëm shpallje të dëmshme.




Figura 1. Numri i shpalljeve me narracione të dëmshme të aktorëve politikë të analizuar, sipas muajve

Sipas periudhës, mesatarisht **në muaj** vihen re rreth shtatë **shpallje më shumë me narracione të dëmshme në periudhën parazgjedhore gjashtëmujore** (nga shtatori 2023 deri në shkurt 2024) në nivel të të gjithë aktorëve politikë, kurse **rënie e ulët në këtë trend** të shpalljeve me narracion të dëmshëm **në periudhën zgjedhore** – mars – maj 2024 (Figura 2).




Figura 2. Numri mesatar mujor i shpalljeve me narracion të dëmshëm të subjekteve politike të analizuar (parti politike, liderë dhe përfaqësues qeveritarë)

Parë në aspektin e tri nëngrupeve të analizuar të aktorëve politikë (parti, liderë dhe funksionarët qeveritarë), nga numri i përgjithshëm i shpalljeve me narracion të dëmshëm, 1103 ose **82%** të tyre **kanë shpallur partitë politike**. Kjo pritej, për shkak të pjesëmarrjes së tyre “udhëheqëse” në grupin e aktorëve politikë, i njëjti trend i **numrit më të madh** të shpalljeve është vënë re në **dhjetor të vitit 2023** dhe **prill të vitit 2024**. Prandaj, përsëri, në tremujorin zgjedhor vihet re **rënie e theksuar** në numrin e shpalljeve me narracione të dëmshme, prandaj **në muajin maj 2024 ka pothuajse tri herë më pak shpallje, në krahasim me dhjetorin e vitit 2023** (Figura 3).




Figura 3. Numri i shpalljeve me narracione të dëmshme të faqeve në internet dhe profileve në Fejsbuk të partive politike, sipas muajve

Ngjashëm si edhe në nivelin e të gjithë aktorëve politikë, edhe te **partitë politike numri mesatar mujor i shpalljeve është më i vogël se në tremujorin: mars – maj 2024** (Figura 4).




Figura 4. Numri mesatar mujor i shpalljeve me narracione të dëmshme të partive politike

Te **liderët** e partive politike dhe te **përfaqësuesit qeveritarë**, tendenca e **numrit mesatar mujor i shpalljeve të dëmshme** priret të jetë **pothuajse dy herë më i lartë në tremujorin e fundit** krahasuar me gjashtëmujorin e parë të monitorimit. Numri mesatar mujor i shpalljeve të liderëve në gjashtëmujorin e parë të monitorimit është 14 shpallje, kurse te përfaqësuesit qeveritarë 4 shpallje, ndërsa në tremujorin e fundit, zgjedhor, te liderët janë shënuar mesatarisht 23 shpallje me narracione të dëmshme, kurse te përfaqësuesit qeveritarë - 10. Duket se **gjatë periudhës zgjedhore, në nivel individual, liderët e partive dhe funksionarëve qeveritarë kanë komunikuar narracione të dëmshme për publikun**, për dallim nga partitë politike prej të cilave vinë.

Sa narracione të dëmshme janë krijuar dhe shpërndarë nëpërmjet shpalljeve

Në lidhjen me numrin e narracioneve të dëmshme të krijuara – analiza tregon se në 1342 shpallje në periudhën nëntëmujore, janë prodhuar tre herë më shumë narracione të dëmshme – **3967 narracione të dëmshme** (Figura 5). Mesatarisht, **në një shpallje janë vërejtur tri narracione të dëmshme**. Siç shihet qartë nga Figura 5, ka një trend në rritje të prodhimit të narracioneve të dëmshme në periudhën parazgjedhore, me kulminim në fund të vitit 2023 (në dhjetor janë prodhuar 601 narracione të dëmshme). Nga fillimi i vitit 2024, vihet re një rënie të ndjeshme deri në prill, kur retorika e dëmshme u intensifikua sërish. Kjo nuk është për t'u habitur duke pasur parasysh se fushata zyrtare zgjedhore për zgjedhjet presidenciale po zhvillohej në prill dhe nga fundi i muajit u organizua rrethi i parë i votimit. Ky është një muaj me aktivitete intensive parazgjedhore, takime me qytetarë, konferenca për shtyp, deklarata ku secili prej aktorëve politikë impononte retorikën e vet, shpeshherë shumë të dëmshme. Kanalet e komunikimit të të gjithë aktorëve politikë të analizuar ishin të mbushura me retorika të dëmshme, e cila, siç do të tregojë pjesa tjetër e analizës, ua pamundësoi qytetarëve të kuptojnë faktet, programet zgjedhore, t'i vlerësojnë ato në mënyrë kritike dhe të marrin vendimet e duhura për zgjedhjet e ardhshme.




Figura 5. Numri i narracioneve të dëmshme të dala nga aktorët politikë të analizuar dhe të transmetuar në shpalljet, sipas muajve

Në bazë mujore, publiku u ekspozua ndaj **narracioneve të dëmshme** mesatarisht **441** herë (Figura 6), ose në baza **ditore** mesatarisht **15** herë. Duke pasur parasysh se narracionet kanë fuqinë të ndikojnë mbi emocionet, qëndrimet dhe sjelljen e njerëzve, ekspozimi ndaj narracioneve të shpeshta të dëmshme të shoqëruara me ndjenja të forta, mund të ketë pasoja të gjera për polarizimin social, sjelljen dhe pjesëmarrjen politike dhe demokracinë në përgjithësi. Në pjesën e analizës kualitative të fjalëve që lidhen me narracionet e dëmshme, analizohet më detajisht komponenti emocional i narracioneve të dëmshme.




Figura 6. Numri mesatar mujor i narracioneve të dëmshme të dala nga të gjithë aktorët politikë (në nivel të nëntë, gjashtë dhe tri muaj)

Nga të gjithë aktorët politikë, pikërisht partitë politike prodhojnë më shumë narracione të dëmshme (3365), ku numri më i madh janë në periudhën e parë gjashtëmujore (72% - Figura 7). Siç është ilustruar në Figurë, i njëjti trend i dinamikës së prodhimit të narracioneve të dëmshme vihet re edhe në nivel të të gjithë aktorëve politikë, si rrjedhim është më se e qarte sepse pikërisht **partitë politike janë prodhuesit kryesorë të narracioneve të dëmshme** që e diktojnë trendin në nivel të të gjithë aktorëve politikë, duke i përfshirë edhe përfaqësuesit qeveritarë. Në bazë ditore, mesatarisht janë komunikuar 16 narracione të dëmshme. **Mjaft më pak** se nga të gjithë muajt e analizuar, partitë politike kanë prodhuar narracione të dëmshme **në maj**, muajin kur përfunduan zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale.




Figura 7. Numri i narracioneve të dëmshme të prodhuara nga partitë politike dhe të transmetuara në shpallje, sipas muajve

Trendi i dinamikës mujore të prodhimit të narracioneve të dëmshme është reflektuar edhe në pothuajse dyfishi më i madh i numrit mesatar të narracioneve të dëmshme që janë prodhuar në muaj në periudhën parazgjedhore, kështu në periudhën shtator - dhjetor 2023, mesatarja mujore e narracioneve të dëmshme të cilat i kanë marrë qytetarët që ndjekin kanalet e komunikimit të partive politike ishte **428 narracione të dëmshme** (Figura 8). **Gjatë periudhës zgjedhore, mesatarja mujore e narracioneve të dëmshme ishte 265.**




Figura 8. Numri mesatar i narracioneve të dëmshme të prodhuara nga partitë (në nivel prej nëntë, gjashtë dhe tre muajsh)

LLOJET MË TË SHPESHTA TË NARRACIONEVE TË DËMSHME

Aspekti tjetër i analizës ka të bëjë me llojet e narracioneve të dëmshme që janë prodhuar më shpesh nga aktorët politikë dhe duhet të na japë përgjigje për pyetjen se si kanë qenë 3967 narracionet e dëmshme, kujt i janë referuar, cili ishte qëllimi i tyre, kujt i drejtoheshin dhe të ngjashme. Ky aspekt i analizës përfshin katër nënaspekte: 1) cilat lloje të narracioneve të dëmshme nga narracionet e përcaktuara teorikisht janë vërejtur, 2) me cilat lidhen më shpesh tema janë narracionet e dëmshme, 3) cilat janë pesë narracionet e dëmshme më të përdorura dhe 4) si kanë komunikuar aktorët politikë dhe ndaj kujt i kanë drejtuar narracionet e dëmshme?

Cilat lloje të narracioneve të dëmshme prej të përcaktuarave janë vënë re

Prej [16 narracioneve të dëmshme të përcaktuara](#) në hulumtim, u vu re se aktorët politikë prodhuan 14 prej tyre (Tabela 2). Narracionet e dëmshme “seksizëm” dhe “ksenofobia” nuk vërehen aspak, ndërsa narracionet “etnocentrizëm”, “teori i konspirative” dhe “informacion keqdashës” prodhohen shumë rrallë, respektivisht 19, 12 dhe 4 herë (Tabela 2, kolona 1, tre rreshtat e fundit).

| Narracion i dëmshëm* | Numri i përgjithshëm i narracioneve të dëmshme të prodhuara | | | Mesatarja mujore e prodhuar | | |
|---|---|--------------|-------------|-----------------------------|--------------|-------------|
| | Nëntë muaj | Gjashtë muaj | Tri muaj | Nëntë muaj | Gjashtë muaj | Tre muaj |
| Minimi i besimit | 1456 | 1158 | 298 | 162 | 193 | 99,3 |
| Përzgjedhje e njëanshme | 1204 | 879 | 326 | 134 | 147 | 109 |
| Sulme në bazë personale | 338 | 220 | 118 | 37,6 | 36,7 | 39,3 |
| Populizëm | 292 | 215 | 77 | 32,4 | 35,8 | 25,7 |
| Nxitja e ndarjeve | 264 | 161 | 103 | 29,3 | 26,8 | 34,3 |
| Ndikimi i huaj | 134 | 93 | 41 | 14,9 | 15,5 | 13,7 |
| Shpërhapja e panikut dhe frikës | 84 | 41 | 43 | 9,33 | 6,83 | 14,3 |
| Dezinformacione | 53 | 53 | 0 | 5,89 | 8,83 | 0 |
| Përmbajtje e manipulative audio dhe vizuale | 51 | 42 | 9 | 5,67 | 7 | 3 |
| Patriotizëm ekstrem dhe nacionalizëm | 30 | 19 | 11 | 3,33 | 3,17 | 3,67 |
| Gjuhë e urrejtjes | 26 | 11 | 15 | 2,89 | 1,83 | 5 |
| Etnocentrizëm | 19 | 10 | 9 | 2,11 | 1,67 | 3 |
| Teori të konspiracionit | 12 | 8 | 4 | 1,33 | 1,33 | 1,33 |
| Informacione keqdashëse | 4 | 3 | 1 | 0,44 | 0,5 | 0,33 |
| Gjithsej | 3967 | 2913 | 1055 | 441 | 486 | 352 |
| Mesatarja ditore e nxjerrë | | | | 14,7 | 16,2 | 11,7 |

* Emërtimet e narracioneve të dëmshme në version të shkurtër. Emërtimet e tërësishme të lexohen [këtu](#).

Tabela 2. Shpeshtësia e narracioneve të dëmshme të prodhuara nga të gjithë aktorët politikë, numri mesatar mujor i narracioneve të dëmshme dhe numri mesatar ditor i narracioneve të dëmshme

Shpjegimi i çdo narracioni prej 16 narracioneve është dhënë në pjesën metodologjike të këtij publikimi dhe për shkak të thjeshtëzimit, në pjesën e analizave të të dhënave janë shpjeguar përsëri vetëm pesë narracionet e dëmshme më të shpeshta.

Me cilat tema lidhen më shpesh narracionet e dëmshme

Çdo narracion, çdo histori, bazohet në një temë më të gjerë ose më të ngushtë, për të cilën krijuesit e narracionit kanë diçka që t'i përcjellin opinionit të vet, publikut. Kështu edhe aktorët politikë, ose më mirë, partitë politike, kanë krijuar narracione të dëmshme për tema të caktuara për të cilat donin të përcillnin mesazhe. Ky nën aspekt i analizës së narracioneve të dëmshme trajton saktësisht se cilat ishin temat më të shpeshta apo më të rëndësishme rreth të cilave partitë politike krijuan narracionet e tyre të dëmshme.

Analiza dëshmoi se politika e brendshme ishte vazhdimisht tema kryesore në krijimin dhe përhapjen e narracioneve të dëmshme gjatë nëntë muajve të monitorimit (Figura 9). Ata janë "frymëzuar" nga tema të tilla si procesi i integritetit evropian, ndryshimet kushtetuese që lidhen me të, ose raporti i përparimit të vendit i Komisionit Evropian (nëntor 2023), nëpërmjet marrëdhënies qeveri-opozitë, deri te ngjarjet aktuale të përditshme me interes të gjerë shoqëror, si amendamentet e ligjeve (Ligji për Amnisti, Kodi Penal), problemet në funksionimin e pushtetit lokal, ndërhyrja e dhunshme në Shoqërinë aksionare shtetërore për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror M-NAV SHA Shkup (janar 2024) dhe sigurisht formimi i Qeverisë teknike (kalimtare), si dhe zgjedhjet presidenciale dhe

parlamentare në prill - maj 2024. Në të nëntë muajt politika e brendshme ka qenë fusha në të cilën mbi 70% e narracioneve të dëmshme janë krijuar në dy muajt e fundit (prill dhe maj të vitit 2024) u zmadhua në mbi 80 % (84 % në prill dhe 87 % në maj të vitit 2024).

Gjithsesi, politika e brendshme është fusha që ndikon më drejtpërdrejt në jetën e përgjithshme të qytetarëve, lidhet drejtpërdrejt me zgjedhjet e zhvilluara në prill dhe maj 2024, dhe si rrjedhim është më e ndjeshme ndaj manipulimit të emocioneve të qytetarëve. Temat e tjera pothuajse u neglizhuan, domethënë “të patrajtueshme sa duhet” për të krijuar narracione të dëmshme. Megjithatë, krahasuar me temat e tjera ⁹, temat si ekonomia, korrupsioni dhe krimi u shfaqën më shpesh si fusha me të cilat lidheshin narracionet e dëmshme. Shpalljet me narracione të dëmshme lidhur me krimin dhe korrupsionin më shpesh u referoheshin sjelljeve korruptive të strukturave qeverisëse dhe tolerancës së tyre ndaj krimit (ndryshimet në Kodin Penal, lidhja e kontratës me konsorciumin “Behtel dhe Enka” për ndërtimin e autostradave, krimi në biznesin e lojërave të fatit). Narracionet e dëmshme lidhur me gjetjet kriminale më shpesh i referoheshin bllokut shqiptar në Qeverinë e atëhershme. Nga ana tjetër, narracionet e dëmshme të bazuara në temat ekonomike, më shpesh kanë të bëjnë me politikën e çmimeve të zbatuara nga Qeveria e atëhershme dhe inflacionin, rritjen e TVSH-së, rritjen e çmimeve për shërbimet e dhëna nga Agjencia e Kadastrës së Pasurive të Patundshme etj.




Figura 9. Tema në të cilat shfaqen narracionet e dëmshme

Cilat janë pesë narracionet e dëmshme të përdorura më shpesh

Nga 14 llojet e narracioneve të dëmshme të vëzhguara, jo të gjitha janë krijuar njësoj dhe në mënyrë të balancuar, por duket se partitë politike më shpesh i kanë krijuar ato që u dukeshin më të përshtatshmet për arritjen e qëllimeve të vendosura, kurse kjo “luftën” politike gjithmonë nënkupton marrjen e pushtetit. Pa përjashtim, secili prej aktorëve politikë ka krijuar të njëjtat narracione të dëmshme që gjenden në pesë vendet e para për nga shpeshësia, ato që janë dëshmuar si instrumentale në arritjen e suksesit në luftën për pushtet.

Analiza dëshmoi se llojet e narracioneve të dëmshme të krijuara më shpesh e minojnë besimin e qytetarëve në sistem (“minim i besimit në institucionet”), duke mos treguar të gjithë pamjen dhe të gjitha faktet (“përzgjedhje e njëanshme”), kurse në të njëjtën kohë duke i nënçmuar në mënyrë të pahijshme kundërshtarë (“sulme mbi baza personale”), duke mos lënë hapësirë për shpresë

9 Janë përcaktuar 11 kategori temash: politika e brendshme, ekonomia, politika e jashtme, arsimi, shëndetësia, politika sociale, kultura, gjyqësore, krimi, korrupsioni dhe sporti.

në aftësinë e atyre të cilëve qytetarët u kanë dhënë besimin për t'i udhëhequr, duke bërë dallimin midis “të mirës” dhe “të keqes” (“nxitjes së përçarjeve”) dhe vënia në dyshim e qytetarëve nëse janë edhe “të mirë” apo “të këqij”, nëse i kanë dhënë dikujt besim dhe ndjenjën e ndarjes, jo vetëm midis aktorëve politikë, por edhe midis tyre, në publik. Narracionet e tilla mund dhe shkaktojnë pasoja afatgjata në atmosferën sociale, sjelljen dhe kulturën, në një kuptim negativ, në shfaqjen e ndjenjave inhibiruese të pafuqisë, zhgënjimit madje dhe dëshpërimit, të cilat nga ana tjetër mund të ndikojnë në angazhimin publik.

Rrëfimet dhe narracionet janë mjet i njohur dhe i fuqishëm në edukimin e fëmijëve, sepse në mënyrën më të lehtë mund të preken arritur ndjenjat e tyre dhe në këtë mënyrë edhe te kuptimi i tyre i mesazhit që dëshiron të përcillet ose që të nxitet një sjellje e caktuar të dëshiruar që është e dobishme për fëmijët. Qëllimi i narratorit, “edukatorit” është i mirë dhe synon të mbështesë zhvillimin e fëmijës, ndërtimin e personalitetit të tij. Ky krahasim me fëmijët nuk synon të nënçmojë qytetarët që duhet të marrin vendime të rëndësishme në procesin demokratik, si zgjedhjet, sepse janë fëmijë të vegjël “të papjekur”. Përkundrazi, krahasimi nis nga e njëjta premisë e dhënies së besimit ndaj një personi që mund të na vendosë në rrugën e duhur – për fëmijët ata janë të rriturit – prindi/kujdestari, mësuesi, trajneri etj., për qytetarët, te qytetarët në rastin e zgjedhjeve demokratike, janë politikanët tek të cilët ata e vendosin besimin e tyre se ata e dinë të zgjedhin, hartojnë dhe udhëheqin rrugën e zhvillimit të shoqërisë dhe të mirëqenies së të gjithë qytetarëve. Si rrjedhim, duke përcjellë mesazhe negative nëpërmjet këtyre narracioneve, aktorët politikë manipulojnë besimin e dhënë nga qytetarët dhe nuk kontribuojnë në asnjë mirëqenie shoqërore, manipulojnë ndjenjat e njerëzve dhe nuk krijojnë një mjedis të favorshëm që do të nxisë të menduarit kritik, të bazuar në fakte dhe argumente.

Hyrja në këtë pjesë të analizës është “inspiruar” nga njohuria se numri më i madh ose 90% e 14 narracioneve të dëmshme të vëna rre hyjnë te pesë narracionet e dëmshme: “minim i besimit tek institucionet dhe mediat”, “përzgjedhja e njëanshme”, “sulmet personale”, “populizmi” dhe “nxitja e ndarjeve”. Më të shpeshtat janë “minimi i besimit” dhe “përzgjedhja e njëanshme” (2/3 ose 67%). Shumë pas tyre janë “sulmet personale”, “nxitja e ndarjes” dhe “populizmi”, kurse nëntë narracionet e mbetura të dëmshme janë nën 3% (Figura 10).




Figura 10. Pesë narracionet e dëmshme më të shpeshta

Duke pasur parasysh **periudhën** e analizës, ekzistojnë **dallime në shpeshtësinë e tri narracioneve të dëmshme**. Domethënë, në tremujorin e fundit, “nxitja e ndarjeve”, “sulmet personale” dhe “përzgjedhja e njëanshme” janë prodhuar më shpesh krahasuar me gjashtë muajt e parë (Tabela 3, kolona e fundit). Kjo ndryshon edhe rendin e narracioneve në periudhën mars - maj 2024, kështu që “përzgjedhja e njëanshme” është e para në frekuencë dhe “nxitja e ndarjeve” është narracioni i katërt në frekuencë. Ky ndryshim në narracion ndoshta nuk është i rastësishëm, duke pasur parasysh se ndodh gjatë fushatave zgjedhore dhe zgjedhjeve, gjatë të cilave aktorët politikë i “modifikuan” ose “përshtatën” narracionet sipas interesave të tyre në lidhje me perspektivat zgjedhore.

| Narracioni i dëmshëm | Frekuenca e prodhimit | | |
|-------------------------|---|--|---|
| | Gjithsej gjatë nëntë muajve (sht. 2023 – maj 2024) (% , N=3967) | Gjatë gjashtë muajve të parë (sht 2023 – shkurt 2024) (% , N=2913) | Gjatë tre muajve të fundit (mars – maj 2024) (% , N=1055) |
| Minimi i besimit | 37 % | 40 % | 28 % |
| Përzgjedhje e njëanshme | 30 % | 30 % | 31 % |
| Sulme në bazë personale | 9 % | 8 % | 11 % |
| Populizëm | 7 % | 7 % | 7 % |
| Nxitje e ndarjeve | 7 % | 6 % | 10 % |

Tabela 3. Pasqyrë e narracioneve të dëmshme të përdorura më shpesh nga të gjithë aktorët politikë

Prodhuesi “më të shpeshtë” të këtyre pesë narracioneve më të shpeshta janë **partitë politike**, përkatësisht **mbi 80% e narracioneve të dëmshme të përgjithshme të prodhuara** nga aktorët politikë. **Rendi sipas shpeshtësisë** së narracioneve të dëmshme është i njëjtë me atë të përgjithshmin për të aktorët politikë vetëm te partitë politike, kurse **te liderët politikë dhe funksionarët qeveritarë ka dallime të caktuara në rendin e vendit të parë dhe të dytë sipas shpeshtësisë**. Domethënë edhe liderët edhe funksionarët qeveritarë në **vendin e parë** është narracioni i dëmshëm **“përzgjedhja e njëanshme”**. Te funksionarët “populizmi” nuk është midis pesë më të shpeshtëve – në vend të tij u shfaq “ndikimi i jashtëm” si narracioni i katër më i shpeshtë, kurse “sulme ndaj personalitetit” është i fundit nga këta të pestët sipas shpeshtësisë. (Tabela 4).

| Narracioni i dëmshëm | Shpeshtësia e prodhimit (% ¹⁰) | | |
|--|--|----------------------------|------------------------|
| | Parti politike | Liderë të partive politike | Përfaqësues qeveritarë |
| Minimi i besimit në institucionet dhe mediat | 1297 (39 %) | 128 (28 %) | 31 (22 %) |
| Përzgjedhja e njëanshme | 1015 (30 %) | 139 (30 %) | 50 (35 %) |
| Sulme në bazë personale | 273 (8 %) | 55 (12 %) | 10 (7 %) |
| Populizmi | 245 (7 %) | 41 (9 %) | / |
| Nxitja e ndarjeve | 223 (7 %) | 24 (5 %) | 17 (12 %) |
| Ndikimi i huaj | / | / | 11 (8 %) |

Tabela 4. Pasqyra e pesë narracioneve më të shpeshta të dëmshme sipas grupit aktorë politikë: parti politike, liderë politikë dhe përfaqësues qeveritarë

¹⁰ **Shënim:** përqindjet janë llogaritur nga numri i përgjithshëm i narracioneve të dëmshme sipas grupit, përkatësisht për partitë politike N = 3365, për liderë N = 458 dhe për përfaqësues qeveritarë N = 144.

Si kanë komunikuar aktorët politikë dhe kujt i drejtohen narracionet e dëmshme

Narracioni (rrëfimi) ka aktorë, persona për të cilët rrëfehët, të cilëve u dërgohen mesazhe, për të cilët rrëfyesit konsiderojnë se janë të rëndësishme që t'i jepen publikut. Si rrjedhim, rrëfyesi i përzgjedh me kujdes fjalët, frazat dhe fjalitë që të ketë mundësi publiku i tij t'i kuptojë qartë.

Kujt i janë drejtuar narracionet e dëmshme?

Partitë në pushtet në periudhën shtator 2023 – janar 2024 (deri në formimin e Qeverisë kalimtare), narracionet e dëmshme i kanë krijuar më shpesh kundër kundërshtarëve të vetë të opozitës. Të njëjtat trende të drejtimit të narracioneve të dëmshme janë vënë re edhe te liderët e partive politike. Nga shkurti 2024 janë vënë re intensifikim i retorikës së dëmshme te partia e atëhershme në pushtet nga blloku shqiptar.

Si i komunikojnë faktorët politikë mesazhet e veta?

Me formimin e qeverisë kalimtare në janar 2024, vërehet një ndryshim edhe në diskursin politik. Komunikimet u bënë më të shpeshta, më të ashpra dhe më të drejtuara ndaj kundërshtarëve politikë, duke përdorur pothuajse çdo temë me interes publik për të promovuar ideologjinë e vet politike dhe për të sulmuar kundërshtarin. Narracionet polarizuese të orientimit pro dhe antievropian që mbizotëruan në dy muajt e parë të vitit 2024 u përforcuan në retorikën zgjedhore. Intensifikimi shtesë i këtij lloji të komunikimit ndodhi në shkurt të vitit 2024, kur Qeveria e përkohshme tashmë kishte filluar punën, kurse zgjedhjet u shpallën në mes të muajit.

Nuk është e pazakontë, madje është e pritshme, që komunikimi politik të përmbajë kritika ndaj kundërshtarëve. Megjithatë, kur kritika politike përdor pretendime që nuk mbështeten me fakte dhe dëshmi, përdor gjuhë fyese dhe etiketime ndaj kundërshtarëve politikë, atëherë ajo kalon në komunikim të narracioneve të dëmshme. Komunikimi me narracione të dëmshme i shkel hapur dhe drejtpërdrejt parimet e komunikimit etik dhe profesional, kurse nga mbartësit e funksioneve publike dhe kandidatët për funksionet publike pritet komunikim transparent, i përgjegjshëm dhe i saktë, që do të jetë në përputhje me angazhimin e tyre se do të punojnë për të mirën e qytetarëve.

Për përfaqësuesit qeveritarë

Përveç monitorimit për praninë e narracioneve të dëmshme, janë monitoruar edhe profilet në Fejsbuk të përfaqësuesve qeveritarë (kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat) që të identifikohen keqpërdorime eventuale të kanaleve qeveritare zyrtare të komunikimit në Fejsbuk për komunikim partiak, përkatësisht a e respektojnë Kodin e Etikës për nëpunësit publikë, sipas të cilit ata duhet t'i kryejnë detyrat e tyre të punës në mënyrë politikisht neutrale dhe të paanshme dhe të mos përfaqësojnë bindjet e tyre politike në kryerjen e detyrave të tyre të punës.

Trendi funksionarët qeveritarë t'i përdorin faqet zyrtare qeveritare në Fejsbuk për aktivitete partiake-politike është vërejtur vazhdimisht gjatë periudhës së monitorimit. Te disa prej tyre, praktika më e shpeshtë është përdorimi i një profili në Fejsbuk për të komunikuar edhe informacionin zyrtar qeveritar, por edhe për aktivitetet e partive politike nga vijnë. Në të njëjtin profil, mund të vërehen aktivitete që i ka pasur një funksionar si pjesë e Qeverisë, kurse gjithashtu me përdorimin e të dhënave zyrtare qeveritare të ilustruhet kontributi i partisë, ku shpeshherë barazohet partia me Qeverinë, përkatësisht shtetin. Praktikimi i kësaj qasjeje nuk paraqet një qasje profesionale në komunikimin me publikun, duke pasur parasysh se nga përfaqësuesit qeveritarë pritet të publikojnë përmbajtje në lidhje me punën e Qeverisë, vendimet që i merr ajo, politikat që i krijon,

ligjet që i propozon, si edhe për punë dobi të interesit të publikut dhe të qytetarëve. Me promovimin partiak në profilet zyrtare në Fejsbuk, kryeministri dhe ministrat i shkelën drejtpërdrejt parimet e profesionalizmit dhe paanshmërisë në komunikimin e përfaqësuesve qeveritarë, por u shkel edhe Kodi i etikës për nëpunësit publikë.

VETPREZANTIMI I AKTORËVE POLITIKË

Si edhe çdo narracion, ashtu edhe i dëmshmi ka “narrator” i cili përfaqësohet nën një dritë të caktuar. Në narracionet e dëmshme “narrator” janë aktorët politikë (partia, lideri ose nëpunësi qeveritar) i cili në 34% të narracioneve të dëmshme nuk ka qëllim të veçantë që të prezantohet në çfarë do lloj roli. Në dy të tretat e mbetura ku prezantohet në një rol të caktuar, më shpesh ose në një të pestën (19 %) e narracioneve të dëmshme prezantohet si “shpëtimtar”, pastaj si “mbrojtës i popullit” – 15 % ose “i të drejtës” – 10 % ose “të identiteti” – 9 %. Në të njëjtën përqindje (9 %) të narracioneve të dëmshme prezantohen se është “i orientuar kah BE-së”, ku si të tilla më shumë tregohen përfaqësuesit qeveritarë – 26%. Shumë më rrallë aktori politik e përfaqëson vetveten si “transparent” (3 %).

Nëse rolet më të shpeshta vendosen në kontekstin e narracioneve më të prodhuara dhe temës së politikës së brendshme, atëherë fitohet një pasqyrë më e plotë për faktin se sa me kujdes krijohen narracionet. Domethënë, në një atmosferë mosbesimi (“minim i besimit”), pasigurie (“sulme ndaj personalitetit”) dhe përçarje në shoqëri (“nxitje e përçarjes”), është i domosdoshëm një “shpëtimtar” dhe “mbrojtës” (i “popullit”, “drejtësisë” ose “identitet”) që do të udhëheqë politikë të brendshme për kthimin e besimit tek institucionet, për uljen e pasigurisë dhe ndarjes shoqërore. Në këtë fakt, orientimi drejt BE-së është shumë më pak i rëndësishëm, kurse dhe aq më pak edhe transparenca si tipar i personalitetit. Narracioni që ofron shpëtimtarët dhe mbrojtësit i drejtohet drejtpërdrejt pjesës emocionale të personit dhe mesazhi nënkontekstual që e dërgon është se qytetarët janë të pafuqishëm, nuk mund ta bëjnë vetë dhe kanë nevojë për një “mbrojtës”. Ky mesazh, për më tepër, nuk inkurajon dhe nuk lë hapësirë për mendim kritik, të pavarur dhe vendimmarrje të bazuar në të dhëna, fakte dhe aspekte të ndryshme të vështrimit të çështjeve dhe problemeve.

FORMA NËPËRMJET TË CILAVE TRANSMETOHEN NARRACIONET E DËMSHME

Format ose mënyrat nëpërmjet të cilave narracioni i dëmshëm është transmetuar lidhet në fakt me llojin e artikullit, përkatësisht a është transmetuar nëpërmjet shpalljeve për publikun apo transmetimit të fjalimit, deklaratës, intervistës, përmbajtjes vizuale dhe audio të manipuluar dhe ngjashëm.

Nga të gjitha mënyrat ose format e transmetimit të narracionit të dëmshëm që janë në dispozicion, mbi 80% e narracioneve të dëmshme transmetohen nëpërmjet tri-katër formave (Tabela 5). Në nivel të **të gjithë aktorëve politikë**, forma më e zakonshme është **shpallja publike**, pastaj vijon **konferenca për shtyp** dhe **reagimi**. Në mënyrë të ngjashme, **partitë politike** i përdorin të njëjtat tri forma – shpallje, konferencë për shtyp dhe reagim. Te **liderët** e partive politike dhe **përfaqësuesit qeveritarë**, forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës përcillet narracioni i dëmshëm është **reagimi**. Te ta, forma tjetër më e zakonshme është **shpallja për mediat**, ndërsa te përfaqësuesit qeveritarë është **intervista**. Intervistat janë forma e tretë më e shpeshtë nëpërmjet së cilës liderët përcjellin

narracione të dëmshme, ndërsa **fjalimi** është në vendin e tretë të përfaqësuesit qeveritarë. Duket se kur komunikojnë si individë dhe jo nëpërmjet partisë së tyre, sidomos përfaqësuesit respektojnë forma të adresimit personal ndaj qytetarëve, qoftë nëpërmjet intervistës, fjalimit apo reagimit.

| Forma të narracionit të dëmshëm | Gjithsej të gjithë aktorët politikë | | | Forma të narracionit të dëmshëm | Gjithsej parti politike | | |
|---------------------------------|-------------------------------------|------------|-----------|---------------------------------|---------------------------------|------------|-----------|
| | 9 muaj | 6 muaj | 3 muaj | | 9 muaj | 6 muaj | 3 muaj |
| Shpallje për mediat | 390 (44 %) | 370 (48 %) | 20 (19 %) | Shpallje për mediat | 372 (51 %) | 356 (53 %) | 16 (29 %) |
| Konferenca për shtyp | 160 (18 %) | 144 (19 %) | 16 (15 %) | Konferenca për shtyp | 155 (21 %) | 141 (21 %) | 14 (25 %) |
| Reagim | 112 (13 %) | 90 (12 %) | 22 (21 %) | Reagim | 54 (7 %) | 51 (8 %) | 3 (5 %) |
| Intervistë | 62 (7 %) | 45 (6%) | 17 (16 %) | Fjalim | 44 (6 %) | 36 (5 %) | 8 (14 %) |
| Fjalim | 59 (7 %) | 49 (6 %) | 10 (10 %) | Intervistë | 39 (5 %) | 29 (4 %) | 10 (18 %) |
| Deklaratë | 39 (4 %) | 34 (4 %) | 5 (5 %) | Deklaratë | 31 (4 %) | 28 (4 %) | 3 (5 %) |
| Kolumnë | 2 (0 %) | 2 (0 %) | / | Kolumnë | 2 (0 %) | 2 (0 %) | / |
| Tjetër | 57 (6 %) | 43 (6 %) | 14 (13 %) | Tjetër | 26 (4 %) | 24 (4 %) | 2 (4 %) |
| | 881 | 777 | 104 | | 723 | 667 | 56 |
| | | | | | | | |
| Forma të narracionit të dëmshëm | Gjithsej liderë partish | | | Forma të narracionit të dëmshëm | Gjithsej përfaqësues qeveritarë | | |
| | 9 muaj | 6 muaj | 3 muaj | | 9 muaj | 6 muaj | 3 muaj |
| Reagim | 44 (39 %) | 35 (42 %) | 9 (31 %) | Reagim | 14 (31 %) | 4 (15 %) | 10 (53 %) |
| Shpallje për mediat | 16 (14 %) | 13 (15 %) | 3 (10 %) | Intervistë | 10 (22 %) | 8 (31 %) | 2 (11 %) |
| Intervistë | 13 (12 %) | 8 (10 %) | 5 (17 %) | Fjalim | 6 (13 %) | 5 (19 %) | 1 (5 %) |
| Fjalim | 9 (8 %) | 8 (10 %) | 1 (3 %) | Shpallje për mediat | 2 (4 %) | 1 (4 %) | 1 (5 %) |
| Deklaratë | 7 (6 %) | 5 (6 %) | 2 (7 %) | Deklaratë | 1 (2 %) | 1 (4 %) | / |
| Konferenca për shtyp | 5 (4 %) | 3 (4 %) | 2 (7 %) | Konferenca për shtyp | / | / | / |
| Kolumnë | / | / | / | Kolumnë | / | / | / |
| Tjetër | 19 (4 %) | 12 (4 %) | 7 (4 %) | Tjetër | 12 (27 %) | 7 (27 %) | 5 (26 %) |
| | 113 | 84 | 29 | | 45 | 26 | 19 |

Tabela 5. Pasqyrë e formave të narracionit të dëmshëm sipas grupit të aktorëve politikë: parti politike, liderë politikë dhe përfaqësues qeveritarë

3.2. ANALIZA E INFORMIMIT NGA MEDIAT PËR NARRACIONET E DËMSHME POLITIKE

Roli i mediave në proceset demokratike tashmë është shumë i njohur. Ato sigurojnë hapësirë ose platformë për shkëmbim të mendimeve, diskutim dhe reflektim – hapësirë e cila ndonjëherë quhet “sferë publike”. Njëkohësisht, ato sigurojnë kanal për komunikim ndërmjet politikanëve dhe publikut, duke u mundësuar politikanëve t’ia komunikojnë bindjet dhe propozimet e tyre publikut, duke u ofruar qytetarëve informacionet që u nevojitet që të marrin pjesë në proceset politike dhe demokratike, por dhe duke i lejuar politikanët të dëgjojnë zërin e publikut. Mediat gjithashtu u rikujtojnë politikanëve përgjegjësinë dhe llogaridhënien e tyre – nëpërmjet raportimit dhe reagimit të drejtpërdrejtë ndaj ngjarjeve të ndryshme sociale dhe çështjeve me interes publik nëpërmjet intervistave.

Mediat kanë rol të rëndësishëm në formimin e mendimit publik. Nëpërmjet përmbajtjes që e ofrojnë dhe tonin me të cilin e thonë, mediat mund të ndikojnë mbi faktin se si publiku do të kuptojë një çështje të caktuar, cilat tema do t’i konsiderojë të rëndësishme dhe cilat informacione do t’i shfrytëzojë gjatë formimit të mendimit personal politik.

Analiza e informimit nga mediat për narracionet e subjekteve politike është bërë mbi dy lloje mediash, të cilat përveç se kanë dallim sipas kanalit nëpërmjet të cilit komunikojnë me publikun, si dhe sipas biblikut të synuar, dallohen edhe nga mënyra se si janë normativizuar. Dy llojet e mediave të dhënat e të cilave janë monitoruar në këtë analizë janë:

- Ekzemplar i 9 **TV-stacioneve** publike dhe private në nivel nacional dhe
- Ekzemplar i 11 **mediave informative onlajn**

TV-STACIONE

DINAMIKA E PËRDORIMIT TË NARRACIONEVE TË DËMSHME

Në periudhën nga shtatori 2023 deri në maj të vitit 2024, monitorimi i TV-stacioneve është kryer në gjithsej **69 ditë**. Gjatë këtij nëntëmujori, secili prej TV-stacioneve është monitoruar çdo të katërtën ditë radhazi të muajit, ose gjithsej 7 deri në 8 ditë në muaj, varësisht nga numri i ditëve në muaj.

Dinamika e shpërhapjes së narracioneve të dëmshme, si dhe tek analiza e aktorëve politikë, analizohet nga dy aspekte: 1) sa raporte televizive me narracione të dëmshme janë transmetuar në lajmet qendrore nga TV-stacionet dhe 2) sa narracione të dëmshme janë transmetuar nëpërmjet raporteve, përkatësisht sa narracione të dëmshme janë paraqitur në këto raporte.

Sa raporte me narracione të dëmshme kanë emituar TV-stacionet

Gjatë periudhës së monitoruar, TV-stacionet kanë transmetuar **669** TV-reportazhe në emisionet e tyre kryesore informative që përmbanin një narracion të dëmshëm. Ashtu si tek aktorët politikë, më shumë se dy të tretat (72%) janë në periudhën parazgjedhore, ndërsa më pak se një e treta e

raporteve me narracione të dëmshme (28%) janë në periudhën zgjedhore. Periudha dhjetor 2023 – shkurt 2024 ka shënuar numrin më të madh të artikujve me narracione të dëmshme, duke kulmuar në janar 2024. Nga shkurti i vitit 2024 deri në muajin e fundit të analizës, ka pasur një rënie të vazhdueshme të numrit të artikujve me narracione të dëmshme, me më pak të publikuara në maj të vitit 2024 (Figura 11).




Figura 11. Numri i TV-reportazhe me narracione të dëmshme në lajmet qendrore, sipas muajve

Publiku (opinion) në muaj, në nivel të periudhës së analizuar nëntëvjeçare, mesatarisht “ka konsumuar” nga 74 TV-raporte me narracione të dëmshme¹¹. Kur ndahet sipas periudhave, pamja është paksa e ndryshme – në periudhën parazgjedhore mesatarja mujore është më e lartë, përkatësisht në muaj janë transmetuar mesatarisht 81 TV-reportazhe me narracione të dëmshme, ndërsa gjatë periudhës zgjedhore janë transmetuar mesatarisht nga 62 TV-reportazhe në muaj, domethënë, publiku është ekspozuar ndaj një çerek më pak TV-reportazhesh me përmbajtje të dëmshme politike gjatë periudhës zgjedhore në krahasim me periudhën parazgjedhore. Duke marrë parasysh se gjatë periudhave zgjedhore, transmetuesit funksionojnë sipas rregullave të duhura për raportimin në kohë zgjedhore dhe janë nën monitorim të posaçëm nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, nuk duhet të habitë fakti që numri i narracioneve të dëmshme në TV-reportazhet është ulur ndjeshëm gjatë kësaj periudhe.

11 Më shumë se një e treta (36%) e numrit të përgjithshëm të TV-reportazheve me narracione të dëmshme janë vetëm nga një TV-stacion. Nëse do të përjashtoheshin TV-reportazhet nga ky stacion televiziv, jo vetëm do të zvogëlohej numri i përgjithshëm i programeve të dëmshme, por edhe mesatarja mujore dhe ditore e TV-reportazheve të dëmshme ndaj të cilave është ekspozuar publiku. Me fjalë të tjera, pjesa e publikut që e ndjek këtë televizion ishte më shpesh dhe në mënyrë të përsëritur e ekspozuar ndaj narracioneve të dëmshme sesa pjesa e publikut që nuk e ndjek këtë televizion.




Figura 12. Numri mujor mesatar i TV-reportazheve me narracion të dëmshëm në lajmet qendrore, sipas periudhës së analizuar

Sa narracione të dëmshme janë të pranishme në reportazhet e lajmeve qendrore

Në lidhje me numrin e narracioneve të dëmshme të transmetuara, ai është (si numri i përgjithshë ashtu edhe ai mujor) shumë më i lartë në periudhën parazgjedhore krahasuar me periudhën zgjedhore, veçanërisht në krahasim me muajt zgjedhorë prill dhe maj 2024 (Figura 13). Gjithsej 1197 narracione të dëmshme janë transmetuar në 669 TV-reportazhe, si me numrin e reportazheve edhe me numrin e narracioneve, është vërejtur i njëjti trend – në periudhën parazgjedhore janë transmetuar 73% të narracioneve të dëmshme, ndërsa në periudhën zgjedhore, 27%. Gjithashtu, trendi mujor në shpeshësinë e narracioneve të dëmshme është identik me shpeshësinë mujore të TV-reportazheve - narracionet më të dëmshme janë transmetuar në muajt dhjetor 2023 dhe janar 2024, dhe më pak në maj të vitit 2024.




Figura 13. Numri i narracioneve të dëmshme në TV-reportazhet në lajmet qendrore, sipas muajve

Figura 14 pasqyron nivelin e nëntë muajve, në publik mesatarisht në muaj janë përcjellë 133 narracione të dëmshme, kurse mesatarisht në ditë nga katër narracione të dëmshme. Nga aspekti i periudhës së analizës, publiku u ekspozua ndaj narracioneve të dëmshme me mbi një të tretën më shumë në periudhën parazgjedhore sesa në periudhën zgjedhore. Gjatë periudhës zgjedhore, mesatarja mujore e narracioneve të dëmshme të transmetuara është 106 ose tre narracione të

dëmshme në ditë më shumë. Shifrat tregojnë se TV-stacionet e ngadalësuan “ritmin” e transmetimit të narracioneve të dëmshme në muajin menjëherë para zgjedhjeve (mars) dhe në muajt e zgjedhjeve (prill dhe maj), kryesisht për shkak të dispozitave ligjore për informim gjatë zgjedhjeve por a është ky ndryshim domethënës në krijimin e një atmosfere informacioni të paanshëm dhe sigurimin e informacionit të saktë dhe konstruktiv që do të sigurojë një bazë solide për arsyetimin kritik dhe më pas në marrjen e vendimeve cilësore nga qytetarëve në lidhje me zgjedhjet? Në kushtet kur në periudhën gjashtëmujore para zgjedhjeve publiku u ekspozua çdo ditë ndaj katër e më shumë narracioneve të dëmshme, ku ky numër u zvogëlua vetëm me një narracion gjatë periudhës zgjedhore, hapësira për gjykim kritik dhe të qartë publik mbetet mjaft e ngushtë.




Figura 14. Numri mesatar i narracioneve të dëmshme në TV-reportazhet në lajmet qendrore (në nivel prej nëntë, gjashtë dhe tre muajsh), në periudhën e analizuar

LLOJI MË I SHPESHTË I NARRACIONEVE TË DËMSHME

Analiza e transmetimit të narracioneve të dëmshme në informimin televiziv është kryesisht e ngjashme me atë të aktorëve politikë, kur bëhet fjalë për 1) llojet e narracioneve të dëmshme nga narracionet e përcaktuara teorikisht që vërehen në këto reportazhe, 2) temat me të cilat ndërlidhen më shpesh narracionet e dëmshme, 3) narracionet e dëmshme më të përdorura, 4) aktorët në reportazhet me narracione të dëmshme dhe qëndrimi i gazetarit ndaj tyre. Por, këtu është shtuar edhe një nënaspekt i pestë: 5) kush e ka prodhuar narracionin e dëmshëm dhe cili është qëndrimi i gazetarit ndaj narracionit të dëmshëm të prodhuar nga aktori politik.

Cilat lloje të narracioneve të dëmshme nga ato të përcaktuarat janë vënë re

Te TV-stacionet janë vënë re 15 nga 16 narracionet e dëmshme në TV-reportazhet (Tabela 6). Prej këtyre 15, tre janë shfaqur rastësisht ose në një ose në periudhë tjetër, kurse ato janë: “teori të komplotit” dhe “informacione keqdashëse” (nga dy herë) dhe “ksenofobi” (një herë), kurse “seksizëm” nuk është regjistruar asnjë herë

| Narracioni i dëmshëm * | Numri i përgjithshëm i narracioneve të dëmshme të prodhuar | | | Mesatarja mujore | | |
|--|--|--------------|------------|------------------|--------------|------------|
| | Nëntë muaj | Gjashtë muaj | Tre muaj | Nëntë muaj | Gjashtë muaj | Tri muaj |
| Minimi i besimit | 419 | 319 | 100 | 47 | 53 | 33 |
| Përzgjedhja e njëanshme | 325 | 225 | 100 | 36 | 38 | 33 |
| Sulme në bazë personale | 152 | 121 | 31 | 17 | 20 | 10 |
| Nxitja e ndarjeve | 80 | 46 | 34 | 9 | 8 | 11 |
| Dezinformacione | 69 | 61 | 8 | 8 | 10 | 3 |
| Populizëm | 49 | 41 | 8 | 5 | 7 | 3 |
| Shpërhapje e panikut dhe frikës | 30 | 13 | 17 | 3 | 2 | 6 |
| Ndikim i huaj | 20 | 15 | 5 | 2 | 3 | 2 |
| Gjuhë e urrejtjes | 16 | 15 | 1 | 2 | 3 | 0 |
| Përmbajta e manipuluar audio dhe vizuale | 13 | 9 | 4 | 1 | 2 | 1 |
| Patriotizëm dhe nacionalizëm ekstrem | 11 | 7 | 4 | 1 | 1 | 1 |
| Etnocentrizëm | 8 | 4 | 4 | 1 | 1 | 1 |
| Teori të komplotit | 2 | 0 | 2 | 0 | 0 | 1 |
| Informacione keqdashëse | 2 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ksenofobi | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjitsej | 1197 | 879 | 318 | 133 | 147 | 106 |
| Mesatarja ditore | | | | 4,4 | 4,9 | 3,5 |

* Emërtimet e narracioneve të dëmshme janë dhënë në version të shkurtër. Emërtimet e tërësishme mund të lexohen në nëntitullin 2.3 Variabilë (f. 41-43)

Tabela 6. Shpeshtësia e narracioneve të dëmshme në TV-reportazhet, numri mesatar mujor dhe numri mesatar ditor i narracioneve të dëmshme

Me cilat tema lidhen më shpesh narracionet e dëmshme

Politika e brendshme është tema me të cilën ndërliiden 68% e narracioneve të dëmshme të transmetuara në TV-reportazhet në të nëntë muajt. Por, më shumë narracione të dëmshme për këtë temë ka gjatë periudhës zgjedhore (82%) në krahasim me periudhën parazgjedhore (63%) (Figura 15). Tema tjetër së cilës i referohen më të vogël narracionet e dëmshme është ekonomia, kurse për këtë temë janë vërejtur edhe më pak narracione të dëmshme gjatë periudhës zgjedhore. Akoma më të rralla janë temat e drejtësisë dhe politikës së jashtme, ndërsa temat e tjera (krimi, shëndetësia, arsimi, korrupsioni, politika sociale dhe kultura), për të cilat janë shfaqur narracione të dëmshme, janë pothuajse të papërfillshme.




Figura 15. Tema në të cilat shfaqen narracione të dëmshme në TV-reportazhet në lajmet qendrore, sipas periudhës së analizuar

Edhe pse në shumicën e rasteve, temat më të shpeshta për të cilat aktorët politikë kanë krijuar narracione të dëmshme janë pasqyruar edhe në TV-reportazhet me narracion dëmtues, nëse krahasohen më me vëmendje tematika e narracioneve të dëmshme te TV-stacionet me tematikën e aktorëve politikë të përcjella nëpërmjet kanaleve të tyre të komunikimit, mund të vërehen disa dallime të rëndësishme:

- Përfaqësim më i ulët i politikës së brendshme si temë në periudhën e përgjithshme në raportimin mediatic në TV-stacione (71% te aktorët politikë, ndërsa 68% te stacionet televizive), por të ndara sipas periudhave, gjatë raportimeve mediaticke në periudhës zgjedhore, narracionet e dëmshme për temat e politikës së brendshme ishin më të shpeshta (82%) sesa vetë aktorët politikë i transmetuan nëpërmjet kanaleve të tyre në të njëjtën periudhë (77.5%) (krahasoni me Figurën 9)
- Narracionet e dëmshme për temat gjyqësor dhe politikë e jashtme gjatë raportimit mediatic janë në vendin e tretë dhe të katërt sipas përfaqësimit, kurse te aktorët politikë të njëjtat tema janë në vendin e tetë dhe të gjashtë (krahasoni me Figurën 9)
- Narracionet e dëmshme në temat për krimin dhe shëndetësinë gjatë raportimit mediatic janë në vendin e pestë dhe të gjashtë, për dallim nga vendi i tretë dhe i katërt te aktorët politikë.

Edhe përkrah këtyre dallimeve në përzgjedhjen e narracioneve të dëmshme, megjithatë dy temat kryesore të narracioneve të dëmshme të cilat i kanë krijuar aktorët politikë, ndiqen dhe përforcohen në mënyrë të përgjithshme nga raportimi mediatic.

Cilat janë narracionet e dëmshme më të shpeshta në reportazhe

Në TV-raportimin më të shpeshta janë gjashtë narracione (Tabela 6) të cilat përbëjnë 88% të numrit të përgjithshëm të narracioneve që janë vënë re. Rendi sipas shpeshtësisë së katër të parave është krejtësisht identik me atë të aktorëve politikë, kurse dallimi i vetëm është në narracionin e fundit, të pestin – te aktorët politika ishte populizmi, kurse te TV-stacionet janë dezinformacionet (Figura 16). Parë më detajisht, në periudhën zgjedhore, i pesti sipas shpeshtësisë në informimin mediatic ka qenë narracioni i dëmshëm “shpërhapja e panikut, frikës dhe pasigurisë”, por në numrin e përgjithshëm prej nëntë muajsh, ai është nën 3%.




Figura 16. Pesë narracionet e dëmshme më të shpeshta në TV-reportazhet në lajmet qendrore, në periudhën e analizuar

Mund të nxirret përfundim se ka pothuajse pasqyrim të tërësishëm të narracioneve të dëmshme të prodhuara nga aktorët politikë në informimin mediatik për politikanët dhe narracionet e tyre në hapësirën informuese mediatike në TV-stacionet.

Cilët janë aktorët në reportazhet me narracion të dëmshëm dhe si është raporti i gazetarit ndaj tyre

Analiza e aktorëve që janë shfaqur, por edhe që i shpërhapin narracionet e dëmshme në këta nëntë muaj, çon në një nga përfundimet kryesore se kush ka qasje te TV-stacionet, përkatësisht kujt i jepet privilegji të flasë. Pa përjashtim, TV-stacionet hapësirën më të madhe ua kanë dhënë përfaqësuesve të partive më të mëdha politike (VMRO-DPMNE, LSDM, BDI), kurse gjatë periudhës zgjedhore edhe koalicionit VLEN, liderëve të tyre, përfaqësuesve, si dhe kandidatëve të tyre për president. Mund të thuhet se aktorët dhe partitë më të vogla politike nuk kanë vend në raportet e TV-stacioneve. E gjithë skena informative duket se u është lënë këtyre partive politike, në të cilat krijohen dy opozita binare – njëra për bllokun maqedonas dhe tjetra për bllokun shqiptar.

Në lidhje me raportin e gazetarit ndaj aktorëve, ai më shpesh ka qenë neutral pothuajse në të gjitha TV-stacionet, por ka pasur edhe raste ku mungon neutraliteti, përkatësisht është shprehur marrëdhënie negative ose pozitive e gazetarit, në varësi nga fakti se për kë aktor politik bëhet fjalë.

Qasja e njëanshme e gazetarit, përkatësisht e theksuar kundër ose në anën e ndonjë aktori politik është në kundërshtim me standardet profesionale të gazetarisë. Sipas Kodit etik të gazetarëve “raportimi për proceset politike, sidomos për zgjedhjet, duhet të jetë i paanshëm dhe i balancuar. Gazetari duhet të sigurojë me patjetër distancë profesionale nga subjektet politike”¹².

Çfarë nënkupton prezenca dominuese e aktorëve të këtyre tri, përkatësisht katër partive/koalicioneve më të mëdha politike në programet informative televizive? Disa shpjegime janë të mundshme. E para ka të bëjë me praktikën klienteliste midis partive politike në pushtet dhe mediave më të mëdha audiovizuale, të cilat rrisin rrezikun e kontrollit të mundshëm politik mbi këto media nëpërmjet boshllëqeve të normativizimit të reklamave politike me pagesë (në MPM 2023 vërehet

12 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. [Kodeksi i Gazetarëve të Maqedonisë](#)

një përkeqësim në fushën tematike të pavarësisë politike me dy pikë përqindje krahasuar me vitin 2022) (Micevski, I. dhe Tërpevska, S., RESIS 2024¹³). Përfundimi i dytë i mundshëm është se televizionet në programet e tyre informative u japin hapësirën më të madhe subjekteve më të mëdha politike, kurse zëra të tjerë dëgjojnë shumë rrallë në transmetim, edhe kur bëhet fjalë për tema specifike dhe profesionale në të cilat do të pritej mendim nga ekspertë (ndryshimi i ligjeve, përzgjedhja e gjykatësve dhe prokurorëve etj.). Në këtë mënyrë, televizionet e shkelën parimin e sigurimit të kushteve të barabarta për qasje te mediat për grupe të ndryshme shoqërore, duke i përfshirë edhe partitë politike (Rezoluta e Këshillit të Evropës 1636, 2008¹⁴). Shpjegimi i tretë është se aktorët politikë, duke u nisur nga premisa se për t'u zgjedhur duhet të jesh vazhdimisht dhe kudo i pranishëm dhe aktiv, imponohen në sferën publike. Dukshmëria, performanca, karizma janë shumë më të rëndësishme se argumentet, të cilat duhet të jenë arma kryesore politike në një demokraci.

Kush e ka krijuar dhe si është raporti i gazetarit ndaj narracionit të dëmshëm të prodhuar nga politikani

Analiza se kush është përgjegjës për krijimin e narracionit të dëmshëm tregon shumëllajshmëri të caktuar në rolin e gazetarit në prodhimin e narracionit të dëmshëm. Ndërsa në shumicën e televizioneve (76%) aktori politik ishte ai që prodhoi narracionin e dëmshëm, kurse gazetari vetëm i ka transmetuar deklaratat e tij pa ndërhyrje apo duke mbajtur ndonjë pozicion, në ¼ e raporteve gazetari ka marrë pjesë drejtpërdrejt në krijimin e narracionit të dëmshëm – ose duke e prodhuar atë vetë ose së bashku me aktorin politik (Figura 17)¹⁵.

Duke parë periudhën e analizuar, nuk ka pothuajse asnjë ndryshim midis periudhës parazgjedhore dhe asaj zgjedhore në rastet kur aktori politik është krijuesi i narracionit të dëmshëm ose në ato ku të dy e krijojnë. Vetëm gjatë periudhës zgjedhore ka një rënie të ndjeshme të rolit të gazetareve si krijues i narracioneve të dëmshme (8%).




Figura 17. Prodhuesi/krijuesi i narracionit të dëmshëm në TV-reportazhe në lajmet qendrore, në periudhën e analizuar

13 Monitorimi i pluralizmit mediatic në epokën digjitale. Raporti nacional për RMV-në për 2023 (2024)

14 Gjendet në [Res. 1636 - Resolution - Adopted text](#)

15 Pjesëmarrje më të madhe gazetareske në krijimin e narracioneve të dëmshme ka në një stacion televiziv. Nëse llogaritet pa të, gazetarët kanë krijuar 11% të narracioneve të dëmshme.

Në rastet kur vetë aktori politik ka krijuar narracion të dëmshëm, gazetarët më shpesh e transmetojnë atë pa asnjë lloj intervenimi ose e theksojnë më rrallë, por nuk ndërmarrin asnjë qëndrim. Në 7% të rasteve e kanë gjykuar, kurse në 13% të rasteve e kanë transmetuar me miratim narracionin e dëmshëm (Figura 18).




Figura 18. Raporti i gazetarit ndaj narracionit të dëmshëm të prodhuar nga politikani në TV-reportazhe, në periudhën e analizuar

Roli i gazetarit/medias në të shumtën e rasteve vetëm ta përcjellë narracionin tek publiku dhe elektorati, pa ndërhyrë në asnjë mënyrë. Megjithatë, akuzat për korrupsion dhe mungesë përgjegjësie, gjuhë ofenduese drejtuar kundërshtarëve politikë, apo selektivitet në deklaratat e aktorëve politikë të raportuara nga media, pa ofruar dëshmi dhe argumente, duhet të trajtohen më seriozisht nga media. Pa vendosjen e një filtri për narracionet e dëmshme dhe pa i kontrolluar deklaratat që nxisin akuza pa dëshmi, intolerancë, madje edhe urrejtje ndaj grupeve të caktuara, mund t'i inkurajojë politikanët që e shohin median si një platformë të lirë për të promovuar narracionet e tyre të dëmshme.

Gazetarët nuk mund të dinë gjithmonë se a janë pohimet e vërteta apo jo, por në mungesë të fakteve dhe argumenteve për mbështetje, është detyrë e gazetarit që të kërkojë përgjigje nga aktorët politikane se ku e kanë bazën akuzat serioze në narracionet e tyre, kurse jo vetëm thjeshtë të përcjellin deklarata politike. Në të kundërtën, edhe gazetarët edhe mediat, edhe pse ndoshta nuk duan të jenë drejtpërdrejt krijues të spekulimeve, informacioneve të gabuara dhe keqdashëse, bëhen transmetues dhe përforcues të tyre, kurse kështu kontribuojnë për polarizimin gjithnjë dhe më të madh në shoqëri dhe për mosbesimin tek institucionet.

SA BURIME JANË KONSULTUAR DHE SA PALË JANË PREZANTUAR NË REPORTAZHET ME NARRACION TË DËMSHËM

Duke i analizuar reportazhet me narracion të dëmshëm sipas numrit të përfaqësimit të palëve të ndryshme, u konstatua se shumica përmbante raportim të njëanshëm (54%), ndërsa artikuj në të cilët përfaqësoheshin dy ose më shumë palë përbënin rreth një të katërtën e numrit të përgjithshëm (Figura 19). Gjatë periudhës zgjedhore, njëanshmëria në raportimin mediatik dominon edhe më shumë (60%), në llogari të përfaqësimit të dy (18%) e më shumë palëve (22%). Duke marrë parasysh kontekstin social dhe politik, përkatësisht zgjedhjet e 24 prillit dhe 8 majit, njëanshmëria e disa

raporteve nuk duhet të jetë befasuese. Mbulimi i mitingjeve, tubimeve dhe konferencave për shtyp të partive politike dominoi hapësirën publike gjatë asaj periudhe, kurse aty krijohen pjesa më e madhe e narracioneve të dëmshme.




Figura 19. Numri i palëve të përfaqësuara në TV-reportazhet me narracion të dëmshëm, në periudhën e analizuar

Informimi i njëanshëm nga një pjesë e mediave, përkatësisht paraqitja e vetëm njërës anë në artikull, është problem serioz që tregon për raportim joprofesional dhe një qasje të pabalancuar dhe të njëanshme. Ky lloj informimi i njëanshëm, në të cilin të gjitha palëve nuk u jepet mundësia të paraqesin versionin e tyre të ngjarjes, mund ta çojë shikuesin në pikëpamje dhe përfundime të paplota, të gabuara dhe të njëanshme. Është detyrë e gazetarit, ose më mirë e medias, t'i konsultojë të gjithë aktorët e lidhur me lajmin, t'i ofrojë të gjitha këndvështrimet.

Informimi i balancuar dhe i paanshëm nënkupton gjithashtu se sa dhe çfarë lloj burimesh përdorin gazetarët kur raportojnë. Analiza tregoi se dominonin ata me një burim (44%), kurse vijonin ata me tri ose më shumë burime (31%) dhe ata me dy (22%), ndërsa 3% e artikujve nuk përmbanin burime, pra gazetari ishte i vetmi burim (Figura 20).




Figura 20. Numri i burimeve në TV-reportazhet me narracion të dëmshëm sipas periudhës së analizuar

FORMAT/ZHANRI I INFORMIMIT MEDIATIK PËR NARRACIONET E DËMSHME

Sipas zhanrit, narracionet e dëmshme më shpesh shfaqen në raporte dhe artikuj analitik-reportazhesh, kurse më rrallë në fjalimet e politikanëve. Pastaj vijnë narracionet e dëmshme të regjistruara si lajm ose lajm me një deklaratë, pastaj intervista, kurse më pak artikuj në të cilët bëhet analizë dhe ata që transmetojnë shpallje të një aktori politik. (Figura 21)

Ajo që është specifike është se përqindja e reportazheve që transmetojnë fjalimin e një politikani është dukshëm më e lartë gjatë periudhës zgjedhore (20%), krahasuar me periudhën parazgjedhore (11%) dhe periudhën e përgjithshme të analizuar (14%). Nëpërmjet këtij lloji reportazhi, i cili thjesht raporton fjalimin e një politikani të caktuar, gazetarët dhe mediat u japin aktorëve politikë një platformë të cilën ata mund ta keqpërdorin për qëllimet e tyre, ndërkohë që deklaratat e tyre nuk analizohen në mënyrë kritike nga media.




Figura 21. Zhanri në TV-reportazh me narracion të dëmshëm, në periudhën e analizuar

Numri më i madh i artikujve të analizuar ku është transmetuar fjalimi i politikanit në periudhën zgjedhore tremujore nuk është për tu habitur, sidomos nëse kemi parasysh se në këtë periudhë dominuan mitingjet parazgjedhore, fjalimet dhe konferencat për shtyp të partive politike. Gjithsesi se mediat kanë obligim t'ua transmetojnë mesazhet politike qytetarëve, por këtë duhet ta bëjnë në mënyrë të balancuar dhe të paanshme dhe të sigurojnë informacione të mjaftueshme për votuesin që të mund të bëjë zgjedhje e cila do të bazohet në informacione objektive. Gjatë kësaj, është e rëndësishme qëndrimi i medias ndaj narracioneve të dëmshme, në ç'mënyrë do t'i "filtrojë", a do t'i gjykojë apo do t'i përforcojë mandej.

Përdorimi i kësaj forme informimi, që është një lloj “anomalie” mediatike, është më karakteristik për mediat e tjera (kryesisht mediat onlajn) dhe ka pak të përbashkëta me standardet profesionale gazetareske. Transmetimi i fjalimeve apo deklaratave të aktorëve politikë, përmbajtja e të cilave është e mbushur me akuza për korrupsion, sjellje joprofesionale dhe diskreditim të kundërshtarëve politikë, pa analizuar përmbajtjen e tyre, pa verifikuar pretendime të tilla apo pa paraqitur palën tjetër, është karakteristikë e gazetarisë së njëanshme dhe joprofesionale. Gjithashtu, me një praktikë të tillë, hapësira mediatike u lihet partive politike që pa pengesa të paraqesin agjendën e tyre dhe të shpërhapin ideologjinë e tyre.

MEDIAT INFORMATIVE ONLAJN

Analiza e të dhënave nga monitorimi i informimit mediatik në mediat informative onlajn zbulon mënyrat se si transmetohen dhe shpërhapen narracionet e dëmshme, si dhe rolin e gazetarëve në këtë proces. Të dhënat analizohen dhe paraqiten si të dhëna agregate për të gjitha mediat informative onlajn si grup, duke ofruar krahasime për periudhën e analizuar (parazgjedhore dhe zgjedhore) dhe, nëse ka dallime të konsiderueshme, krahasime sipas gjuhës së komunikimit (maqedonisht dhe shqip).

DINAMIKA E PËRDORIMIT TË NARRACIONEVE TË DËMSHME

Në periudhën nga shtatori i vitit 2023 deri në maj të vitit 2024, monitorimi i mediave informative onlajn u zhvillua për gjithsej 69 ditë. Çdo muaj, secili prej mediave informative onlajn monitorohej çdo të katërtën ditë radhazi të muajit ose gjithsej 7 deri në 8 ditë, në varësi të numrit të ditëve në muaj. Dinamika e shpërhapjes së narracioneve të dëmshme, si në analizat e mëparshme, analizohet nga dy aspekte: 1) sa përmbajtje me narracion të dëmshëm janë publikuar nga mediat informative onlajn dhe 2) sa narracione të dëmshme janë transmetuar nëpërmjet përmbajtjeve të publikuara.

Shpallje me narracion të dëmshëm në mediat onlajn

Gjatë nëntë muajve të monitorimit, mediat informative onlajn arritën të përcjellin narracione të dëmshme në gjithsej **1908 përmbajtje të publikuara**, rreth 600 postime më shumë se vetë krijuesit e narracioneve të dëmshme – aktorët politikë. Kjo është kryesisht për shkak të faktit se e njëjta përmbajtje publikohet nga shumica e mediave informative onlajn ose nga i njëjti eveniment janë publikuar më shumë se një shpallje. Në çdo rast, është e rëndësishme që publiku shumë shpesh ishte i ekspozuar ndaj përmbajtjes me një rrëfim të dëmshëm.

Numri më i madh i shpalljeve është vërejtur në janar të vitit 2024 dhe sidomos në prill 2024 (Figura 22). Në janar, qeveria e atëhershme u shpërbë dhe në fund të muajit u formua Qeveria kalimtare, ndërsa muaji prill ishte muaji i fushatës zgjedhore për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare dhe mbajtjen e raundit të parë të zgjedhjeve presidenciale.




Figura 22. Numri i shpalljeve me narracion të dëmshëm në mediat informative onlajn, sipas muajve

Reduktuar në një numër mesatar publikimesh, gjatë nëntë muajve, mediat onlajn kanë publikuar 212 përmbajtje në muaj, kurse në krahasimin midis periudhave, mesatarja mujore për periudhën zgjedhore është më e lartë se mesatarja mujore për periudhën parazgjedhore dhe mesatarja mujore në nivel nëntëmujor (Figura 23). Në vend që të kontribuojnë në informacionin e saktë, të drejtë dhe të paanshëm për qytetarët, mediat informative onlajn kanë kontribuar në rritjen e diskursit toksik dhe polarizues të diktuar nga aktorët politikë.




Figura 23. Numri mesatar mujor i përmbajtjeve me narracion të dëmshëm në mediat informative onlajn, në periudhën e analizuar

Numri i narracioneve të dëmshme në përmbajtjet e mediave informative onlajn

Niveli tjetër i analizës, përkatësisht sa narracione të dëmshme janë të pranishme në ato përmbajtje të botuara, tregon se gjithsej **3762 narracione të dëmshme** janë transmetuar në 1908 shpallje. Qytetarët u janë ekspozuar ndaj pothuajse dy narracioneve të dëmshme në një përmbajtje të publikuar. Prej tyre, 70% janë transferuar në periudhën parazgjedhore, me numrin më të madh në nëntor të vitit 2023, dhe prill të vitit 2024 (Figura 24). Në nëntor të vitit 2023, mesatarisht, pothuajse tre narracione të dëmshme ishin të pranishme në një përmbajtje të botuar, kurse në prill të vitit 2024, pothuajse dy. Cila është arsyeja e rritjes së infomimit toksik mediatik në këta dy muaj? Gjatë nëntorit 2023 u zhvilluan disa ngjarje politike (mbajtja e Samitit të OSBE-së në Shkup, si pjesë e kryesimit të RMV-së me OSBE-në gjatë asaj periudhe, ndryshimi i Rregullores së Kuvendit të RSM-së), por edhe diskutime në lidhje me mbajtjen e

zgjedhjeve në vitin 2024, dhe në këtë kontekst, fushatat e nisura nga partitë politike në të gjithë vendin (shumë më përpara se fushatat të cilat filluan më 18 prill të vitit 2024). Prilli i vitit 2024 ishte muaji i kulminimit të fushatave zgjedhore dhe në të njëjtën kohë një muaj zgjedhor për zgjedhjet presidenciale. Të gjitha këto evenimente u kanë lënë aktorëve politikë hapësirë të mjaftueshme për të krijuar narracione të dëmshme, kurse mediat onlajn duket se nuk kanë arritur të njohin rolin e tyre të rëndësishëm në ofrimin e informacionit të balancuar, veçanërisht në momentet kur qytetarët duhet të marrin vendime dhe konkluzione të rëndësishme, as nuk e kanë njohur rolin e tyre të rëndësishëm në ruajtjen e atmosferës demokratike.




Figura 24. Numri i narracioneve të dëmshme në artikujt në mediat informative onlajn, sipas muajve

Edhe pse mesatarja mujore e përmbajtjeve të publikuara gjatë periudhës zgjedhore është më e lartë se periudha parazgjedhore dhe periudha e përgjithshme e analizuar, megjithatë ende ka numrin mesatar mujor më të ulët të narracioneve të dëmshme të transmetuara në përmbajtjet e publikuara (Figura 25). Nuk është i vogël numri i narracioneve të dëmshme të shpërndara, por inkurajues është fakti që gjatë kësaj periudhe “toksiciteti” i përmbajtjes është 14% “më i ulët” krahasuar me periudhën parazgjedhore. Duke e thënë këtë, dhe duke pasur parasysh faktin se në muajin prill ishte numri më i madh i narracioneve të dëmshme, si dhe fakti se në gjashtëmujorin e kaluar mediat informative kanë kontribuar vazhdimisht në atmosferën “toksike”, pohohet përsëri konstatimi i deklaruar se këto media nuk e kanë përmbushur rolin e tyre të rëndësishëm në informimin e paanshëm dhe të drejtë, gjë që kontribuon në përforcimin e kulturës demokratike.




Figura 25. Numri mesatar mujor i narracioneve të dëmshme në përmbajtjet e mediave informative onlajn, në periudhën e analizuar

LLOJET MË TË SHPESHTA TË NARRACIONEVE TË DËMSHME

A Analiza e transmetimit të narracioneve të dëmshme në mediat informative onlajn, ashtu si analiza e TV-stacioneve, i përmban të njëjtat nënaspekte: 1) llojet e narracioneve të dëmshme nga narracionet e përcaktuara teorikisht të vëzhguara në përmbajtjen e publikuar të mediave informative onlajn, 2) temat me të cilat lidhen më shpesh narracionet e dëmshme, 3) cilat janë gjashtë narracionet të dëmshme më të shpeshta, 4) aktorët politikë të cilëve u drejtohen narracionet e dëmshme në përmbajtjet e botuara dhe 5) roli i gazetarit në krijimin dhe qëndrimi i tij ndaj narracioneve të dëmshme.

Llojet e narracioneve të dëmshme

Mediat informative onlajn kanë transmetuar pesëmbëdhjetë prej gjashtëmbëdhjetë narracione të dëmshme në hapësirën mediatike. “Seksizmi” u vu re vetëm një herë (nuk u vu re fare tek aktorët politikë), dhe “informacionet keqdashëse” u vunë re katër herë (ashtu si tek aktorët politikë).

Temat më të shpeshta të narracioneve të dëmshme

Nga pesëmbëdhjetë narracionet e dëmshme të vëzhguara të përcjella në përmbajtjen mediatike të mediave informative onlajn, në shumicën e rasteve (70%) lidhen me tema të politikës së brendshme dhe shumë më pak me ekonominë, korrupsionin, krimin apo ndonjë nga temat e tjera (Figura 26). Kjo është e pritshme, duke qenë se janë krijuar kështu nga vetë aktorët politikë; kurse mediat informative onlajn thjesht i shpërhapin ato në mënyrë të padiskutueshme në të gjithë hapësirën mediatike.




Figura 26. Tema ku shfaqen narracionet e dëmshme në përmbajtjet e mediave informative onlajn, në periudhën e analizuar

Narracionet më të shpeshta të dëmshme në shpallje

Për dallim nga aktorët politikë, ku janë të pranishme pesë narracione e dëmshme më të shpeshta, në mediat informative onlajn, sipas të njëjtës përqindje të shpeshtësisë së narracioneve të dëmshme (7% - kufiri i poshtëm i shpeshtësisë së shfaqjes së narracionit të dëmshëm), janë vërejtur gjashtë narracione të dëmshme (Figura 27). Ato janë pothuajse nuk bëjnë dallim sipas rendit të shfaqjes edhe tek aktorët politikë edhe te mediave onlajn, me përjashtim të narracionit të dëmshëm të “dezinformacionit” i cili renditet i katërti për nga

shpeshtësia në postimet e mediave informative onlajn, ndërkohë që nuk është në pesë vendet e para tek aktorët politikë.

“Dezinformacionet”, “populizmi” dhe “sulmet në bazë personale” janë transmetuar më shpesh në periudhën parazgjedhore (Figura 27). Në të kundërt, narracionet e “minimit të besimit në institucione”, “përzgjedhjes së njëanshme” dhe “nxitjes së ndarjeve” u transmetuan shumë më shpesh nga mediat informative onlajn në përmbajtjen e tyre gjatë periudhës mars - maj 2024, përkatësisht gjatë periudhës zgjedhore. Këto tri narracione janë veçanërisht të dëmshme gjatë proceseve demokratike, siç janë zgjedhjet, kur qytetarët vendosin për të ardhmen e tyre dhe është e një rëndësie të madhe që të kenë qasje në informacione dhe fakte të sakta, të drejta dhe të paanshme. Në vend të kësaj, duke i neglizhuar standardet profesionale të medias, informative onlajn kanë ofruar përmbajtje që minojnë besimin, nuk lejojnë paanshmëri dhe kontribuojnë në thellimin e ndarjeve në shoqëri, duke u bërë kështu “dorë e zgjatur” e aktorëve politikë.




Figura 27. Gjashtë narracionet më të shpeshta në shpalljet e mediave informative onlajn, në periudhën e analizuar

Kush i krijon dhe si është raporti i gazetarit ndaj narracionit të dëmshëm të prodhuar nga politikani

Nga gjithsej 3762 narracione të dëmshme të transmetuara në mediat informative onlajn, gazetari, vetëm ose bashkë me aktorin politik, merr pjesë më rrallë në krijimin e narracioneve të dëmshme (në 16% të narracioneve).

Shumica e narracioneve të dëmshme krijohen nga aktorët politikë, më shumë gjatë periudhës zgjedhore sesa gjatë periudhës parazgjedhore (Figura 28). Megjithatë, pjesëmarrja e gazetarit si krijues i narracioneve të dëmshme është pak më e ulët gjatë periudhës zgjedhore, në mënyrë të pavarur ose së bashku me aktorin politik.




Figura 28. Prodhuesi/krijuesi i narracionit të dëmshëm në përmbajtjet e mediave informative onlajn, në periudhën e analizuar

Duke e analizuar raportin e gazetarit ndaj narracionit të dëmshëm të krijuar nga aktori politik, del në pah mosrespektimi i informimit profesional. Përkatësisht, gazetari më shpesh luan rolin e transmetuesit të narracioneve të dëmshme, pa dhënë të dhëna shtesë dhe shpjegime nga shumë anë. Pothuajse në një të katërtën e narracioneve të transmetuara, gazetari e nxjerr në pah, pa mbajtur anë, por sërish pa shtuar shpjegime shtesë për të ekspozuar narracionin e dëmshëm, si dhe ka raste kur ai e miraton ose dënon narracionin e dëmshëm (Figura 29). Duke iu përgjigjur pyetjes se cili është roli i medias onlajn në informimin për narracionet e dëmshme, fatkeqësisht duhet të konstatohet se informimi i tillë mediatik jo vetëm që i shkel standardet profesionale gazetareske, por gjithashtu kontribuon ndjeshëm në zhvillimin dhe mbështetjen e një atmosfere toksike në momentet kur qytetarët duhet të marrin vendime të rëndësishme për të ardhmen e shoqërisë. Larg rolit që duhet të ketë media, mediat informative onlajn e ndjekin pa diskutim agjendën e diktuar nga aktorët politikë.




Figura 29. Raporti i gazetarit ndaj narracionit të dëmshëm të prodhuar nga politikani në përmbajtjet e mediave informative onlajn, në periudhën e analizuar

BURIME TË KONSULTUARA DHE PALËT E PËRFAQËSUAR NË PËRMBAJTJET ME NARRACION TË DËMSHËM

Konsultimi me burime të shumta gjatë informimit për një eveniment shoqëror, person apo temë të rëndësishme politike, si dhe prezantimi i perspektivave apo palëve të ndryshme në informim, janë standarde të rëndësishme profesionale të raportimit gazetaresk dhe tregues të mediave të paanshme dhe profesionale. Çfarë tregon analiza e këtyre dy indikatorëve të profesionalizmit mediatik?

Karakteristikë e përbashkët e të gjitha mediave informative onlajn është mbështetja e tyre në një burim të vetëm informacioni. Në 86% të publikimeve, vetëm një burim është konsultuar, ndërsa rrallë ose rastësisht janë konsultuar dy ose tri ose më shumë burime ose nuk është cituar fare burim (Figura 30). Kjo qasje është rezultat i dominimit të dy formave të zhanrit – “deklarata e transmetuar” dhe “fjalimi i transmetuar” – ku mediat onlajn transmetojnë plotësisht ose pjesërisht një deklaratë apo qëndrim të një aktori të caktuar politik (parti, lider partie, zëdhënës, deputet) për një çështje specifike. Prandaj, pavarësisht nga numri i artikujve të analizuar me narracione të dëmshme në portalet individuale, konstante në të gjithë artikujt është mbizotërimi i një burimi informacioni.




Figura 30. Numri i burimeve të vendosura në përmbajtjet me narracion të dëmshëm në mediat informative onlajn, në periudhën e analizuar

E ngjashme është imazhi i marrë nga analiza e përfaqësimit të palëve të ndryshme në postime – raportimi i njëanshëm është karakteristikë e të gjitha mediave informative onlajn që ishin objekt analize. Rreth 90% e përmbajtjes në internet që transmeton narracione të dëmshme e paraqet vetëm njërën anë, ndërsa një numër shumë i vogël postimesh paraqesin dy ose më shumë anë (Figura 31). Në muaj të caktuar, në disa media informative, të gjithë artikujt e analizuar kanë vetëm njërën palë.




Figura 31. Numri i palëve të përfaqësuar në përmbajtjet me narracion të dëmshëm në mediat informative onlajn, në periudhën e analizuar

FORMAT E INFORMIMIT MEDIATIK PËR NARRACIONET E DËMSHME

Në aspektin e zhanrit, si konstante, më të zakonshmet janë shpalljet partiake, fjalimet e transmetuara të politikanëve¹⁶, postimet e tyre në Fejsbuk, intervistat e dhëna për media të tjera dhe konferencat për shtyp. Pothuajse dy të tretat e artikujve të analizuar të mediave onlajn janë shpallje e transmetuar dhe fjalim i transmetuar i një politikani - Figura 32.

16 Zhanret “njoftim i transmetuar” apo “fjalim i transmetuar i një politikani” nuk u përkasin ndarjeve tradicionale të zhanrit gazetaresk sipas kriterëve të ndryshme, si: gjatësia e tekstit gazetaresk, kohëzgjatja e materialit video, tema, zona, stili, mënyra e përgatitjes, lloji i medias etj. Duke qenë se monitorimi mbulon mediat onlajn, ku vërehet tendenca për mbiprodhim të formave gazetareske dhe kuazigazetareske, me qasjen metodologjike është evidencuar edhe ky lloj publikimi.




Figura 32. Zhanri i shpalljeve me narracion të dëmshëm në mediat informative onlajn, në periudhën e analizuar

Është vërejtur praktika e krijimit të shpalljeve të shumëfishta nga një eveniment i vetëm, për shembull nga një konferencë për shtyp, një intervistë (shpesh e dhënë për një media tjetër), ose pjesëmarrja e subjekteve politike në emisione debati në stacione televizive të caktuara. Është vërejtur një numër i zmadhuar informacionesh, raportesh, lajmesh për një eveniment të vetëm, përkatësisht krijimi i reportazheve që veçmas nxjerrin në pah çështje për çështje për të cilat flet ose debaton një politikan, deputet, zëdhënës ose anëtar i një partie të caktuar politike. Në këtë mënyrë, në fakt, jo vetëm që informimi ditor i medias onlajn duket më i pasur në krahasim me mediat e tjera onlajn, por edhe “shumëfishohet” numri i narracioneve të dëmshme, kurse kështu edhe vetë mediumi bëhet krijues i narracioneve të dëmshme. Kjo qasje, në vetvete, si formë informacioni, lejon hapësirë të lirë për “rritje” të narracioneve të dëmshme dhe në këtë proces, përveç aktorit politik, merr pjesë drejtpërdrejt edhe vetë media.

3.3. MESAZHË KRYESORE NGA ANALIZA E AKTORËVE POLITIKË DHE MEDIAVE

PËR AKTORËT POLITIKË

Gjatë nëntë muajve, prodhimi dhe komunikimi i narracioneve të dëmshme në komunikimin politik të të gjithë aktorëve politikë ndaj publikut ka shënuar dy tendenca dinamike: njëra në rritje, duke arritur kulmin në dhjetor të vitit 2023 dhe prill të vitit 2024, kurse tjetra në rënie, nga janari i vitit 2024 dhe më e ulëta në maj të vitit 2024, pas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare. Dhjetori i vitit 2023 ishte muaji në të cilin qeveria e atëhershme aktuale po largohej, kurse në horizont ishte formimi i një qeverie kalimtare. Nga ana tjetër, prilli i vitit 2024 ishte muaji i fushatës zgjedhore presidenciale dhe parlamentare dhe zhvillimit të raundit të parë të zgjedhjeve presidenciale.

Prania e narracioneve të dëmshme në postime nuk është lineare – një shpallje – një narracion i dëmshëm, por në shumicën e rasteve ka më shumë se një narracion të dëmshëm në një shpallje. Te disa aktorë politikë në një shpallje të vetëm është vërejtur prania e dy, tre, dhe disa kanë edhe katër, pesë dhe gjashtë narracioneve të dëmshme. Kjo do të thotë se aktorët politikë përdorën retorikë të intensifikuar negative ose të dëmshme në përpjekje për t'u pozicionuar si opsioni i parë politik i zgjedhur për qytetarët. Më shpesh (37%) ata përdorën narracionin e dëmshëm të “minimit të besimit” në institucionet - nga institucionet shtetërore, pushteti lokal e deri te partitë politike si institucione dhe media. Pikërisht pas këtij narracioni, pothuajse po aq shpesh (30%) ishte përdorimi i “përzgjedhjes së njëanshme” të të dhënave dhe informacionit, në dy drejtime - ose për të denigruar kundërshtarët politikë ose për të “zbukuruar” imazhin e dikujt - duke nxjerrë jashtë të dhëna të rëndësishme, të cilat nga ana e tyre mund t'i çojnë qytetarët në përfundime të gabuara. Shumë më rrallë (7-9) janë të pranishme “sulmet në bazë personale”, me etiketim, ofendim dhe nënçmim të oponentëve politikë, pastaj “nxitja e ndarjeve”, nëpërmjet dallimit të qëllimshëm midis “ne – e mira, prosperiteti, përparimi” dhe “ata – e keqja, e prapambetura, shkatërruesja” dhe narracioni i dëmshëm “populizmi” duke përdorur fjalë dhe fjali për promovim të ideologjive dhe aktiviteteve personale si diçka që është në dobi të popullit.

Një e pesta e aktorëve politikë u paraqitën si shpëtimtarë dhe mbrojtës të popullit nga kundërshtarët politikë që punojnë për të shkatërruar shtetin. Vetëm nga përfaqësuesit e qeverisë vërehet se më shpesh (një e katërta e tyre) paraqiten se janë të orientuar drejt BE-së. Nga blloku maqedonas i partive politike, partia e atëhershme në pushtet u paraqit si opsioni i vetëm për një të ardhme evropiane, ndërsa partia më e madhe opozitare premtoi mbrojtjen e interesave kombëtare, rikthimin e dinjitetit kombëtar dhe kthimin e shtetit në duart e qytetarëve, nëpërmjet një lufte të vendosur kundër korrupsionit. Partia më e vogël opozitare nga blloku maqedonas e promovoi veten si opsioni i vetëm politik që nuk është i korruptuar dhe synon të mbrojë interesat kombëtare. Ndër partitë politike nga blloku shqiptar, partia në pushtet u paraqit si pro-evropiane, kundër ndikimit të dëmshëm rus dhe avokate e vlerave të vërteta si mbrojtëse e popullit (popullit shqiptar mbi të gjitha). Opozita e bashkuar në një koalicion trepalësh u paraqit si një alternativë më e mirë se partia në pushtet, e cila është në anën e shqiptarëve, luftëtare kundër korrupsionit dhe mbrojtëse e interesave të njerëzve të thjeshtë.

Kritika e argumentuar dhe e ashpër ndaj kundërshtarëve politikë gjatë periudhës parazgjedhore është e pritshme dhe e pranishme në çdo shoqëri demokratike. Megjithatë, prodhimi dhe shpërndarja e narracioneve të dëmshme në hapësirën publike mund të kontribuojë në polarizimin e debatit publik, në normalizimin e praktikave të këqija të komunikimit dhe në shkeljen e standardeve dhe parimeve të komunikimit etik dhe profesional. Diskursi që përmban akuza të pabazuara, sulme, fyerje dhe fjalori ofendues në skenën publike dhe në komunikimin publik mund të kontribuojë në nxitjen e ndarjeve edhe më të mëdha në baza etnike dhe politike dhe të rezultojë në uljen e besimit në procesin zgjedhor dhe tek institucionet. Kur fjalori ofendues nuk mungon, nuk kufizohet përdorimi i tij, atëherë pas një periudhe më të gjatë ajo mund të pranohet si pjesë e leksikut të gjuhës, kurse kështu të mundësohet edhe shpërhapje e narracioneve të dëmshme dhe kulturës së ulët të të shprehurit në publik.

Përgjegjësia e aktorëve politik në kulturën e të shprehurit publik është me rëndësi thelbësore. Si rrjedhim edhe parimet e komunikimit politik të bazuar në dëshmi, profesionalizëm dhe paanësi, në etikë dhe në mosshpërhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës diskriminuese.

PËR MEDIAT

Informimi mediatic mbi narracionet e dëmshme politike të monitoruara gjatë nëntë muajve ka qenë intensivisht i pranishëm si në eterin e transmetuesve nacionalë televizive ashtu edhe në hapësirën e internetit të mediave informative onlajn. Raportimi toksik, veçanërisht në mediat informacioneve onlajn, është më i përhapur sesa tek aktorët politikë. Në këtë mënyrë mediat (onlajn) e kanë shumëfishuar efektin e narracioneve të dëmshme duke siguruar platformë të aktorëve politikë nëpërmjet arritjes te publiku i gjerë, kurse jo vetëm tek ata të cilët i ndjekin kanalet e komunikimit në faqet e internetit të partive dhe profileve në Fejsbuk të politikanëve.

Retorika e dëmshme e diktuar nga aktorët më të mëdhenj dhe më të fuqishëm politikë është pasqyruar pothuajse tërësisht në lajmet kryesore televizive dhe faqet e para në internet. Kulmet më të mëdha të narracioneve toksike dhe akuzave ndërpartiake janë në janar, kur ende nuk ka nisur zyrtarisht fushata zgjedhore dhe prilli, në kulmin e fushatës zgjedhore. Shifrat e monitorimit konfirmojnë se elita politike ka një depërtim jashtëzakonisht të lehtë në agjendën e medias, duke shijuar komoditetin e imponimit të temave të rëndësishme për ta, krijimit të opinionit publik dhe dominimit të sferës publike.

Mediat informative onlajn kanë transmetuar numrin më të madh të përmbajtjeve informative me narracion të dëmshëm¹⁷ (1908 artikuj), madje tri herë më shumë sesa TV-stacionet (669), të cilat kanë në të vërtetë pjesëmarrjen më të ulët në shpërhapjen e narracioneve të dëmshme (dhe në krahasim me aktorët politikë, krijuesit e narracioneve të dëmshme – 1342 shpalljeve në internet dhe në Fejsbuk). Kur kësaj do t'i shtohet edhe numri i madh i narracioneve të dëmshme të transmetuara, del në pah (mungesa e) serioziteti dhe (pa)përgjegjësia e secilit prej aktorëve të analizuar në lidhje me obligimet e tyre profesionale ndaj publikut. Përsëri, mediat e lajmeve në internet “paraprijnë” në raport me TV-stacionet, duke transmetuar tri herë më shumë narracione të dëmshme – mediat onlajn transmetojnë 3762 narracione të dëmshme krahasuar me 1197 që transmetojnë TV-stacionet. Por “primatin” në përcjelljen e narracioneve të dëmshme e kanë aktorët politikë. Ata transmetuan 3967 narracione të dëmshme nëpërmjet kanaleve të tyre të komunikimit

17 Te mediat onlajn nuk ka kufizime kur është në pyetje hapësira, kurse emisionet informative (lajmet) në TV janë me kohëzgjatje të kufizuara.

gjatë gjithë periudhës së ndjekur. Edhe pse për secilin nga këta faktorë të veçantë ekzistojnë dispozita me të cilat normativizohet profesionalizmi dhe korrektësia në komunikimin me publikun, pothuajse asnjëri prej tyre nuk i ka respektuar.

Teorikisht, nëse një qytetar ndjek rregullisht kanalet e komunikimit të aktorëve politikë, televizionit dhe mediave onlajn, **gjatë një muaji, ai do të ekspozohet ndaj mesatarisht 435 përmbajtjesh me narracion të dëmshëm**. Ky “ekzagjerim” teorik është hipotetik dhe është paraqitur si ilustrim i ekspozimit të tepërt të qytetarëve ndaj narracioneve të dëmshme.

Pasojat e mundshme të ekspozimit të lartë ndaj narracioneve të dëmshme janë të shumta dhe të gjera në llogari të demokracisë dhe të mirëqenies shoqërore, por mbi të gjitha të vetë qytetarëve. Si rrjedhim, respektimi i rregulloreve pozitive dhe standardeve të komunikimit korrekt publik ([politik](#) dhe në [media](#)) është një detyrim që si aktorët politikë ashtu edhe punonjësit e medias duhet të kujtohen dhe t’i rikthehen më shpesh. Besimi që qytetarët e kanë si te politikanët ashtu edhe tek punonjësit mediatik i detyron ata për transparencë, paanshmëri, mirësjellje dhe komunikim të bazuar në dëshmi dhe fakte.

Në raport me faktin se cilat narracione të dëmshme i kanë transmetuar më shpesh televizionet dhe mediat onlajn, pothuajse janë pasqyruar krejtësisht nga ato të shpërndarat më shpesh dhe nga partitë politike. Tri llojet e narracioneve të dëmshme më të shpeshta janë të njëjta te të tri grupet e faktorëve, kurse ato janë “minimi i besimit tek institucionet”, “Përzgjedhja e njëanshme” dhe “sulmet në bazë personale”. Dallimi midis aktorëve politikë dhe mediave është fakti se te mediat shfaqet narracioni i dëmshëm i shpërhapjes së dezinformacioneve në pesë vendet e para.

Mandej, kur shqyrtohet mënyra se si ka qenë informimi nga mediat mbi narracionet e dëmshme dhe roli i gazetarit si një transmetues i heshtur, pa analiza kritike të pohimeve, akuzave dhe deklaratave të dëmshme të aktorëve politikë, pa ofruar këndvështrime të shumëfishta mbi narracionin që përcillet, duke u konsultuar vetëm me një burim në shumicën e rasteve, bëhet edhe më e qartë se sa ka qenë publiku i pasqyruar ndaj narracioneve që nxisin ndjenja të cilat mund të mbledhin ose të nxitin sjellje joproduktive, madje edhe agresion.

Gjatë prezantimit të narracioneve të dëmshme, mediat onlajn e informojnë publikun pothuajse në mënyrë identike: dominon transmetimi i njëanshëm i fjalimit së aktorit politik ose transmetohet një shpallje politike e një partie të caktuar politike, më shpesh me një tekst të shkurtër, me disa paragrafë, qoftë edhe vetëm disa fjali nga deklaratat e tyre, qëndrimet për një çështje të caktuar. Kështu, meqenëse se nuk bëhet fjalë për lajm, lexuesi që nuk i ka ndjekur përditë ngjarjet duhet të mundohet që ta kuptojë informacionin, çfarë u tha, pse, kur, ku. Tipar tjetër specifik i disa mediave informative onlajn është praktika e krijimit të disa postimeve (për çështje, tema të ndryshme) nga një rast apo pseudongjarje e vetme (konferencë për shtyp, emision debati).

Te televizionet dominon gjithashtu informimi i njëanshëm, më shpesh duke konsultuar vetë, një burim në raportet, në reportazhet apo në artikujt analitike-reportazhore nëpërmjet të cilave përcillen narracionet e dëmshme. Fakti se më shumë se gjysma e artikujve përfshijnë vetëm një rëndësi anë është alarmant, duke pasur parasysh se paanshmëria dhe objektiviteti duhet të jenë ndër standardet më të rëndësishme gazetareske. Aq më tepër nëse vërehet se në shumicën e reportazheve në të cilat shfaqet vetëm njëra palë, aktorët politikë dominojnë si burimi i vetëm i informacionit, që nënkupton se roli i medias është të jetë vëzhgues i heshtur i ngjarjeve politike. Sidomos në rastet kur rrëfimi i dëmshëm prodhohet nga njëri prej aktorëve politikë, gazetari është i detyruar të konsultojë palën tjetër, përkatësisht të ofrojë të gjitha pikëpamjet për problemin apo situatën.

POLITIKANËT KRIJOJNË, MEDIAT E MBËSHTESIN SHPËRHAPJEN E NARRACIONEVE TË DËMSHME

Politikanët tregojnë një potencial të jashtëzakonshëm “krijues” në krijimin e narracioneve të dëmshme, si në aspektin e vëllimit të prodhimit dhe shpeshtësisë së narracioneve të dëmshme edhe në aspektin e përmbajtjes dhe shumëllojshmërisë së narracioneve të dëmshme. Mesatarisht, në një muaj kanë krijuar mbi 400 narracione të dëmshme. Aktorët politikë përdorin kanale të shumta komunikimi për të shpërhapur narracionet, duke filluar nga faqet e tyre në internet dhe Fejsbuk, mediat informative onlajn, televizionet, konferencat për shtyp, si dhe deklaratat publike që ua dërgojnë televizionit dhe mediave onlajn. Në raportimin mediatik, përsëri, konferencat për shtyp dhe kumteset publike janë ndër format më të zakonshme të zhanrit. Në këtë mënyrë, aktorët politikë në fakt e kanë mbuluar të gjithë hapësirën e informacionit.

Aq sa kanë krijuar aktorët politikë narracione të dëmshme, po aq edhe media ka mbështetur transmetimin e narracioneve të dëmshme te qytetarët, duke i lejuar që të depërtojnë në hapësirën mediatike dhe të arrijnë te publiku i gjerë, kurse në rastin e mediave informative onlajn, edhe më shumë se vetë krijuesit. Mesatarisht, në një muaj, stacionet televizive transmetojnë mbi 100 dhe mediat onlajn mbi 400, narracione të dëmshme.

Kjo është një gjetje shkatërruese, si për aktorët politikë, ashtu edhe për mediat dhe gazetarët. Nga politikanët që fitojnë besimin e qytetarëve, publiku pret komunikim transparent, dinjitoz dhe të bazuar në fakte, jo krijimin e narracioneve që cenojnë ndjenjën e sigurisë dhe besimin në aftësinë e politikanëve për të kontribuar në mirëqenien e qytetarëve. Mediat duhet të jenë “gardianët” e së vërtetës dhe informimit të paanshëm. Informimi i medias duhet t'i sigurojë publikut informacion të plotë, të saktë dhe të bazuar në dëshmi, duke shpjeguar këndvështrime të ndryshme, mbi bazën e të cilave ai mund të marrë më pas vendime të drejta.

NARRACIONET E DËMSHME SI MJETI KRYESOR KOMUNIKUES NË FUSHATAT ZGJEDHORE

Diskursi i cili bazohet kryesisht në pohime të pabaza, pa dëshmi dhe fakte, i cili përdoret për të minuar besimin tek institucionet dhe tek kundërshtari (gjithsej 3049 tentativa të regjistruara për të minuar besimin tek institucionet në diskursin e aktorëve politikë dhe në informacionin mediatik), ku përzgjidhet informacion në favor të opsionit të vet politik (gjithsej 2039 përpjekje të shënuara me përzgjedhje të njëanshme të informacioneve të partitë politike dhe mediat) ose përdorimi i fjalorit ofendues (gjithsej 953 sulme të regjistruara mbi baza personale midis partive politike dhe në informimin mediatik), ishte mjete dominues në garën parazgjedhore.

Diskursi i tillë as nga larg nuk kontribuon në ofrimin e një baze të mirinformuar për nxjerrjen e përfundimeve dhe marrjen e vendimeve të informuara për qytetarët në lidhje me zgjedhjet. Përdorimi i shpeshtë i një diskursi të tillë mund të çojë në pranimin e fjalorit fyes si pjesë e leksikut të përgjithshëm të gjuhës, duke mundësuar kështu shpërhapjen e narracioneve të dëmshme dhe një kulturë të ulët të të folurit publik.

MEDIAT I SHKELIN STANDARDET THEMELORE PROFESIONALE TË INFORMIMIT MEDIATIK

Paanshmëria dhe balancimi, së bashku me vërtetësinë, janë elementët themelorë të profesionit të gazetarit. Konsultimi vetëm me një burim (në 45% të TV-reportazheve dhe 86% të përmbajtjeve të lajmeve të mediave onlajn dhe mbi 1% të postimeve të mediave onlajn që nuk e citojnë burim) dhe të paraqitet vetëm një anë në reportazh (në 55% të TV-reportazheve) ose të përmbajtjes së

publikuar në internet (në 90% të postimeve), sidomos kur ajo palë është përgjegjëse për krijimin e disa narracioneve të dëmshme gazetareske, është larg nga gazetaria profesionale.

